



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **RAPORTI VJETOR 2019**

**Prishtinë, mars 2020**

**PËRMBAJTJA**

<b>1</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>7</b>
<b>2</b>	<b>ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI .....</b>	<b>10</b>
2.1	Bordi i Rregullatorit.....	10
2.2	Struktura organizative dhe burimet njerëzore .....	11
2.3	Financimi i Rregullatorit.....	15
<b>3</b>	<b>AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI .....</b>	<b>16</b>
3.1	Licencimi i aktiviteteve të energjisë.....	16
3.2	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE).....	19
3.3	Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja .....	23
3.4	Gjeneratorët për vetë-konsum .....	29
3.5	Harmonizimi i Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë nga BRE .....	30
3.6	Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë .....	31
3.7	Kontestet gjyqësore .....	37
3.8	Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike .....	37
3.9	Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve .....	38
3.10	Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve .....	48
3.11	Procesi i certifikimit të OST (KOSTT) .....	53
<b>4</b>	<b>BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA .....</b>	<b>54</b>
4.1	Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës .....	55
4.2	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare .....	58
4.3	Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare .....	60
4.4	Aktivitetet e prokurimit .....	67
<b>5</b>	<b>RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN .....</b>	<b>68</b>
5.1	Të hyrat .....	68
5.2	Buxheti .....	68
5.3	Shpenzimet buxhetore.....	69
<b>6</b>	<b>SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE .....</b>	<b>73</b>
6.1	Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike.....	73
6.2	Burimet primare të energjisë.....	77
6.3	Prodhimi i energjisë elektrike .....	78
6.4	Sistemi i transmetimit.....	83
6.5	Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike.....	93
6.6	Furnizimi me energji elektrike .....	102

---

6.7	Importi dhe eksporti i energjisë elektrike.....	107
6.8	Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike .....	110
<b>7</b>	<b>SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE .....</b>	<b>124</b>
7.2	Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike .....	125
7.3	Përformanca e ndërmarrjeve të energjisë termike .....	128
7.4	Prodhimi, furnizimi dhe humbjet e gjithmbarshme të energjisë termike.....	132
7.5	Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes .....	132
<b>8</b>	<b>SEKTORI I GAZIT NATYROR .....</b>	<b>135</b>
8.1	Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë .....	135

**Lista e shkurtesave**

<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BRE</b>	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
<b>CCP</b>	Customer Care Programme (Programi për përkujdesje të konsumatorëve)
<b>CEER</b>	Council of European Energy Regulators (Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji)
<b>DETG</b>	Departamenti për energji termike dhe gaz
<b>DLL</b>	Departamenti ligjor dhe i licencimit
<b>DMK</b>	Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve
<b>DTÇ</b>	Departamenti i tarifave dhe i çmimeve
<b>DTE</b>	Departamenti për treg të energjisë
<b>EBRD</b>	European Bank for Reconstruction and Development (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
<b>EC</b>	European Commission (Komisioni Evropian)
<b>ECRB (BRKE)</b>	Energy Community Regulatory Board (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë)
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>EMS</b>	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Serbisë
<b>ENS</b>	Energy Not Supplied (Energjia e pafurnizuar)
<b>ENTSO-E</b>	European Network of Transmission System Operators for Electricity (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike)
<b>ERC</b>	Komisioni Rregullativ për Energji dhe Ujë i Republikës së Maqedonisë Veriore
<b>ERE</b>	Enti Rregullator të Energjisë të Republikës së Shqipërisë
<b>ERRA</b>	Energy Regulators Regional Association (Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë)
<b>FSHU</b>	Furnizuesi me shërbim universal
<b>GPG</b>	Grupi Punues për Gaz
<b>GPNL (PHLG)</b>	Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (Permanent High Level Group)
<b>GWh</b>	Gigavatorë
<b>HC</b>	Hidrocentral
<b>HLM (MAR)</b>	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (Maximum Allowed Revenue)
<b>IAP</b>	Ion-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
<b>ITC</b>	Inter TSO Compensation (Kompensimi ndërmjet OST-ve)
<b>KE</b>	Komuniteti i Energjisë
<b>KEDS</b>	Kompania Kosovare për Distribuim me energji elektrike (Kosovo Electricity Distribution and Services)
<b>KEEJL</b>	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KESCO</b>	Kompania për furnizim me energji elektrike e Kosovës (Kosovo Electricity Supply Company)
<b>KESH</b>	Korporata Energjetike e Shqipërisë
<b>KfW</b>	Banka Gjermane për Zhvillim
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>km</b>	Kilometër

<b>KOSTT</b>	Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut
<b>KPSC</b>	Komisioni Rregullativ për Shërbime Publike Kentucky
<b>kV</b>	Kilovolt
<b>kW</b>	Kilovat
<b>LP</b>	Largpërçues
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MBE</b>	Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MVA</b>	Megavoltamper
<b>MW</b>	Megavat
<b>MWh</b>	Megavatorë
<b>MW<sub>TH</sub></b>	Megavat termik
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>NARUC</b>	National Association of Regulatory Utility Commissioners (Asociacioni Nacional i Komisionarëve të ndërmarrjeve Rregullative)
<b>NJA</b>	Njësia e administratës
<b>NQ</b>	Ngrohje Qendrore
<b>NS</b>	Nënstacioni
<b>OSSH</b>	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
<b>OST</b>	Operator i Sistemit të Transmetimit
<b>OT</b>	Operator Tregu
<b>PECI</b>	Projects of Energy Community Interest (Projekti i Interesit të Komunit. Energjisë)
<b>PRR</b>	Periodha rregullative
<b>RAB</b>	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
<b>RoR</b>	Rate of Return (Norma e kthimit)
<b>SAIDI</b>	Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem
<b>SAIFI</b>	Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem
<b>SCADA</b>	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
<b>SKE</b>	Energy Community Secretariat (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë)
<b>TAP</b>	Trans-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
<b>TC</b>	Termocentral
<b>TF</b>	Task Forcë
<b>TKE</b>	Traktati i Komunitetit të Energjisë
<b>TM</b>	Tensioni i Mesëm
<b>TR</b>	Transformator
<b>TU</b>	Tensioni i Ulët
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>UA</b>	Udhëzimi administrativ
<b>USAID</b>	United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar)
<b>WACC</b>	Weighted Average Cost of Capital (Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit)
<b>WBIF</b>	Western Balkans Investment Framework (Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor)

**ZK** Zona Kadastrale  
**ZRRE** Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori)

## 1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm Rregullatori), në përputhje me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), paraqet Raportin Vjetor për vitin 2019 për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Raporti Vjetor përmban informata mbi aktivitetet në lidhje me fushëveprimin e Rregullatorit, si dhe funksionimin e sektorit të energjisë, duke analizuar të dhënat e të licencuarve, përfshirë edhe zhvillimin e tregut të energjisë në Kosovë.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti financiar i buxhetit të Rregullatorit për vitin 2019.

Rregullatori bënë hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e energjisë, bazuar në kërkesat që dalin nga ligjet primare dhe obligimet që rrjedhin nga Komuniteti i Energjisë, ku Kosova është pjesëmarrëse në Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Hartimi dhe rishikimi i legjislacionit sekondar nga ana e Rregullatorit, bëhet duke aplikuar konsultime publike ku mund të japin qëndrimet e veta palët e treta.

Më tej paraqitet një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të Rregullatorit dhe zhvillimeve në sektorin e energjisë, duke filluar me obligimet, përgjegjësitë, strukturën organizative dhe financimin e Rregullatorit.

- Aktiviteti i rëndësishëm i Rregullatorit është licencimi i ndërmarrjeve energjetike për prodhim, furnizim/tregtim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë. Bordi i Rregullatorit ka lëshuar licenca për prodhim të energjisë ndërmarrjes Hidroenergji, Kelkos Energy, Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-për TC Kosova A – vazhdim licence) dhe në proces të shqyrtimit është aplikacioni i ContourGlobal Kosova.

Për furnizim të energjisë elektrike është lëshuar licenca për ndërmarrjen Enerco LLC.

Rregullatori, përmes formave të ndryshme të përkrahjes përfshirë skemën mbështetëse dhe prioritetin në dispeçim i kushton kujdes të veçantë zhvillimit të projekteve të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE-ve). Projektet për zhvillimin e BRE-ve realizohen përmes autorizimeve të lëshuara nga Rregullatori, ku gjatë vitit 2019 Rregullatori ka lëshuar 22 autorizime preliminare, 2 autorizime finale, ka modifikuar 4 autorizime finale dhe 3 aplikacione janë në proces të shqyrtimit. Në proces të ndërtimit janë 4 projekte me turbina me erë, disa projekte të hidrocentraleve të vogla si dhe një projekt nga biomasa.

Poashtu, gjatë vitit 2019 janë lëshuar 20 vendime për ndërtimin e gjeneratorëve për vetë-konsum.

- Gjatë vitit 2019, Rregullatori ka vazhduar me monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara të energjisë përfshirë edhe tregun e energjisë.

Raporte të monitorimit gjenden të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së.

- Rregullatori ka bërë shqyrtimin e aplikacioneve të licencuarve për të hyrat e lejuara dhe tarifatat në sektorin e energjisë elektrike, për transmetimin, shpërndarjen, blerjet e energjisë me shumicë dhe furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale, si dhe shqyrtimin e aplikacionit tarifor për energjinë termike.

- Në shkurt 2019, Bordi i Rregullatorit ka certifikuar Operatorin e Sistemit të Transmisionit, duke përmbyllur kështu procesin e certifikimit i cili është vlerësuar i suksesshëm edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
- Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve Rregullatori gjatë vitit 2019 ka pranuar 75 ankesa të reja nga konsumatorët, ndërsa ka zgjidhur 263 ankesa përfshirë edhe ato nga vitet paraprake.
- Në kuadër të aktiviteteve të veta të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me institucionet tjera, Rregullatori ka bërë raportime në Kuvendin e Kosovës, dhe ka pasur takime me komisionet parlamentare dhe ka bërë marrëveshje me Odën e Afarizmit të Kosovës.  
Gjatë vitit 2019 janë realizuar nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë si Komisionin Rregullativ për Energji dhe Ujë (ERC) të Republikës së Maqedonisë Veriore dhe me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të bashkëpunimit me NARUC janë shtjelluar çështjet për konsumatorët në nevojë dhe sigurinë kibernetike.
- Në realizimin dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj, Rregullatori ka marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë si pjesëmarrëse në grupet punuese për energji elektrike, gaz, konsumatorë dhe tregje me pakicë, si dhe për REMIT dhe siguri kibernetike.
- Rregullatori financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe gjatë vitit 2019 ka realizuar të hyra në shumë prej 1,329,192.29 €, ndërsa ka shpenzuar 699,215.18 € dhe pjesa e pashpenzuar në shumë prej 629,977.11 € janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pjesa e dytë e raportit përmban aktivitetet e të licencuarve në sektorin e energjisë ku analizohen veçmas energjia elektrike, energjia termike dhe gazi natyror.

- Në sektorin e energjisë elektrike raporti përmban të dhënat për tregun e energjisë elektrike, prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, kërkesën, humbjet, furnizimin, importet, eksportet dhe çmimet e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë.
  - Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2019 ka qenë 5,718 GWh, prej të cilave 5,404 GWh janë nga termocentralet, ndërsa nga HC dhe BRE tjera janë 314 GWh, dhe ka një ngritje prej 7.7% krahasuar me prodhimin në vitin 2018.
  - Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2019 ka qenë 6,001 GWh, që paraqet një rritje prej 5.8% në krahasim me kërkesën në vitin 2018 .
  - Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm 1.25 % ndaj energjisë së futur në transmetim.
  - Humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Humbjet teknike janë 12.84 %, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (më tutje në tekst humbjet komerciale) përbëjnë 13.04 % të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pa faturuar në katër komunat veriore të Kosovës përbënë 5.53 % (294 GWh). Furnizimi i konsumatorëve në vitin 2019 përfshinë furnizimin e konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal dhe konsumatorëve të parregulluar. Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm është rreth 57%, ndërsa me 43% marrin pjesë konsumatorët tjerë.



2019	Ngarkesa	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi
	MWh	MWh	€	€
Konsumatorët e rregulluar (shpërndarje)	5,321,999	3,944,315	278,206,817	276,721,423
Konsumatorët e parregulluar (transmetim)	573,713	573,713	27,801,482	27,801,482
Gjithsej	5,895,713	4,518,028	306,008,300	304,522,905

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është 5.68 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është 7.33 €cent/kWh.

- Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2019 krahasuar me bilancin e vitit 2019 dhe me realizimin në vitin 2018, prej nga shihet se për balancimin e sistemit-furnizim ndaj kërkesës është paraqitur nevoja për importe dhe eksporte.

	Njësia	Prodhimi	Kërkesa	Importi	Eksporti	Humbjet	
						Transmetim	Shpërndarje
<b>Realizimi 2019</b>	<b>GWh</b>	<b>5,718</b>	<b>6,001</b>	<b>928</b>	<b>905</b>	<b>105</b>	<b>1,378</b>
Bilanci 2019	GWh	5,696	5,627	693	650	110	1,341
Realizim/Bilanc	%	100.38	106.65	133.98	139.23	95.90	102.71
Realizimi 2018	GWh	5,311	5,686	1,242	880	118	1,464
Raporti 2019/2018	%	107.66	105.54	74.76	102.84	89.40	94.10

- Sa i përket sektorit të energjisë termike situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Projekti i kogjenerimit në NQ Termokos ka dhënë rezultate të mira duke ngritur cilësinë e ngrohjes për konsumatorët e kyçur në rrjet, ndërsa projekti i kogjenerimit në NQ Gjakova është në proces të realizimit.
  - Prodhimi i energjisë termike në vitin 2019, në NQ Termokos ka qenë 235 GWh<sub>Th</sub>, ndërsa në NQ Gjakova 9,1 GWh<sub>Th</sub>;
  - Konsumi i energjisë termike në vitin 2019, në NQ Termokos ka qenë 210 GWh<sub>Th</sub>, ndërsa në NQ Gjakova 6.9 GWh<sub>Th</sub>;
  - Humbjet e energjisë termike në vitin 2019, në NQ Termokos ka qenë 8.44 % (vetëm për rrjetin primarë të shpërndarjes), ndërsa në NQ Gjakova 20 %.
- Në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe treg i gazit natyror, mirëpo ligjet e energjisë dhe strategjia e energjisë parashohin zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes (kyçjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, përmes projektit të gazsjellësit TAP ("Trans-Adriatik-Pipeline" – Gazsjellësi Përtej Adriatikut) dhe Projektit të interkonekcionit të gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë.

## 2 ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) është agjenci e pavarur dhe e ndarë në aspektin ligjor dhe funksional nga çdo person tjetër fizik a juridik. Detyrat dhe funksionet e Rregullatorit janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, të cilat përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve dhe dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përkujdesen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme dhe në bazë të metodologjisë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurrese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.

Rregullatori është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kornizës rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë, me qëllim që të arrihet pajtueshmëri me detyrimet e Traktatit të KEEJL-së dhe harmonizimit me *“acquis communautaire”* për energji, për të siguruar qasje jo diskriminuese të të gjithë shfrytëzuesve të rrjetit të energjisë me çmime që reflektojnë shpenzimet e vërteta ekonomike.

### 2.1 Bordi i Rregullatorit

Bordi i Rregullatorit përbëhet nga pesë (5) anëtarë përfshirë kryesuesin, të cilët emërohen me orar të plotë të punës nga Kuvendi i Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar. Bordi i Rregullatorit është organ vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e Rregullatorit. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm por duhet të ketë tri (3) vota pro për të qenë vendimi i plotfuqishëm. Bordi paraqet qëndrimet e veta rreth çështjeve që trajtohen përmes vendimeve, të cilat merren në mbledhje të hapura dhe të njoftuara qysh më parë në faqen zyrtare të Rregullatorit.

Nga maji i vitit 2017 Bordi i ZRRE-së operon me ushtrues detyre për kryesuesin e bordit por ka kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.

Me 31 dhjetor 2019 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji përbëhej nga anëtarët si në vijim:

*Arsim Janova, Ushtrues detyre i kryesuesit;*

*Besim Sejfiqaj, anëtar;*

*Selman Hoti, anëtar; dhe*

*Izet Rushiti, anëtar.*

Për qëllime të vendimmarrjes, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur takime të vazhdueshme, në të cilat është diskutuar lidhur me funksionimin e sistemit energjetik në Kosovë dhe janë marrë vendime adekuate si dhe aprovime/miratime të dokumenteve të nevojshme për sektorin.

Bordi i ZRRE-së deri në dhjetor të vitit 2019 ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) mbledhje publike, në të cilat janë marrë 134 vendime që kanë të bëjnë me:

- Monitorimin e tregut dhe aktiviteteve të sektorit të energjisë;
- Liberalizimin e tregut të energjisë;

- Rregullimin e çmimeve;
- Licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë;
- Autorizimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë nga Burimet e Ripërtrishme;
- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Arovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve tjera të sektorit të energjisë, dhe
- Çështje të tjera në kuadër të përgjegjësive të tij.

Pjesa më e madhe e dokumenteve të shqyrtuara dhe të miratuara fillimisht janë vënë në diskutim publik, ashtu siç parashihet me ligj, për të përfshirë të gjitha palët e involvuara në proceset e vendimmarrjes dhe janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Për të gjitha aktivitetet, Bordi është mbështetur nga: Drejtori menaxhues, Njësia administrative dhe pesë (5) departamente si në vijim:

- Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)
- Departamenti i tregut të energjisë (DTE)
- Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)
- Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)
- Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Bordi i ZRRE-së ka përkrahur ngritjen profesionale të stafit të ZRRE-së duke synuar specializimin e punonjësve në profilet përkatëse në kuadër të përgjegjësive të tyre, përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

## 2.2 Struktura organizative dhe burimet njerëzore

Rregullatori është i organizuar në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Kreu II i Ligjit) dhe Manualin e Operimeve të Rregullatorit. Bordi i Rregullatorit sipas përgjegjësive të përcaktuara me ligj kryen aktivitete si në vijim:

- Miraton politikat rregullative dhe operacionale të Rregullatorit;
- Organizon dhe mbikëqyr punën e Rregullatorit;
- mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Rregullatorit dhe miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- Organizon procedurat e rekrutimit dhe mbikëqyr punën e personelit të punësuar nga Rregullatori;
- Miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e Rregullatorit;
- Harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Rregullatorin e energjisë.

Struktura organizative e Rregullatorit është e përcaktuar nga Bordi i Rregullatorit bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat që parashihen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Struktura bazë përbëhet nga Drejtori menaxhues, Zyrtarja për asistencë të Bordit, Zyrtarja për marrëdhënie me

publikun, pesë departamente dhe Njësia e administratës (NJA) të cilat janë themeluar në pajtim me detyrat operationale të Rregullatorit.

### **2.2.1 Drejtori Menaxhues**

Drejtori menaxhues i koordinon aktivitetet midis Bordit dhe stafit profesional dhe administrativ; është përgjegjës për implementimin e të gjitha vendimeve të Bordit të Rregullatorit, në mënyrë aktive informon dhe këshillon Bordin për zhvillimet në sektorin Energjetik, mbështet Bordin e Rregullatorit për të siguruar që të gjitha aktivitetet e Rregullatorit janë kryer në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat e Rregullatorit si dhe mbikëqyrë punën e departamenteve të Rregullatorit. Drejtori menaxhues i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Bordit, në pajtim me Manualin e operimeve të Rregullatorit.

### **2.2.2 Departamentet e Rregullatorit**

Departamentet udhëhiqen nga udhëheqësit e departamenteve, të cilët organizojnë, kontrollojnë, planifikojnë, bashkëpunojnë, vlerësojnë stafin e tij/saj dhe mbajnë përgjegjësi për aktivitetet dhe përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara për punën e departamenteve. Udhëheqësi i departamentit është përgjegjës për delegimin e punëve të përditshme të stafit të departamentit.

Roli i anëtarëve të stafit të departamenteve është të kryejnë detyra, kurdo që është e nevojshme sipas kërkesave ligjore dhe përmes udhëheqësve të departamenteve i propozojnë në Bord. Në disa raste, anëtarët e stafit mund të autorizohen nga Bordi të kryejnë detyra të posaçme.

Anëtarët e stafit duhet të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin e departamentit dhe stafin tjetër profesional. Anëtari i stafit po ashtu duhet të ketë mundësi në ndjekjen e trajnimeve të disponueshme nga Rregullatori, për përmirësimin e aftësive dhe njohurive të tyre profesionale.

#### ***Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)***

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit sekondar, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënien e autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

#### ***Departamenti i tregut të energjisë (DTE)***

Departamenti i tregut të energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e performancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

#### ***Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)***

Departamenti i tarifave dhe çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara, monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes shqyrtimeve tarifore, ndërmerr të gjitha masat që tarifatat të jenë kosto - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente, duke marrë në konsiderim përballueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

### **Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)**

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat, të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

### **Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)**

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror është përgjegjës për shqyrtimin dhe implementimin e strategjive, standardeve të performancës dhe praktikave tjera operacionale, që kanë të bëjnë me këta sektorë. Ky departament kryen monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara përmes mbledhjes, analizës dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave përkatëse, e gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sistemeve raportuese të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore duke u fokusuar në elementet tekniko-teknologjike dhe në integrimin e masave nxitëse dhe caqeve për eficiencë. Po ashtu bashkëpunon me departamentet tjera të Rregullatorit duke dhënë mbështetjen dhe ekspertizën teknike për çështjet e ndërlidhura me energjinë termike dhe gazin natyror.

### **Njësia e administratës (NJÄ)**

Njësia e administratës mbështet funksionimin e Rregullatorit, organizon rekrutimin efikas të stafit të Rregullatorit, koordinon trajnimet e stafit të Rregullatorit, furnizimin me pajisje të zyrës dhe mirëmbajtjen e tyre, ndihmon në rregullimin e zyrës, duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e Rregullatorit.




Fig. 2.1 Skema organizative e Rregullatorit

Përshkrimi i shkurtër i strukturës organizative me vendet e punës në vitin 2019 është dhënë në tabelën më poshtë.

*Tab. 2.1 Struktura organizative*

Pozitat e vendeve të punës	Pozitat e planifikuara	Punësuar	Vendet e lira
<b>Bordi i ZRRE-së</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
<b>Drejtor menaxhues</b>	1	1	0
Zyrtare për marrëdhënie me publikun	1	1	0
Zyrtare për asistencë të Bordit	1	1	0
<b>Njësia e administratës</b>			
Udhëheqëse e njësisë së administratës			
Zyrtar kryesor financiar			
Menaxhere e prokurimit			
Zyrtare e administratës			
Zyrtar për menaxhimin e të dhënave	9	9	0
Ekspert për zhvillim të bazës së të dhënave			
Përkthyes i gjuhës angleze			
Recepionist			
Mirëmbajtës/Vozitës			
<b>Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)</b>			
Udhëheqës i dpt. ligjor dhe të licencimit			
Ekspert për çështje ligjore dhe të monitorimit	3	3	0
Analiste për çështje ligjore dhe monitorim të licencave			
<b>Departamenti i çmimeve dhe Tarifave (DTÇ)</b>			
Udhëheqës i dpt. për çmime dhe tarifa			
Ekspert ekonomik për çështje rregullative dhe të tarifave	4	4	0
Analist për tarifa dhe çmime			
Analist për strukturë tarifore			
<b>Departamenti i tregut të energjisë (DTE)</b>			
Udhëheqës i dpt. për treg të energjisë			
Analiste për furnizim me energji dhe strukturë të tregut	4	4	0
Analist për sisteme elektroenergjetike			
Analist për monitorim të tregut			
<b>Departamenti për gaz dhe energji termike (DGET)</b>			
Udhëheqës i dpt. për energji termike dhe gaz	2	2	0
Analiste për energji termike			
<b>Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK)</b>			
Udhëheqës i dpt. për mbrojtje të konsumatorëve			
Zyrtar për mbrojtje të konsumatorëve	3	2	0
Analist për përbushje të standardeve			1
<b>Gjithsej</b>	<b>33</b>	<b>31</b>	<b>2</b>

Personeli i Rregullatorit është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësi që ata mbulojnë.

Ky kombinim eksperiencash inxhinierike, ekonomike, juridike dhe të tjera e përforcon besimin për një institucion me strategji të qartë drejt suksesit në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.

## 2.3 Financimi i Rregullatorit

Rregullatori financohet nga të hyrat e dedikuara, që mblidhen nga taksat e inkasuara nga të licencuarit në bazë të nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Rregullatori mbledh të hyra nga:

- Taksat fillestare dhe vjetore të licencimit;
- Taksat nga aplikacionet për lëshimin dhe modifikimin e licencave;
- Taksat për lëshimin e certifikatave të origjinës;
- Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, të gjitha taksat e lartpërmenduar janë të hyra të dedikuara të Rregullatorit.

Nëse vlerësohet se të hyrat e dedikuara të Rregullatorit janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve totale të kërkuara për kryerjen efektive të obligimeve, Rregullatori mund të kërkojë një ndarje buxhetore plotësuese për ta mbuluar mungesën. Gjithashtu në pajtim me këtë Ligj, nëse taksat e mbledhura i tejkalojnë parashikimet e Rregullatorit, ato derdhen në buxhetin e shtetit.

### 3 AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

#### 3.1 Licencimi i aktiviteteve të energjisë

Tanimë është e ditur se asnjë aktivitet energjetik nuk mund të kryhet në Kosovë pa pasur licencë të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Të gjitha llojet e aktiviteteve për të cilat ndërmarrjet duhet të pajisen me licencë, janë të përshkruara në legjislacionin në fuqi, më konkretisht në Nenin 28 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Sipas këtij Neni (paragrafit 2) dhe po ashtu sipas Nenit 3 (paragrafit 1) të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, datë 31.03.2017), deri më tani Rregullatori ka lëshuar licenca për këto aktivitete: prodhimin e energjisë elektrike; prodhimin e energjisë termike; bashkëprodhimin të energjisë elektrike dhe termike; transmetimin e energjisë elektrike përfshirë operimin e sistemit të transmetimit; shpërndarjen e energjisë elektrike duke përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes; shpërndarjen e energjisë termike; furnizimin me energji elektrike dhe energji termike, duke përfshirë transitin, importin ose eksportin e energjisë elektrike; furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike; si dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Përveç licencave të sipërpërmendura, me ligjet në fuqi lejohen të kryhen disa aktivitete energjetike pa pasur nevojë të aplikojnë në Rregullator për licencë, e të cilat nuk kanë ndikim shumë të madh në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Pra aktivitetet të cilat nuk kanë nevojë për licencë janë:

- prodhimi i energjisë elektrike në lokacionin energjetik me kapacitet që nuk tejkalon 5 MW;
- prodhimi i energjisë termike të prodhuar nga ngrohtoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon 1 MW;
- prodhimi i energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmetimit apo shpërndarjes.

Që nga themelimi e deri më tani Rregullatori ka licencuar rreth shtatëdhjetë (70) ndërmarrje për aktivitetet të ndryshme të energjisë, ku rreth katërdhjetë (40) kanë ende licenca aktive.

Gjatë këtij viti fokusi i ndërmarrjeve që kanë aplikuar për licencim ka qenë në licencim të prodhimit të energjisë elektrike, kryesisht nga burime të ripërtërishme të energjisë (uji), mandej furnizim me energji elektrike, dhe vazhdim licence.

Për dallim nga vitet tjera, për herë të gjatë këtij viti në Rregullator nuk ka aplikuar asnjë ndërmarrje për licencim të aktivitetit të Furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike.

##### 3.1.1 Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike

Sipas Nenit 29 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, prodhimi i energjisë për gjeneratorët që janë me kapacitet më të madh se 5 MW nuk mund të bëhet pa pasur licencë të lëshuar nga Rregullatori.

Si rrjedhojë e kësaj, Rregullatori në vazhdimësi pranon aplikacione për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike (nga linjiti, era, uji, solare etj.), e që vlen të përmendet se gjatë këtij viti, për dallim nga vitet tjera Rregullatori ka lëshuar katër (4) licenca (të përkohshme) për prodhim të energjisë elektrike nga hidrocentralet, ku procesi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve po ashtu është udhëhequr nga Rregullatori përmes rregullës së procedurës së autorizimit për ndërtim të



kapaciteteve të reja. Po ashtu këtë vit në Rregullator ka aplikuar një aplikues për prodhim të energjisë elektrike nga linjiti (qymyri) dhe një aplikues për vazhdim licence.

Ndërmarrjet që janë pajisur me licencë (të përkohshme) për prodhim të energjisë elektrike, u është vazhduar licenca dhe atyre që janë në proces të licencimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, mund ti gjeni të tabelën si më poshtë.

*Tab. 3.1 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca dhe janë në proces të licencimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike*

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"Hydroenergjia" SH.P.K. (HC Lepenci 3)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_63/18	Rr. Dëshmorët e Kombit, P.N. Ferizaj, Republika e Kosovës	05.06.2019 - 04.06.2020 Licencë e përkohshme
2	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Deçani)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_49/16	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	14.10.2019 - 13.10.2020 Licencë e përkohshme
3	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Belaje)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_50/16	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	14.10.2019 - 13.10.2020 Licencë e përkohshme
4	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Lumbardhi II)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_64/18	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	14.10.2019 - 13.10.2020 Licencë e përkohshme
5	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. (TC Kosova A)	Prodhim i energjisë elektrike (nga linjiti)	ZRRE/Li_05/17_A	Rr. "Nëna Terezë" Nr 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	04.10.2019- 04.10.2020-Vazhdim Licence
6	"ContourGlobal Kosovo" L.L.C.	Prodhim i energjisë elektrike (nga linjiti)	ZRRE/Li_66/19	Rr. Anton Çeta, 5A, 10000 - Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces të licencimit

**Hydroenergjia SH.P.K** – ka aplikuar në Rregullator për licencë të prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali Lepenci 3, me datë 20 dhjetor 2018, për kapacitet të instaluar prej **9.98 MW**.

Bordi i Rregullatorit me datë 05 qershor 2019, me vendimin V\_1140\_2019, ndërmarrjes në fjalë i ka lëshuar licencë të përkohshme, duke obliguar ndërmarrjen që brenda afatit të përcaktuar në vendim të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të vendimit.

**Kelkos Energy SH.P.K** – kjo ndërmarrje ka aplikuar në rregullator për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, për tri (3) njësi prodhuese nga:

- hidrocentrali Deçani me kapacitet prej **8.06 MW**
- hidrocentrali Belaje me kapacitet prej **9.8 MW** dhe
- hidrocentrali Lumbardhi II me kapacitet prej **6.2 MW**

Për dy njësitë e para ka aplikuar me datë 24 shkurt 2016, ndërsa për njësinë e fundit ka aplikuar me datë 21 dhjetor 2018. Në mungesë të dokumentacionit të kompletuar, nuk është marrë vendim për licencim të kësaj ndërmarrjeje deri në vitin 2019. Kështu Bordi i Rregullatorit gjatë këtij viti, më konkretisht me datë 14 tetor 2019, me vendimin V\_1182\_2019, V\_1183\_2019, dhe V\_1184\_2019, ndërmarrjes në fjalë i ka lëshuar licencë të përkohshme për të tri hidrocentralet, duke obliguar ndërmarrjen që brenda afatit të përcaktuar në vendim të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të vendimit.

Lëshimi në operim i këtyre hidrocentraleve (Lepenci 3, Deçani, Belaje dhe Lumbardhi II), shton kapacitetet prodhuese në Kosovë nga burimet e ripërtërishme (mbi 5MW) në total prej **34.04MW**.

**Korporata Energjetike e Kosovës** SH.A Divizioni i Gjenerimit, Termocentrali Kosova A – edhe këtë vit, si edhe vitet tjera, KEK ka aplikuar për vazhdimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga linjiti (qymyri) deri me 04.10.2022, ndërsa të njëjtës i është vazhduar licenca nga Bordi i Rregullatorit për periudhën kohore prej 04.10.2019 deri më 04.10.2020.

Sa i përket vazhdimin të licencës, kohëzgjatja e çdo licence mund të zgjatet për një periudhë kohore që nuk e tejkalon periudhën relevante kohore të licencës aktuale, duke nënkuptuar që i licencuari arrin t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe detyrimet e licencës dhe të ketë parashtruar një kërkesë me shkrim për vazhdimin e licencës aktuale.

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.** – përveç aplikimit për prodhim të energjisë nga burime të ripërtërishme të energjisë, Rregullatori me 20.06.2019 ka pranuar një aplikacion me disa dokumente mbështetëse për prodhim të energjisë nga linjiti (qymyri) me kapacitet të instaluar prej 500MW. Aplikacioni është në proces të shqyrtimit dhe i njëjti do të vlerësohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

### 3.1.2 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me energji elektrike

Për dallim nga vitet paraprake, ku interesimi për licencim të këtij aktiviteti ka qenë shumë më i lartë, gjatë këtij viti kemi vetëm një ndërmarrje (Enerco LLC. SH.P.K.e) cila me 05 mars 2019 ka aplikuar dhe me 16 prill 2019 është licencuar për furnizim me energji elektrike, përkundër kësaj, ende nuk ka kryer ndonjë furnizim të konsumatorëve me energji elektrike.

As kjo ndërmarrje e as shtatë (7) ndërmarrje të licencuara më parë (HEP Energjia KS SH.P.K, GSA ENERGJI SH.P.K., FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., JAHA COMPANY SH.P.K., SharrCem SH.P.K, dhe dhe Korporata Energjetike e Kosovës SH.A) përveç KESCO nuk kanë hyrë në treg për të furnizuar konsumatorët me energji elektrike. Pra i tërë furnizimi i konsumatorëve në vend me energji elektrike edhe gjatë vitit 2019 është bërë nga KESCO, njëjtë si edhe vitet paraprake.

Tab. 3.2 Ndërmarrjet që janë licencuar për aktivitet të furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2019

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	Enerco LLC. SH.P.K.	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_65/19	Bregu i diellit, Hyzri Talla 11/4, Prishtinë, Republika e Kosovës	16.04.2019-15.04.2024 lëshim licence

Kohëzgjatja e licencës së furnizimit përcaktohet varësisht nga gjendja financiare e aplikantit me kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh, ndërsa sa i përket ndërmarrjes Enerco LLC. SH.P.K Bordi i Rregullatorit i ka lëshuar licencë për periudhë pesë (5) vjeçare në pajtim me nenin 32 të ligjit për rregullatorin e energjisë.

Rregullatori merr vendim për secilin aplikacion për licencë, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike, pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar.

Vlen të përmendet se gjatë këtij viti nuk ka pasur ndonjë aplikim për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, kështu që tregtimi i energjisë elektrike është kryer disa ndërmarrje që janë të licencuara nga Rregullatori i Energjisë si dhe nga ndërmarrjet tjera, të

licencuara në ndonjërin nga palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Sipas ligjit për energji elektrike, licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike pa pasur nevojë për licencë shtesë. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale.

### 3.2 Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)

Me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081 në fuqi është përcaktuar politika e BRE-së, e cila ka për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të BRE-ve, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit e cila është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës.

Për zbatimin e politikave të BRE-ve, Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi ka përcaktuar me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga BRE në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit Evropian për BRE.

Me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 është përcaktuar se ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (BRE), sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit sipas këtij ligji, e cila do të ndërmerret nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në përputhje me kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Për të përmbushur obligimet ligjore për të arritur cakun e detyrueshëm për BRE deri në vitin 2020, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 me të cilin ka përcaktuar caqet vjetore dhe afatgjate të Energjisë nga BRE.

Udhëzimi Administrativ ka përcaktuar se, caku i detyrueshëm nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë deri në 2020, është 25 % të konsumit përfundimtar bruto të energjisë siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë Nr. D/2012/04/MC –EnC.

Vlen të theksohet se Kosova është palë nënshkruese e Traktatit e për Themelimin e Komuniteti të Energjisë e cila është nënshkruar me datë 25 tetor 2005, e ratifikuar dhe ka hyr në fuqi me 01 korrik 2006 dhe ka filluar të implementohet me 1 korrik 2007. Në bazë të kësaj Kosova ka marrë obligime ligjore për të përmbushur të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë ku është paraparë edhe obligimi i detyrueshëm për arritjen e caqeve të BRE-ve deri në 2020.

Shtojca I e këtij Udhëzimi Administrativ 05/2017 ka përcaktuar kapacitetet e Energjisë Elektrike nga BRE (MW), Ku Niveli i caqeve të përcaktuara për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe të pranuar në Skemën Mbështetëse është si në tabelën në vijim:

*Tab. 3.3 Caqet e përcaktuara për kapacitetet nga BRE*

Kapaciteti i energjisë elektrike nga BRE					
Burimi primar i energjisë	2016	2017	2018	2019	2020
Fotovoltaike	6	7	8	9	30
Erë	1	61	115	129	150
HC të vogla	40	57	181	187	240
Biomasë	6	8	10	12	20

### 3.2.1 Skema mbështetëse ekzistuese për burimet e ripërtrishme të energjisë

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), si institucioni i pavarur që rregullon sektorin e energjisë në Kosovë, zbaton procedurën e autorizimit për zhvillimin e projekteve për BRE, lëshon licencat dhe kushtet për funksionimin e këtyre projekteve, dhe harton Skema Mbështetëse për të ndihmuar në financimin dhe realizimin e tyre.

Rregulla për Skemën Mbështetëse përcakton parimet aktuale të mbështetjes ose subvencionimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtrishme të energjisë të cilat përndryshe nuk do të ishin në gjendje që të konkurrojnë në tregun me shumicë.

Për të qenë i kualifikuar për Skemën Mbështetëse, një objekt gjenerues BRE duhet të prodhojë energji elektrike nga një prej burimeve primare të ripërtrishme të energjisë, duhet të jetë i vendosur brenda territorit të Kosovës dhe duhet të pajiset me stabilimente gjenerimi të reja dhe të papërdorura.

Gjatë shqyrtimit të aplikimit të tyre për pranim, ZRRE-ja i referohet caktimit të detyrueshëm specifik të teknologjisë 2020 të përcaktuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e burimeve të ripërtrishme të energjisë gjithashtu përcakton madhësinë maksimale të një projekti të vetëm të pranueshme për skemë si:

- 3 MW për PV,
- 14 MW për biomasë,
- 35 MW për erë dhe
- 10 MW për hidro

Aktualisht, **Tarifa nxitëse është e vetmja skemë mbështetëse** që përdorë stimujt financiar për të arritur caqet për BRE. Kushtet për të marrë këtë mbështetje përjashtojnë lloje të tjera të stimujve financiarë që do të përdoren njëkohësisht për projektin e njëjtë. Tani për tani nuk ka as stimuj të zbritjeve tatimore e as të kostove të importit për burimet e ripërtrishme të energjisë për gjenerimin e energjisë elektrike.

Kosova, ngjashëm me shumicën e vendeve në rajonin e Evropës Juglindore (SEE), krijoi skemën mbështetëse të saj të bazuar në tarifën nxitëse. Megjithatë, për shkak të kufizimeve financiare dhe mungesës së reagimit të shpejtë ndaj çmimeve në rënie të teknologjisë së BRE-së, efikasiteti i skemave mbështetëse aktuale është vënë në pikëpyetje. Ekziston një nevojë që të shqyrtohet kthimi drejt skemave mbështetëse të bazuara në treg, kryesisht primet nxitëse dhe procedura konkurruese të ofertimit/tenderimit (ankandeve), në mënyrë që të rritet kosto-efikasiteti dhe të kufizohen shtrembërimet konkurruese. Ky trend është përshpejtuar nga rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore që udhëzojnë një futje graduale të proceseve të ofertave konkurruese dhe parashikojnë

një zëvendësim gradual të tarifës nxitëse me primet nxitëse, i cili gjithashtu do të jetë një qasje e detyrueshme edhe për anëtarët e Komunitetit të Energjisë.

Kur të merret parasysh një skemë mbështetëse e përshtatshme për BRE-të, duhet të ndiqen katër parimet themelore në përcaktimin e skemës mbështetëse më të përshtatshme për BRE-të: efektivitetin, efikasitetin, praktikën dhe efektet e jashtme të një skeme mbështetëse.

Duke marrë parasysh përfitimet dhe disavantazhet e caktuara në forma të ndryshme të mbështetjeve të BRE-ve, primet nxitëse dhe ankandet janë mekanizmat mbështetës për BRE-të më të miratuarat e që janë të bazuara në treg dhe çmim..

Mekanizmat mbështetës të BRE-ve të cilat nuk konsiderohen si mekanizma të bazuara në çmime janë gjithashtu të rëndësishme që të merren parasysh nga politikëbërësit, por zakonisht konsiderohen si diçka që plotëson mekanizmat e bazuar në çmim. Prandaj, në mënyrë që të arrihen caqet e planifikuara për BRE, duhet të zbatohet gradualisht një kombinim i mekanizmave mbështetës por komplementare financiare dhe jo-financiare (d.m.th., instrumente të politikave) për të mbështetur zhvillimin dhe vendosjen e BRE-ve.

Për të vendosur politikën e duhur të sektorit të BRE-ve për Kosovën, faza aktuale e liberalizimit të tregut duhet të merret parasysh. Ekzistojnë faktorë kufizues të njohur në vendet me kushte të ngjashme të tregut si në Kosovë, megjithatë, udhëzimet e përgjithshme që duhen ndjekur kur të përcaktohet një skemë mbështetëse janë:

- Kufizimet e mbështetjes financiare - vendimmarrësit përgjegjës duhet të kufizojnë mbështetjen financiare në atë që është e nevojshme për të siguruar konkurrencën e gjenerimit të BRE-ve në treg
- Fleksibiliteti - Skema mbështetëse për BRE-të duhet të jetë në gjendje të reagoj ndaj kostove në rënie të teknologjisë
- Integriteti dhe transparenca - vendimmarrësit duhet të shmangin çdo ndryshim të paparalajmëruar ose retroaktiv

Megjithëse ankandet duhet të sigurojnë efikasitet dhe efektivitet më të madh në sektorin e BRE-ve, rreziqet e mëposhtme potencialisht mund të ndodhin:

- Rreziku i procesit të tenderimit të pasuksesshëm. Çdo proces i tenderimit kërkon shumë kohë dhe ka kosto të konsiderueshme për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë në një proces të tillë.
- Rreziku i dështimit për të përfunduar projektin nga prodhuesi fitues mund të ndikojë në efektivitetin dhe dështimin në arritjen e caqeve të detyrueshme.

Rreziqet e lartpërmendura mund të zbuten duke zgjedhur elementet e duhura të dizajnit të ankandit. Një ndër elementët më të rëndësishëm për zbutjen e rrezikut ku paraqiten premiumet nxitëse, ankandet dhe ofertat konkurruese janë kufizimet e çmimeve në më të larta dhe më të ulëta, të cilat janë kufizime që nuk lejojnë as primin ose çmimin për energjinë elektrike të gjeneruar nga BRE të shkojë mbi ose nën vlerat e paracaktuara.

Ankandet, në përgjithësi nuk organizohen për centralet e vogla të energjisë elektrike për shkak të kostove të larta të përgatitjes së dokumentacionit për ofertim. Për këta prodhues, rekomandohet qasja administrative në përcaktimin e tarifës nxitëse ose premiumit nxitës. Ngjashëm, ankandet nuk

janë mjaft të përshtatshme për tregjet pa konkurrencë të zhvilluar ose ku tregjet dominohen nga një entitet i vetëm.

Në mënyrë që të vazhdohet tutje me një skemë të re mbështetëse për BRE-të bazuar në kushtet konkurruese, autoritetet e Kosovës duhet të analizojnë të gjitha aspektet relevante në mënyrë që të përcaktojnë një rrugë të përshtatshme për të vazhduar tutje në një transformim gradual drejt mekanizmave mbështetës të tregut. Për zgjedhjen e mekanizmit mbështetëse të përshtatshëm dhe elementëve të tij, autoritetet duhet të rishikojnë dhe eventualisht të përshtatin kornizën ligjore dhe rregullative. Është e rëndësishme të theksohet se futja e mekanizmit të ri nuk duhet të ketë ndonjë ndikim në të gjitha kontratat aktuale MBE të nënshkruara sipas skemës aktuale mbështetës.

#### **Faktet kryesore që karakterizojnë Skemën Mbështetëse për BRE:**

- Gjeneratorët nga BRE nënshkruajnë Marrëveshje për Blerje të Energjisë të vlefshme për 10-12 vjet, varësisht nga teknologjia.
- Mbështetja përmes Tarifave Nxitëse ofrohet për një kornizë rregullative të besueshme dhe të testuar ndaj stresit për të mbështetur koston shtesë të prodhimit nga BRE-të.
- Gjeneratorët BRE kanë të drejtën e dispeçimit prioritar për të gjithë prodhimin e energjisë elektrike përgjatë tërë vlefshmërisë së MBE-së dhe kompensohen për energjinë elektrike të liferuar.
- Gjeneratorët nga BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse janë përgjegjës vetëm për 25% të kostove të tyre të jobalanceve të shkaktuara.

### **3.2.2 Nxitja e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE**

Kosova është një nga shtetet të cilat të gjithë mekanizmin e përkrahjes financiare për burimet e ripërtitshme, deri më tani e ka mbështetur tek Zyra e Rregullatorit për Energji, e cila ka krijuar mekanizma të skemës mbështetëse të BRE-ve në bazë të caqeve të vendosura nga Qeveria e Kosovës për plotësimin e obligimeve ligjore që ka marrë në raport me Komisionin Evropian. Kështu Kosova ka pas cakun obligativ që deri në vitin 2020, të arrijë që 25 % e konsumit të brendshëm të jetë nga BRE-të. Si rrjedhojë, Rregullatori ka trajtuar me mjaft kujdes këtë obligim, duke krijuar mekanizma të përshtatshëm dhe të parashikueshëm për kohën dhe rrethanat ekonomiko-sociale të Kosovës. Mekanizmat e krijuara nga Rregullatori për mbështetjen e BRE-ve kanë rezultuar mjaft efikas, duke mbuluar në masë të madhe caqet në teknologji të ndryshme me aplikacione për investime, dhe kohë pas kohe i ka përshtatur këtyre mekanizmave ndryshimet ligjore dhe kushtet e të bërit biznes në Kosovë dhe rajon.

Mund të themi që sektori i energjisë, duke përfshirë edhe energjinë e ripërtitshme, mbetet një nga hallkat më atraktive për investime në Kosovë, falë mekanizmave të lartcekur. Si rezultat, niveli i investimeve në BRE gjatë viteve të fundit është rritur ndjeshëm, ku vetëm në vitin 2019 vlerësohet të jenë investuar rreth 35 milion euro në kapacitetet gjeneruese me 24.9 MW nga teknologjia e ujit dhe 3.4 MW kapacitet i instaluar me panele solare.

Për periudhën 2013 -2019 janë investuar këto kapacitete prodhuese nga BRE sipas teknologjive të paraqitura në tabelën në vijim, e të cilat janë futur në operim deri në fund të vitit 2019.

*Tab. 3.4 Kapacitetet e instaluarat të BRE-ve sipas teknologjisë*

Kapacitetet e instaluarat prodhuese nga BRE 2013-2019	
BRE	MW
Era	33.75
Fotovoltaike	10
Hidrocentrale të vogla	50.02
Biomasa	0
Gjithsej	93.77

Tarifat nxitëse (Feed-in) janë një mekanizëm për nxitjen e investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, të cilat aplikohen në vendet në zhvillim, si dhe në vendet e zhvilluara (BE-së, SHBA-së dhe më gjerë). Duke qenë si një nevojë e domosdoshme e promovimit të investimeve në BRE, edhe Kosova ka adaptuar Tarifën Nxitëse (Feed in Tariff) si mekanizmin kryesor mbështetës.

Në tabelën në vijim janë paraqitur tarifat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, sipas teknologjive.

*Tab. 3.5 Tarifat nxitëse të BRE-ve sipas teknologjisë*

Tarifat nxitëse të aplikueshme për BRE	
BRE	€/MWh
Era	85.00
Fotovoltaike	136.40
Hidrocentrale të vogla	67.47
Biomasa	71.30

Implementimi i skemës mbështetëse të tarifës nxitëse bëhet i mundur përmes Fondit të BRE-ve që menaxhohet nga Operatori i Tregut. Vlera financiare e fondit të parashikuar për vitin 2019 ka qenë rreth 13.74 milion euro. Sipas trendit të investimeve në BRE, pritet që fondi i BRE-ve të rritet në vitet në vijim.

Meqenëse caqet e BRE sipas obligimeve ndërkombëtare dhe Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës për Promovimin e BRE-ve janë të kufizuara, atëherë Rregullatori është kujdesur që të krijoj një kornizë rregullative për të gjithë investitorët potencial për investime në teknologji të BRE jashtë skemës së Tarifës Nxitëse. Kjo kornizë ju garanton prioritet në dispeçim të energjisë dhe çmime të tregut, të gjithë gjeneratorëve jashtë skemës së tarifës nxitëse.

Rregullatori gjithashtu ka zhvilluar edhe skemën mbështetëse për gjeneratorët për vetë-konsum të BRE. Qëllimi kryesor i kësaj skeme është nxitja e konsumatorëve që të investojnë në mikro-gjeneratorë me anë të të cilëve do të mbulonin një pjesë të konsumit të tyre.

### **3.3 Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja**

ZRRE, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me zbatimin e procedurës së autorizimit, shqyrtimin e aplikacioneve për lëshimin e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), për shoqëritë që kanë aplikuar për marrjen e autorizimit.

ZRRE në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të caktuara me legjislacionin në fuqi, ka lëshuar Autorizime Finale për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, ku çdo aplikues për marrjen e autorizimit iu është nënshtruar analizës së rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, teknik, financiar dhe mjedisor, si dhe marrjes së lejeve përkatëse, për përdorim e ujit në rastet e hidrocentraleve, të drejtën e shfrytëzimit të tokës, zgjidhjet teknike të kyçjes dhe pëlqimin mjedisor, të lëshuara nga institucionet relevante në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar për marrjen Autorizimit final për lejin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në BRE.

Gjatë vitit 2019 ZRRE nga subjektet e ndryshme juridike ka pranuar 17 aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Janë pranuar dhe shqyrtuar 2 kërkesa për shndërrimin e Autorizimit Preliminar në Autorizim Final nga burimet e energjisë së erës dhe biomasa. Gjatë këtij viti ka pasur kërkesa për Modifikim të Autorizimit Final.

### 3.3.1 Lëshimi i autorizimit preliminar

ZRRE gjatë këtij viti ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e pranuar nga subjektet juridike dhe se kanë dëshmuar përshtatshmërinë e tyre për ndërtimin e stabilimenteve të reja, porse nuk kanë plotësuar ende kërkesat që dalin nga legjislacioni në fuqi, ka lëshuar Autorizime Preliminare për kompletimin e aplikacioneve dhe për marrje të Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i Autorizimet Preliminare të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së sipas Burimeve të ndryshme gjatë vitit 2019.

*Tab. 3.6 Autorizimet preliminare të BRE-ve*

Autorizime prliminare nga BRE	Nr. i vendimeve të lëshuara
Energjia solare	22
Gjithsej	22

ZRRE për ka lëshuar Autorizime Preliminare për 22 projekte nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitetit të instaluar është rreth 66 MW, janë konsideruar me vendimi si aplikacione “në pritje” për tu pranuar në Skemën Mbështetëse.

Aplikuesit që i kanë përmbushur kërkesat dhe kriteret e përcaktuara për lëshimin e Autorizimit Preliminar, gjatë këtij viti Bordi i ZRRE-së i ka lëshuar njëzetedy (22) autorizime preliminare( “në pritje”. Në vazhdim janë paraqitur shoqëritë të cilave iu është lëshuar Autorizimi preliminar (shih tabelën 3.7 më poshtë).



*Tab. 3.7 Shoqërive të cilave u është lëshuar Vendimi për Autorizim Preliminar*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Autorizimit Preliminar
1	KPOWER SH.P.K.	Solare	Projekti KSOL -Sverrk- Pejë	33 MW	28 janar 2019
2	EDK SH.P.K.	Solare	Projekti SUNPOWER 1 – Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
3	EDK SH.P.K.	Solare	Projekti SUNPOWER 2 – Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
4	JAHA EXTRA BETON SH.P.K.	Solare	Projekti DUKASONNE 1 Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
5	JAHA EXTRA BETON SH.P.K.	Solare	Projekti DUKASONNE 2 Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
6	PERLAT SH.P.K.	Solare	Projekti ALPHA POWER Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
7	EDK SH.P.K.	Solare	Projekti SUNPOWER 3 – Sverrk Pejë	3 MW	28 janar 2019
8	N.T.SH. ELING	Solare	Projekti SOLAR Llabjan Pejë	3 MW	28 janar 2019
9	D-ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti D-ENERGY 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
10	D-ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti D-ENERGY 2 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
11	D-ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti D-ENERGY 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
12	BP SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti SOLAR 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
13	BP SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti SOLAR 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
14	BP SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti SOLAR 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
15	ALPHA SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti ALPHA SOLAR 1 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
16	ALPHA SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti ALPHA SOLAR 2 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
17	ALPHA SOLAR L.L.C.	Solare	Projekti ALPHA SOLAR 3 Pejë	3 MW	05 qershor 2019
18	SUN ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti SUN ENERGY 1 Sverrk Pejë	3 MW	05 qershor 2019
19	SUN ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti SUN ENERGY 2 Sverrk Pejë	3 MW	05 qershor 2019
20	SUN ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti SUN ENERGY 3 Sverrk Pejë	3 MW	05 qershor 2019
21	SUN ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti SUN ENERGY 4 Sverrk Pejë	3 MW	05 qershor 2019
22	SUN ENERGY SH.P.K.	Solare	Projekti SUN ENERGY 5 Sverrk Pejë	3 MW	05 qershor 2019

Krahasuar me vitin 2018, ku ZRRE kishte lëshuar trembëdhjetë (13) Autorizime Preliminare, gjatë vitit 2019, janë lëshuar njëzetedy (22) vendime për Autorizime Preliminare me kapacitet total të instaluar prej 66 MW, të cilat kanë qenë jashtë caqeve të BRE-ve, dhe janë konsideruar si “aplikacione në pritje”, sipas dispozitave ligjore të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për gjeneratorët e BRE-ve.

### 3.3.2 Aplikacionet që janë në proces të shqyrtimit në Rregullator

ZRRE, gjatë këtij viti ka pranuar aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të cilat janë në fazën e kompletimit të aplikacioneve. Në vazhdim është paraqitur lista e aplikacioneve, të cilat janë në proces të shqyrtimit.

*Tab. 3.8 Shoqëritë që janë në proces të shqyrtimit për marrjen e vendimit për autorizim preliminar*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Aplikimit
1	ECODRI SH.P.K.	Hidrocentral	HC ECODRI-me digë), Prizren	9.56 MW	18 korrik 2019
2	SHARR PLANINA VODE SH.P.K.	Hidrocentral	HC SHARR PLLANINA 1, Dragash	1.65 MW	29 korrik 2019
3	SHARR PLANINA VODE SH.P.K.	Hidrocentral	HC SHARR PLLANINA 2, Dragash	2.2 MW	29 korrik 2019

ZRRE ka vlerësuar aplikacionet për lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore për plotësimin e caqeve të BRE-ve, të përcaktuara me udhëzimet në fuqi, dhe pas kompletimit do t'i lëshoj Autorizimet Preliminare për aplikuesit e lartcekur.

### 3.3.3 Lëshimi i autorizimit përfundimtar (final)

ZRRE gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar aplikacionet për lëshimin e Autorizimit Final, së bashku me dokumentacionin e kompletuar për shndërrimin e vendimit mbi njoftimin për autorizimin preliminar në Autorizim final për ndërtim.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i Autorizimet Finale të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së sipas Burimeve të ndryshme gjatë vitit 2019.

*Tab. 3.9 Autorizimet finale të BRE-ve*

Autorizime finale nga BRE	Nr. i vendimeve të lëshuara
Turbina të Erës	1
Biomasa	1
<b>Totali</b>	<b>2</b>

Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës është lëshuar 1 Autorizim Final dhe 1 Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Biomasa me kapacitet total të instaluar prej 12.2 MW, nga të cilat:

- 1 autorizim nga Turbinat të Erës me kapacitet 11 MW
- 1 autorizim nga Biomasa me kapacitet 1.2 MW

Në tabelën e mëposhtme janë paraqiten subjektet juridike të cilave iu është lëshuar Autorizimi Final për Ndërtim të Kapaciteteve të reja Gjeneruese (shih tabelën më poshtë).

*Tab. 3.10 Shoqërive të cilave iu është lëshuar autorizim final për ndërtim*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Autorizimit Final
1	NP NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVA	Biomasa	Rezina, Gjakova	1.2 MW	27 nëntor 2019
2	BOND – COM ENERGY POINT SH.P.K.	Turbina të Erës	Wind Park – BUDAKOVA, Suhareka	11 MW	26 dhejtor 2019

Projektet e lartcekura priten të realizohen brenda periudhës afateve të përcaktuara sipas planit dinamik të realizimit të projekteve në pajtim me kushtet të Autorizimit.

### 3.3.4 Modifikimi i Autorizimit Final

ZRRE gjatë këtij viti ka pranuar kërkesa për Modifikimit e Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Kërkesat e tilla pas kompletimit me dëshmitë relevante të lëshuara nga Institucionet relevante në Republikën e Kosovës janë vlerësuar dhe janë shqyrtuar nga Bordi i ZRRE-së, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur subjektet juridike të cilave iu është lejuar Modifikimi i Autorizimit Final për kapacitet e instaluar për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE.

*Tab. 3.11 Shoqërive të cilave iu është modifikuar autorizimi final*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Modifikimit të Autorizimit Final
1	KelKos Energy SH.P.K	Hidrocentral	HC Lumbardhi II.	6.2 MW	28 mars 2019
2	SOWI KOSOVO L.L.C.	Turbina të Erës	WIND PARK SELAC 1	34.47 MW	10 korrik 2019
3	SOWI KOSOVO L.L.C.	Turbina të Erës	WIND PARK SELAC 2	34.47 MW	10 korrik 2019
4	SOWI KOSOVO L.L.C.	Turbina të Erës	WIND PARK SELAC 3	34.47 MW	10 korrik 2019

Modifikimi i Autorizimit final nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., është kërkuar për Hidrocentralin HC Lumëbardhi II për kapacitetin instalues nga 5.5 MW i Autorizuar me vendimin V-568-2013 të datës 24 tetor 2013, dhe të modifikuar me Vendimin V-1122-2019 të datës 28 mars 2019 në kapacitetin instalues 6.2 MW, komuna e Deçanit, duke i plotësuar kërkesa mjedisore dhe ujore. Ndërsa Modifikimi i Autorizimit Final sipas Vendimeve V-980-2018, V\_981\_2018 dhe V\_982\_2018 i datës 13 qershor 2018 të lëshuar shoqërisë SOWI KOSOVO L.L.C. nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 34.5 MW në kapacitetin instalues prej 34.47 MW dhe reduktimin e numrit të turbinave nga dhjetë (10) në nëntë (9) turbina është lejuar me Vendimet V-1164-2019, V\_1165\_2019 dhe V\_1166\_2019 i datës 10 korrik 2019 në përputhje me Lejet Ndërtimore të lëshuar nga MMPH. Këto Modifikimi janë lejuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore të legjislacionit në fuqi.

### 3.3.5 Projektet në proces të ndërtimit sipas Autorizimit Final

Projektet të cilat janë duke u ndërtuar sipas planit dinamik të realizimit dhe sipas afateve të përcaktuara me Rregullën Nr. 11/2017 për Procedurës së Autorizimit, janë katër (4) projekte nga Turbinat e Erës ku 103.4 MW me gjithsej njëzeteshtatë (27) turbina, në Parkun e Erës në Bajgora të Komunës së Mitrovicës, dhe projekti Parku i Erës Budakova me kapacitet prej 11 MW me gjithsej tri (3) turbina janë duke u ndërtuar në Budakovë të Suharekës. Poashtu, në proces të ndërtimit janë edhe disa projekte të vogla nga hidrocentralet ku sipas dinamikës së punime priten të realizohen në viteve në vijim, si dhe projekti i parë nga Biomasa me kapacitet prej 1.2 MW energji elektrike dhe 15 MW energji termike e cila do të realizohet nga NP Ngrohtorja e Qytetit – Gjakova, projekt i financuar nga Komisionin Evropian.

### 3.3.6 Hyrja në operim e gjeneratorëve nga BRE

Gjatë këtij viti pas finalizimit të projekteve sipas Autorizimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe pas pranimit teknik kanë hyr në operim komercial shtatë (6) projekte, me fuqi totale të instaluar prej 28.3 MW.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur projektet të cilat kanë hyr në operim komercial për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE.

*Tab. 3.12 Shoqëritë të cilat kanë hyrë në operim*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Hyrjes në Operim
1	N.T. SH. ELING	Solare	Llabjan, Pejë	0.4 MW	23 mars 2019
2	EUROKOS JH SH.P.K.	Hidrocentral	HC Brodi 3- Dragash	4.7 MW	08 maj 2019
3	N.T.N. RENELUAL TAHIRI SH.P.K.	Hidrocentral	HC Orqusha	4 MW	04 qershor 2019
4	HIDROENERGJI SH.P.K.	Hidrocentral	HC Lepenci 3- Kaçanik	9.98 MW	19 qershor 2019
5	SOLAR GREEN ENERGY SH.P.K.	Solare	Novosellë, Kamencia,	3 MW	18 shtator 2019
6	KELKOS ENERGY SH.P.K.	Hidrocentral	HC Lumbardhi II - Deçan	6.2 MW	31 dhjetor 2019


*Fig. 3.1 Pamje nga Godina e HC Lepenci 3, Kaçanik*

*Fig. 3.2 Pamje nga Parku Solar/fotovoltaik, Novosellë, Kamencia*

Projektet hidrike dhe nga panelet solare/fotovoltaike janë në operim komercial, janë finalizuar Marrëveshjet për Blerje të Energjisë për prodhimin e Energjisë elektrike nga BRE, marrëveshjet janë nënshkruar për periudhën kohore prej dhjetë (10) vite për prodhim të energjisë nga hidrocentralet dhe dymbëdhjetë (12) vite për prodhim të energjisë nga panelet solare/fotovoltaike me KOSTT/OT.

### 3.4 Gjeneratorët për vetë-konsum

ZRRE, gjatë këtij viti ka trajtuar edhe kërkesat/aplikacionet për gjeneratorët për marrjes e statusit të konsumatorit prodhues për vetë-konsum, të cilat pas plotësimit të kërkesave ligjore në pajtim me Rregullën e Autorizimit dhe Skemën mbështetëse, janë lejuar për të vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i vendimeve të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së, për gjeneratorët për vetë-konsum gjatë vitit 2019.

*Tab. 3.13 Autorizimet për vetë-konsum*

Vendime për vetë-konsum	Nr. i vendimeve të lëshuara
Solare	20
Gjithsej	20

Në tabelën e mëposhtme janë paraqiten subjektet juridike të cilave iu është lëshuar vendimi për autorizimin për ndërtim të gjeneratorëve për vetë-konsum.

*Tab. 3.14 Shoqëritë të cilave iu është lëshuar vendimi për ndërtim të gjeneratorëve për vetë-konsum*

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Vendimit
1	IADK	Solare	Sfaraçak I Ultë, Vushtrri	10 kW	20 janar 2019
2	Person Fizik	Solare	Gjakova	4.88 kW	20 janar 2019
3	Person Fizik	Solare	Prishtinë	5 kW	16 prill 2019
4	Person Fizik	Solare	Ceceli/Vushtrri	5 kW	05 qershor 2019
5	NTSH TIK –TAC –SERVICE&SUPPLY	Solare	Shkugza/Gjakova	4.8 kW	05 qershor 2019
6	Person Fizik	Solare	Leshan/Peja	5 kW	05 qershor 2019
7	DYZI BERRY FRUITS SH.P.K.	Solare	Dyz/Podujeva	25 kW	05 qershor 2019
8	BESIANA – G SH.P.K.	Solare	Izvor/Novobërda	5 kW	05 qershor 2019
9	BESIANA – G SH.P.K.	Solare	Prelez/Ferizaj	69 kW	10 korrik 2019
10	Person Fizik	Solare	Orllat/Drenas	3 kW	28 gusht 2019
11	Person Fizik	Solare	Zllatar/Prishtinë	5 kW	28 gusht 2019
12	N.T.P. AMG	Solare	Balloç/Podujeva	30 kW	14 tetor 2019
13	DONI FRUITS SH.P.K.	Solare	Z. Industriale/Shtime	49.92 kW	14 tetor 2019
14	OBRICO SH.P.K.	Solare	Graqanica	30 kW	14 tetor 2019
15	Person Fizik	Solare	Prishtinë	9.9 kW	14 tetor 2019
16	BALLKAN PETROL SH.P.K.	Solare	Gërlaç/Ferizaj	100 kW	27 nëntor 2019
17	AGROPRODUKT SH.P.K.	Solare	Sine/Istog	64 kW	27 nëntor 2019
18	Person Fizik	Solare	Dujak/Gjakova	5 kW	27 nëntor 2019
19	Person Fizik	Solare	Pagarush/Malishevë	2 kW	27 nëntor 2019
20	DRENA SH.P.K.	Solare	Skenderaj	75 kW	26 dhjetor 2019

Projektet e lartcekura priten të realizohen brenda periudhës së përcaktuar sipas planit dinamik të realizimit të projekteve në pajtim me kushtet teknike të kyçe.

ZRRE, poashtu ka pranuar edhe kërkesa tjera nga personat fizik dhe juridik, të cilat janë në faza të ndryshme të kompletimit dhe sipas procedurave në fuqi, pas kompletimit do të lejohen në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga gjeneratorët për vetë-konsum.

### 3.5 Harmonizimi i Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë nga BRE

ZRRE, gjatë vitit 2019 me kërkesë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të institucioneve tjera financiare ndërkombëtare, ka rishikuar Marrëveshjen për Blerje të Energjisë për gjeneratorët e BRE-ve, ku pas analizimit, vlerësimit dhe konsultimit me të gjitha palët e interesit dhe institucionet e vendit, ka aprovuar këtë Marrëveshje, e cila në Nëntor 2019 është nënshkruar mes

BERZH/SOW /KOSTT për financimin dhe realizimin e projektit të ndërtimit të tre (3) gjeneratorëve nga BRE/era, me kapacitet të instaluar prej 105MW, i cili projekt konsiderohet ndër më të mëdhenjtë në Ballkan e që financohet nga BERZH.

ZRRE, gjatë vitit 2019, ka hartuar dhe aprovuar Marrëveshjen për Blerje të Energjisë për gjeneratorët me vetë-konsum. Me këtë është plotësuar tërë korniza rregullative/ligjore për trajtimin e këtyre gjeneratorëve për vet-konsum apo që ndryshe njihen si konsumatorëve prodhues, dhe me këtë është përmbushur edhe kushti i fundit i Rregullës për Skemën Mbështetëse nga BRE, dhe trajtimi i energjisë së prodhuar nga gjeneratorët për vetë-konsum.

### 3.6 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë

Një ndër kompetencat kryesore të Rregullatorit të energjisë lidhur me mbikëqyrjen/monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë, janë të dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, e posaçërisht me Kreun XII, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjislacionin sekondar

Kështu, Rregullatori, si edhe viteve tjera edhe këtë vit ka vazhduar me monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara për aktivitetet e energjisë, duke u siguruar nëse ndërmarrjet janë duke vepruar në pajtueshmëri me kushtet e licencës, zbatimin e rregullave, akteve individuale dhe vendimeve tjera të lëshuara nga rregullatori apo legjislacioni tjetër në fuqi. Monitorimi bëhet duke kërkuar raporte dhe të dhëna nga të licencuarit, duke mbajtura takime, si dhe duke vizituar (monitoruar) të licencuarit, me apo pa paralajmërim.

Edhe gjatë vitit 2019, Rregullatori ka monitoruar ndërmarrjet e licencuara të energjisë, posaçërisht ato mbi 5 MW, por po ashtu ka monitoruar edhe ndërmarrjet që janë në proces të ndërtimit përmes procedurës së autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja.

Raportet e detajuara mbi monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë publikohen ueb faqe të Rregullatorit.

#### 3.6.1 Monitorimi i tregut të energjisë elektrike

Me gjithë liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, për mbarëvajtjen dhe funksionimin të rregullt dhe evitimin parregullsive dhe diskriminimit të pjesëmarrësve të sektorit të energjisë është e nevojshme që të bëhet monitorim i vazhdueshëm i tregut të energjisë. Rregullatori, është përgjegjës për monitorimin e operimit të tregjeve të energjisë.

Rregullatori në vazhdimësi monitoron tregun e energjisë në përgjithësi përmes raporteve ditore, mujore, etj., sipas kërkesave ligjore. Ky monitorim përfshinë prodhimin, kërkesën dhe humbjet e energjisë elektrike sipas kategorive të ndryshme, si dhe importet dhe eksportet e energjisë elektrike. Për të gjeturat e këtyre monitorimeve përgatiten raporte kuartale interne, ndërsa në fund të vitit të gjitha këto përmbledhen në raportin vjetor të ZRRE, i cili publikohet në faqen elektronike të ZRRE.



### 3.6.2 Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese

Rregullatori, gjatë këtij viti, ka bërë monitorimin e subjekteve juridike që janë të pajisura me Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, e të cilat janë në faza të ndryshme të ndërtimit.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria HIDROENERGJI SH.P.K., për projektin HC Lepenci 3 i Autorizuar me Vendimin V-755-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, ZK Kaçanik, Komuna e Kaçanikut. Projekti HC Lepenci 3, është përfunduar, dhe ka hyr në operim komercial.

Hidrocentrali HC Vica, sipas dinamikës së punimeve të realizuara në teren, pritet që të finalizohet në fillim të vitit 2019, ndërsa projektet HC Shtërpca dhe HC Sharri janë në faza të ndryshme të ndërtimit.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria HIDROENERGJI SH.P.K., për projektin HC Lepenci 1 i Autorizuar me Vendimin V-754-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, ZK Uji i Tharët, Komuna e Hanit të Elezit. Ky projekt është vonuar në realizim për shkak të ndërtimit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria EUROKOS JH SH.P.K., për projektin HC Brodi 3 i Autorizuar me Vendimin V-870-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, ZK Kukalane, Komuna e Dragashit. Projekti HC Brodi 3, është përfunduar, dhe ka hyr në operim komercial.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria N.T.N. RENELUAL TAHIRI SH.P.K., për projektin HC Orqusha i Autorizuar me Vendimin V-891-2017, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, ZK Orqusha, Komuna e Dragashit. Ky projekt është finalizuar dhe ka hyr në operim komercial.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria Matkos Group SH.P.K., për projektet HC Vica, HC Shtërpca dhe HC Sharri, të Autorizuara me Vendimet V-640-2014, V-759-2016 dhe V-760-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentralet, me kapacitet total të instaluar tri (3) projektet prej 16 MW, ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës. Këto projekt janë në faza të ndryshme të realizimit.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria SOLAR GREEN ENERGY SH.P.K., për projektin e Autorizuar me Vendimin V-838-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Novosellë, Komuna e Kamenicës. Ky projekt është finalizuar dhe ka hyr në operim komercial.

ZRRE ka monitoruar edhe punimet në realizimin e projekteve nga shoqëria SOWI KOSOVO L.L.C. për projekt Wind Park SELAC1, SELAC 2 dhe SELAC 3, të autorizuar me Vendimet V-980-2018, V\_981\_2018 dhe V\_982\_2018 i datës 13 qershor 2018, ku sipas planit dinamik priten të vendoset njëzeteshtatë (27) turbina për prodhimin e energjisë elektrike nga Era.

Po ashtu, ZRRE ka monitoruar edhe projektet tjera që janë duke u realizuar sipas vendimeve mbi Autorizimet Finale, e të cilat janë në faza të ndryshme të ndërtimit sipas afateve ligjore të dhëna me vendimet përkatëse. Monitorimi i tyre është bërë në vazhdimësi varësisht nga kërkesat që janë dal gjatë implementimit të tyre.



ZRRE do të vazhdojë me monitorimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

### **3.6.3 Monitorimi sipas Doracakut të Raportimit në Sektorin e Energjisë**

Sipas këtij doracakut, ndërmarrjet e licencuara të energjisë kanë dërguar në Rregullator raporte të menjëhershme, tremujore, apo vjetore, varësisht nga kërkesat e përshkruara në këtë doracak apo kërkesa tjera të Rregullatorit. Për disa nene të licencës, të një rëndësie më të veçantë, pra shkelje të kushteve të licencës që mund të kenë ndikim serioz mbi politikën qeveritare, të konsumatorëve ose në koston për kompensim, i licencuari duhet ta njoftojë menjëherë Rregullatorin. Në rast se një njoftim i tillë nuk bëhet me kohë, Rregullatori ka të drejtë të vendos masa administrative ose gjoha në pajtim me Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Duke marrë parasysh raportet e dërguara gjatë vitit 2019, rregullatori nuk ka vendosur ndonjë masë administrative apo gjobë për të licencuarit.

Në vijim janë paraqitur në pika të shkurtra disa nga monitorimet e kryera nga Rregullatori për ndërmarrjet e energjisë, gjatë vitit 2019.

### **3.6.4 Monitorimi në vend i Programit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin 2018**

Ky program është në fuqi që nga viti 2015 (V\_750\_2015), i cili është i aprovuar nga Bordi i Rregullatorit. Zyrtari i Pajtueshmërisë i KEDS, çdo vit ka raportuar në Rregullator lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë program. Deri më tani nuk ka pasur nevojë të shqiptohet masa apo gjoha ndaj të licencuarit lidhur me zbatimin e këtij programi. Megjithatë, për funksionim më të mirë të tij, Rregullatori gjatë monitorimit të këtij programi gjatë vitit 2019, ka kërkuar nga KEDS që ky program të modifikohet dhe përafrohet me legjislacionin aktual, kështu që KEDS ka dërguar këtë program të modifikuar, i cili pritet të aprovohet nga Bordi i Rregullatorit gjatë vitit 2020.

### **3.6.5 Monitorimi i investimeve kapitale në KOSTT dhe KEDS për vitin 2018**

Siguria e furnizimit me energji elektrike dhe kualiteti i saj varen nga niveli i shpenzimeve operative dhe kapitale. Për këtë qëllim ZRRE gjatë periudhave rregullative lejon nivel të caktuar të investimeve kapitale duke u bazuar në projektet e planifikuara. Për të parë se si janë implementuar projektet e tilla, ZRRE në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të saj, bënë monitorimet e nevojshme. Në këtë kuadër me anë të vendimit VB\_114\_2018 të bordit të ZRRE-së është themeluar edhe grupi punues për monitorim të investimeve kapitale të të licencuarve KOSTT dhe KEDS.

Për realizimin e këtij procesi, grupi monitorues përmes komunikimeve me shkrim dhe të vizitave në teren është fokusuar në monitorimin e aspektit procedural, teknik dhe financiar. Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij monitorimi është bërë duke përzgjedhur projektet sipas rastësisë e të cilat janë të natyrave të ndryshme. Për këtë qëllim grupi punues ka kërkuar nga të licencuarit dosjet e projekteve përkatëse.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të projekteve të përzgjedhura, grupi monitorues ka nxjerr rezultate të cilat për nga natyra janë të matshme (kuantitative) dhe kualitative. Në përgjithësi mund të themi se pas analizimit të dosjeve dhe vizitave në teren, i licencuari KOSTT procesin procedural dhe teknik e ka kryer në pajtueshmëri me kërkesat e përgjithshme teknike dhe procedurale si dhe ka ofruar dëshmi për projektet e përzgjedhura, ndërsa i licencuari KEDS ka shpjeguar procesin teknik dhe procedural por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme.

Në pajtim me të gjeturat nga raporti i monitorimit, Bordi i ZRRE-së ka bërë njoftimin për mos pajtueshmëri duke njoftuar palët për mos pajtueshmërinë me kornizën rregullative dhe ka dhënë vërejtjet për përmirësim.

Hollësitë nga raporti i monitorimit të investimeve kapitale për KOSTT dhe KEDS për vitin 2018 mund të gjinden në raportin e publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së në linkun:

[http://ero-ks.org/2019/Raportet/Monitorimi%20i%20investimeve%20kapitale%20KOSTT%20dhe%20KEDS\\_Qershor%202019.pdf](http://ero-ks.org/2019/Raportet/Monitorimi%20i%20investimeve%20kapitale%20KOSTT%20dhe%20KEDS_Qershor%202019.pdf)

### 3.6.6 Monitorimi i ofrimit të shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO

Rregullatori konform dispozitave ligjore të dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë gjatë vitit 2019 ka bërë monitorimin e ankesave dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve për Furnizuesin - KESCO dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes – KEDS. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Rregullatori gjatë monitorimit të të licencuarve KESCO dhe KEDS lidhur me ankesat e konsumatorëve dhe fushat tjera në mbrojtjen e konsumatorëve janë:

1. Sigurimin e të dhënave në fushën e ofrimit të shërbimeve për konsumatorët nga Furnizuesi - KESCO dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS;
2. Vizita të grupit punues të Rregullatorit në tre distrikte: Prishtinë, Ferizaj dhe Mitrovicë;
3. Sigurimin e të dhënave (mostrave) nga vendi i ngjarjes në distriktet e lartpërmendura;
4. Analizimin e të gjitha të dhënave të siguruara nga KESCO dhe KEDS-i;
5. Konstatimet e nxjerra nga të dhënat e siguruara nga KESCO dhe KEDS-i.

Grupi punues i Rregullatorit bazuar në të dhënat dhe informatat e pranuar nga KESCO dhe KEDS, ka përgatitur Raportin final të ofrimit të shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO për periudhën janar – dhjetor 2018, ku përshkruhen në mënyrë të detajuar të gjitha proceset që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve nga KEDS dhe KESCO.

Në Raportin e ofrimit të shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO për periudhën janar – dhjetor 2018 janë monitoruar këto fusha:

- Kyçjet/lidhjet e reja dhe Pëlqimet Elektroenergjetike;
- Ndërrimi i njehsorëve elektrik;
- Zbatimi i shkyçjeve dhe rikyçjeve;
- Zbatimi i procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike;
- Leximi i konsumatorëve;
- Ankesat e konsumatorëve

Në Raportin final të ofrimit të shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO, përveç analizave të bëra të të dhënave dhe proceseve të marra nga të dy të licencuarit, ka paraqitur edhe të gjeturat për secilën fushë të monitorimit, si dhe ka paraqitur edhe rekomandimet konkrete për të licencuarit KEDS dhe KESCO e që kanë të bëjnë me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për konsumatorët.

Rekomandimet e ZRRE-së për KESCO dhe KEDS, janë si në vijim:

**a) Lidhjet e reja dhe Pëlqimet Elektroenergjetike**

- Pikat 7 dhe 8 të dhëna në Pëlqimin Elektroenergjetik nga KEDS, e të cilat kanë të bëjnë me operimin, mirëmbajtjen, faturimin e konsumatorëve, si dhe dorëzimin e objekteve energjetike, duhet të jenë unifikuese për të gjithë aplikuesit dhe të jenë sipas dispozitave ligjore të legjislacionit primar dhe sekondar.
- KEDS duhet të kompensojë të gjithë konsumatorët të cilët i ka ngarkuar në Pëlqimet Elektroenergjetike për pagesën e grupit matës ose edhe vendosjen e grup matësit nga vet konsumatori, ngase sipas nenit 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike: “Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”.

**b) Ndërrimet e njehsorëve**

- Kërkesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me shqyrtimin e njehsorëve, përkatësisht saktësinë e matjes së njehsorit, duhet të respektohen nga KEDS dhe ato të bëhen në përputhje me Kodin e Matjes;
- Asnjë përgjigje të cilat kanë të bëjnë me ankesat e konsumatorëve lidhur me dyshimin në matjen e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik, KESCO të mos i lëshoj pa u realizuar shqyrtimi i saktësisë së atij njehsori elektrik.

**c) Shkyçjet dhe rikyçjet e konsumatorëve**

- KEDS-i të mos realizojë shkyçjen e konsumatorëve në asnjë rast, për vlerat e kontestuara ashtu siç përcaktohet në nenin 17 të Rregullës për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë.
- KEDS-i çdo procesverbali zyrtar duhet t’i dorëzojë konsumatorëve te objekti i banimit.

**d) Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike**

- Udhëzohet KESCO/KEDS që për rastet e lidhjeve të reja fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike duhet të përcaktohet bazuar në kërkesën e konsumatorit dhe të bëjë përpjekje për sigurimin e informatave për kohëzgjatjen e llogaritjes së shfrytëzimit të paautorizuar.
- Udhëzohet KEDS-i që të vazhdojë të avancojë edhe më tutje trajnimin e punëtorëve të autorizuar për inspektimin e pikave matëse për mënyrën e plotësisë, si dhe përmbajtjen e procesverbaleve të inspektimit/kontrollës me qëllim që të paraqitet sa më saktë dhe qartë gjendja faktike dhe masat e ndërmarra gjatë inspektimit, në të kundërtën procesverbalet e tilla mund të konsiderohen si të pavlefshme.

**e) Ankesat e konsumatorëve**

- KESCO dhe KEDS duhet që të respektojnë nenin 6, paragrafi 4, të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, dhe të dërgojnë për shqyrtim dhe aprovim në ZRRE procedurën e tyre të brendshme për trajtimin e ankesave të konsumatorëve të harmonizuar sipas Rregullës së lartcekur.
- KESCO duhet të përmirësojë përgjigjet ndaj ankesave të konsumatorëve, të cilat përgjigje duhet të hartohen konform nenit 10 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të respektojë afatet ligjore konform nenit 9, paragrafi 3; si dhe të respektojë dispozitën e nenit 12, paragrafi 4 të rregullës së lartë cekur, që ka të bëjë me sigurimin e dokumenteve për konsumatorin.
- KEDS për ankesat e konsumatorëve lidhur me pëlqimet elektroenergjetike dhe për ankesat për qasje/kyçje në rrjet, të lëshoj përgjigje me shkrim konsumatorëve/aplikuesve për kyçje konform nenit 10 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Bordi i Rregullatorit në seancën e datë 28.08.2019 ka shqyrtuar Raportin e ofrimit të shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO për periudhën janar – dhjetor 2018, së bashku me rekomandimet e paraqitura në raport, si dhe ka vendosur që për të gjeturat e monitorimit të njoftohen operatorët dhe të vazhdohet me procedurat e parapara në Programin e monitorimit.

### **3.6.7 Njoftimi për mospajtueshmëri (Të gjeturat dhe vendimet e Bordit lidhur me monitorimet e ndërmarrjeve)**

Bordi i Rregullatorit në mbledhjen e mbajtur me 28.08 2019, bazuar në të gjeturat e provuara dhe rekomandimet e prezantuara në raportet e monitorimit të grupeve punuese të Rregullatorit, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka vendosur që të obligoj të licencuarit KEDS dhe KESCO që në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga data e pranimit të këtij njoftimi të informojë Bordin lidhur me veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin e parregullsive në raportet e monitorimit, dhe veprimet që do t'i ndërmerr për mos përsëritjen e parregullsive të konstatuara.

Bazuar në njoftimin për mos pajtueshmëri të Rregullatorit, të licensuarit KEDS dhe KESCO me datë 07.10.2019 janë përgjigjur Rregullatorit lidhur me njoftimin për mos pajtueshmëri, respektivisht të licensuarit për secilën pikë të njoftimit ka dhënë sqarimet e nevojshme.

Bordi i Rregullatorit në seancën e mbajtur me datë 27.11.2019 ka nxjerr vendim ku ka Obliguar KEDS-in të ndërpres menjëherë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkeljen e kushteve dhe obligimeve të parapara me Nenin 11 të Licencës së OSSH-së, si dhe ka Detyruar KEDS-in që brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pranimit apo publikimit të Vendimit, të kompensojë të gjithë konsumatorët të cilët i ka ngarkuar në Pëlqimet Energjetike për pagesën e grupit matës.

### **3.6.8 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë termike**

Duke qenë se monitorimi është ndër aktivitetet e rregullta që ndërmerren në vazhdimësi nga ZRRE, në vitin 2019 janë monitoruar realizimet dhe performanca në sezonin 2018/2019 e ndërmarrjeve NQ Termokos dhe NQ Gjakova. Monitorimi i realizimeve ka përfshirë:

- Bilancin e energjisë: prodhimin dhe furnizimin me energji termike si dhe humbjet në rrjet;
- Realizimin e të hyrave (faturimit dhe arkëtimit) dhe kostove operative;
- Realizimin e kostove kapitale – konkretisht investimeve të reja të lejuara;
- Kyçjet e reja dhe kontratat e furnizimit të konsumatorëve;
- Shfrytëzimin e pa-autorizuar dhe shkyçjet; dhe
- Ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe adresimi i tyre nga ndërmarrjet respektive;

Nga analiza i të dhënave dhe informatave të mbledhura gjatë monitorimit janë hartuar Raportet e monitorimit të realizimeve në sezonin 2018/2019 për NQ Termokos dhe NQ Gjakova, të cilat janë shqyrtuar nga Bordi i ZRRE-së në seancën e 28 gushtit 2019. Këto raporte kanë përshkruar vlerësimet dhe të gjeturat për realizimet e secilës komponentë të monitorimit dhe gjithashtu janë dhënë rekomandimet përkatëse.

### 3.7 Kontestet gjyqësore

Gjatë vitit raportues disa Vendime të ZRRE-së janë atakuar në Gjykatat Themelore, Departamentet për Çështje Administrative, dhe të cilat pritet të shqyrtohen dhe vendosen gjatë vitit 2020 nga Gjykatat kompetente. Vendimet e atakuara të ZRRE-së kanë të bëjnë kryesisht me ankesat e konsumatorëve, ndërsa një nga Vendimet e atakuara ka të bëjë me caktimin e tarifës nxitëse për energjinë elektrike që do prodhohet nga panelet fotovoltaike/djellore.

Në Raportin Vjetor të ardhshëm të ZRRE-së do të raportohet detajisht për rrjedhën e këtyre kontesteve.

### 3.8 Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike

Sipas Ligjit për Energjinë (nr. 05/L-081) ZRRE është përgjegjëse për aprovimin e bilanceve të energjisë, ku përfshihen bilancet vjetore dhe afatgjate (10 vjeçare) të energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror. Në këtë kuptim përgjegjësia ligjore e ZRRE-së shtrihet edhe në përcaktimin e Metodologjisë, rregullave dhe procedurave për përgatitjen dhe miratimin e bilanceve të energjisë. Po ashtu sipas ligjit përcaktohen edhe obligimet e operatorëve të sistemeve për përgatitjen e këtyre bilanceve. Bilancet vjetore duhet të aprovohen nga ZRRE veçmas dhe pastaj përmbledhen si një tërësi e përbashkët për energjinë elektrike, energjinë termike dhe gazin natyror dhe publikohen në faqen elektronike.

Bazuar në kërkesat ligjore dhe në Rregullën dhe metodologjinë për hartimin e bilanceve të energjisë, në seancën e 26 dhjetorit 2019, ka aprovuar Bilancin vjetor:

- Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike 2020;
- Bilancet Vjetor të Energjisë Termike të NQ Termokos dhe NQ Gjakova 2020;

Meqenëse Kosova nuk posedon sistem të organizuar të gazit natyror, nuk janë përgatitur bilancet përkatëse për gazin natyror.

Këto dokumente janë punuar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (Neni 8), dhe Metodologjinë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe përmbajnë:

- a) planifikimin vjetor dhe afatgjatë të prodhimit për energji elektrike dhe termike;

- b) parashikimin për import dhe eksport të energjisë elektrike,
- c) konsumin dhe humbjet në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike/termike.

Qëllimi i këtyre dokumenteve është të informojë të gjithë të interesuarit për parashikimin e kërkesës për energji për vitin 2020. Dokumentet janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

### 3.9 Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve

#### 3.9.1 Shqyrtimi tarifor

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullave për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM), në kuadër të kompetencave të dhëna është autoriteti i vetëm përgjegjës për përcaktimin e tarifave për aktivitetet e rregulluara dhe ato që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë.

Në këtë kontekst një nga detyrat kryesore të ZRRE-së gjatë vitit 2019 ka qenë shqyrtimi i aplikacioneve të licencuarve për të hyrat e lejuara dhe tarifave në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes, blerjet e energjisë me shumicë dhe furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale, përkatësisht tarifave për konsumatorët e rregulluar. ZRRE ka bërë vlerësimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave përmes analizimit të treguesve teknik, ekonomik dhe financiar të paraqitur në aplikacionet e të licencuarve.

ZRRE gjatë vitit 2018 ka zhvilluar shqyrtimin periodik për periudhën 1 prill 2018 deri më 31 mars 2023, ku janë përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të licencuarve: Operatorin e Sistemit Transmetimit-Operatorin Tregut (OST/OT-KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS) dhe periudhë njëvjeçare për Furnizuesin me shërbimit universal (FSHU-KESCO). Duke u bazuar në të hyrat e vendosura gjatë shqyrtimit periodik, ZRRE ka kryer përshtatjet e rregullta të të hyrave, në muajin mars 2019 ndërsa në muajin prill 2019 ka përcaktuar tarifave për shërbimet e rregulluara të energjisë elektrike.

Shqyrtimi i aplikimeve për të hyrat dhe tarifave të rregulluara në sektorin e energjisë elektrike ka përfshirë: aktivitetet e blerjes së energjisë me shumicë nga gjeneratorët vendor, importin e energjisë elektrike, aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal (FSHU) të energjisë elektrike. Në këtë shqyrtim tarifor, ZRRE-ja ka analizuar të dhënat e realizuara për vitin 2018 të të cilat i ka përshtatur me ato të vitit relevant tarifor 2019.

I gjithë ky proces i shqyrtimit ka kaluar përmes konsultimeve publike (takimeve dhe publikimit të dokumenteve) si në vijim:

- Rregullatori në muajin dhjetor 2018 ka iniciuar shqyrtimin tarifor për vitin 2019;
- Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OSSH, i publikuar në muajin mars 2019;
- Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me shërbim universal (KESCO), i publikuar në muajin mars 2019

- Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale OST/OT – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar në muajin prill 2019;
- Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale OSSH– Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar në muajin prill 2019;
- Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të Furnizuesit me shërbim universal– Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar në muajin prill 2019.

### 3.9.2 Blerjet e Energjisë në tregun me shumicë

Çmimet e prodhimit për Gjeneratorët publik (KEK SH.A) janë të derregulluara nga data 1 prill 2017, por kjo energji do të ofrohet në tregun e energjisë me shumicë, me prioritet për Furnizuesin e Shërbimit Universal. Pas përcaktimit të sasive të nevojshme për furnizim me qëllim të mbulimit të kërkesave të konsumatorëve të Furnizuesit me shërbim universal, bëhet edhe kalkulimi i kostove tjera për blerje të energjisë në tregun me shumicë. Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të sigurojë energji elektrike në mënyrë transparente, konkurruese dhe efikase. Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet të demonstrojë se çmimet e parashikuara të energjisë elektrike janë të arsyeshme, në përputhje me çmimet historike dhe ato të projektuara në tregun me shumicë.

Kosova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ka marr obligime për zbatimin e pakos së tretë të energjisë në BE dhe është duke zbatuar ato. ZRRE në bazë të Udhëzimit për liberalizimin e tregut dhe Dizajnit të Tregut është duke zhvilluar tregun konkurrues. Përmes hapjes së tregut mundësohet rritja e konkurrencës në tregun me shumicë dhe pakicë. Kjo mundëson që konsumatorët të përfitojnë çmime më konkurruese.

Në përcaktimin e të hyrave të FSHU merret parasysh bilanci i energjisë elektrike i cili duhet të reflektojë vetëm kostot e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Energjia e prodhuar nga KEK-u do të ofrohet në tregun me shumicë e cila duhet të bëhet në pajtim me “Procedurën për Tregtim të Energjisë”. Duke respektuar këtë procedurë dhe Rregullat e Tregut, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bëjnë blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse. Kontratat për këto shërbime duhet të bëhen në pajtim me parimet e tregut.

Parashikimi i ngarkesës (Bilanci Energjetikë) - energjisë në dispozicion përfshinë: blerjet e energjisë së gjeneruar nga KEK-u, blerjet e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet, prodhimi i energjisë nga panelet solare, prodhimi i energjisë nga turbinat me erë, blerjet nga importi, blerjet e humbjeve të energjisë elektrike për sistemin transmetues, shpërndarjes dhe shitjet te konsumatorët e rregulluar tarifor.

Këto të dhëna energjetike dhe financiare të lejuara për vitin 2019 janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tab. 3.15 Blerjet e lejuara të energjisë elektrike për FSHU

Kostot e blerjes së energjisë - 2019	GWh	€/MWh	mil€
Sasitë e furnizuara nga KEK	3,293.0	29.5	97.14
Ujmani dhe gjeneratorë tjerë në nivel të OST	296.0	37.3	11.03
Gjeneratorë në nivel të OSSh-së	142.6	37.8	5.39
Importi	41.3	60.0	2.48
Gjithsej sasitë e furnizuara	3,772.0	30.8	116.05
Margjina me pakicë [3.00 %]			3.81
<b>Gjithsej kostot e blerjes së Energjisë</b>			<b>119.53</b>

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme vërehet se çmimi mesatar për blerje të energjisë në tregun me shumicë për FSHU është 30.8€/MWh.

### 3.9.3 Të hyrat dhe tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar

Në harmoni me parimet e përgjithshme të përcaktuar në legjislacionin dhe Rregullën për përcaktimin e të hyrave për Furnizuesin me Shërbime Universal, KESCO ka përgatitur aplikacionin me propozime për të hyra dhe tarifa për shqyrtim nga ZRRE.

ZRRE pas vlerësimit të aplikacioneve të të licencuarve, ka bërë analizat e nevojshme dhe ka përgatitur Raportin vlerësues për të hyrat e lejuara maksimale për FSHU-në. Ky raport ka qenë në konsultim publik me qëllim të marrjes së komenteve nga palët e interesit. Pas pranimit të komenteve dhe shqyrtimit të tyre, ZRRE ka përgatitur raportin përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale për FSHU-në.

Pas përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, të licencuari kanë dërguar propozimet për tarifa, ku ZRRE ka analizuar propozimin dhe ka vendosur që tarifat e rregulluara me pakicë të mbesin të njëjta.

Kostot e arsyeshme të cilat janë përdorur për përcaktimin e tarifave të rregulluara përfshijnë: kostot e blerjeve të energjisë, kostot e bartshme (kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes), kostot e furnizuesit (kostot me pakicë) dhe kostot e përshtatura. Detajet e këtyre kostove janë të paraqitura në tabelën në vijim.



Tab. 3.16 *Kostot e arsyeshme të cilat janë përdorur për përcaktimin e tarifave të rregulluara*

<b>MAR-i I Furnizuesit me Shërbim Universal - 2019</b>	mil€
Shpenzimet Operative	6.06
Zhvlerësimi	0.11
<b>Kostot e bartshme</b>	
Kostot e OST	30.34
Kostot e OSSh	101.50
Fondi BRE	12.06
Kapitali Punues (WCLCt)	1.68
Kostot për blerjen e energjisë	119.53
Taksa për licence	0.01
Përshtatjet 2018	-32.42
Borxhi i keq (BDTA)	9.95
<b>MAR-i Final</b>	<b>248.82</b>

ZRRE përcakton tarifën e rregulluarë për konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Kriteret se cilët konsumatorë e gëzojnë këtë të drejtë janë të vendosura në Ligjin për Energjinë Elektrike, sipas të cilit: “Të drejtën e furnizimit me shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar, dhe jo familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës”.

Në vitin 2019 konsumatorët të cilët janë faturuar me tarifa të rregulluara janë konsumatorët e kyçur në nivelet e tensionit 35kV, 10kV dhe 0.4kV, ndërsa konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 220kV dhe ata në 110kV janë furnizuar me çmime të parregulluara (çmime të tregut).

Duhet të theksohet se të drejtën për furnizim me çmime të tregut, përkatësisht mundësinë e zgjedhjes së furnizuesit e kanë të gjithë konsumatorët. Deri më tani ZRRE ka licencuar gjithsej 8 furnizues nga të cilët konsumatorët mund të blejnë energjinë e tyre me çmime të parregulluara, por vlen të përmendet se vetëm KESCO është aktiv.

Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale (tarifat e rregulluara) është dizajnuar ashtu që të mbulojë të hyrat e përcaktuara në vlerë prej 248.82 milion euro.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e tarifave me pakicë, pas aplikimit të këtyre tarifave pritët që furnizuesi të faturojë nivelin e lejuar të të hyrave të lejuara maksimale. Kjo strukturë tarifore është duke u aplikuar nga data 1 prill 2019.

**Tab. 3.17 Struktura e tarifave të rregulluara për konsumatorët fundor për vitin 2019**

Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Aprovuar 2018
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67	
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67	
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67	
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	8.83
			€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
				€/kWh	Tarifë e Ulët
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
				€/kWh	Tarifë e Ulët
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		5.32
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.24

*Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars*  
*Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator*  
*Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me  $\cos(\Phi) < 0.95$*

### 3.9.4 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit

Gjatë vitit 2019, ZRRE ka kryer procesin e përshtatjes së të hyrave përmes aplikimit të faktorit të efikasitetit dhe indeksimit të kostove për inflacion për shpenzimet operative, riparimet & mirëmbajtjes, kostot e blerjes së humbjeve, shpenzimet e kthimit dhe zhvlerësimit që rezultojnë nga investimet e planifikuara sipas planit zhvillimor dhe kostot tjera të arsyeshme për operim të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes.

Për të mundësuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, përkrahjen e rritjes së ngarkesës, integrimin e burimeve të ripërtitshme, rritjen e cilësisë së furnizimit, ZRRE gjatë shqyrtimit periodik

për periudhën rregulative 2018-2022 ka lejuar investime kapitale rreth 60 milion euro për OST/OT. Alokimi i këtyre investimeve nëpër vite për periudhën 2018-2022 është i paraqitur në figurën e më poshtme.




Fig. 3.3 Investimet kapitale për OST/OT

Me qëllim të sigurisë së furnizimit, liberalizmit dhe integritit të tregjeve të energjisë elektrike, integritit të kapaciteteve të reja gjeneruese, reduktimit të humbjeve dhe përmirësimin e parametrave tjerë teknik të rrjetit janë lejuar të hyrat e mjaftueshme për operimi të rrjetit të transmetimit.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Bordi i ZRRESË për vitin relevant tarifar 1 prill 2019 - 31 mars 2020.

Tab. 3.18 Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT

<b>MAR-i i OST/OT-së - 2019</b>	mil€
Shpenzimet Operative	7.42
Zhvlerësimi	10.63
Kthimi I lejuar	9.59
Humbjet e lejuara	5.11
Kostot e Fondit të BRE-ve	13.74
Kosto e shërbimeve ndihmëse	2.66
Të hyrat e parregulluara tarifore	-0.06
Të hyrat nga ITC	-0.40
<b>Përshtatjet e PRR1 dhe vitit 2017</b>	
Përshtatjet	-1.26
Të hyrat e mbetura nga KEK	-3.33
Korigjimi i jobalanceve 2017	0.23
Borxhi i keq (BDTA)	9.85
<b>MAR-i Final</b>	<b>54.19</b>

Të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT do të mblidhen përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE bazuar në Metodologjinë e përcaktimit të tarifave të sistemit të transmetimit, operimit të sistemit, dhe operimit të tregut. Pra, KOSTT ka dy licenca të lëshuara nga ZRRE si: Operatori i sistemit Transmetimit i cili menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të tensionit të lartë dhe Operatori i tregut i cili është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimit (shit-blerjen) të energjisë elektrike dhe kryerjes së transaksioneve në mes prodhueseve, furnizueseve dhe klientëve të tjerë.

Në tabelën në vijim është prezantuar struktura e tarifave për shfrytëzimin e operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut që aplikohet nga data 1 prill 2019.

*Tab. 3.19 Struktura e tarifave të OST/OT për vitin 2019*

Grupi tarifor	Elementi tarifor	Njësia	Tarifa
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.241
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.036
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.550
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.036
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.286
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.038
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	11.600
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	23.885
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.286
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.038
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	3.198

### 3.9.5 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes

Procesi i përshtatjeve të rregullta vjetore ngjashëm sikurse të OST/OT aplikohet edhe të OSSH. Kështu, ZRRE përmes një procesi transparent dhe duke u konsultuar me të gjitha palët e interesit ka përcaktuar të hyrat e lejuara maksimale për OSSH për vitin 2019.

Për të mundësuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, përkrahjen e rritjes së ngarkesës, integrimin e burimeve të ripërtrishme, zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së furnizimit, ZRRE gjatë shqyrtimit periodik për periudhën rregullative 2018-2022 ka lejuar investime kapitale rreth 131 milion euro për OSSH.

Alokimi i këtyre investimeve nëpër vite për periudhën 2018-2022 është i paraqitur në figurën e më poshtme:




Fig. 3.4 Investimet kapitale për OSSH

Të hyrat e OSSH për periudhën e 1 prill 2019- 31 mars 2020 të cilat janë aprovuar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab. 3.20 Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH për periudhën 1 prill 2019- 31 mars 2020

<b>MAR-I i OSSH-së - 2019</b>	mil€
Shpenzimet Operative	26.30
Zhvlerësimi	14.65
Kthimi i lejuar	13.59
Obligimet për OS dhe OT	1.23
Humbjet e lejuara	41.89
Të hyrat e parregulluara	-3.50
<b>Përshtatjet e PRR1 dhe vitit 2017</b>	
Përshtatjet	-1.50
Korrigjimi për çmimin e humbjeve të vitit 2017	-2.48
Korrigjimi për jobalancet e vitit 2017	1.74
Faktori Korigjues i të hyrave KREV	9.58
<b>MAR-i Final</b>	<b>101.50</b>

Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH do të mblidhen përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE bazuar në Metodologjinë e përcaktimit të Tarifave të Sistemit të Shpërndarjes.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2019.

Tab. 3.21 Struktura e tarifave për OSSH për vitin 2019

Tarifat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.71
10 kV	€/kWh	2.01
0.4 kV	€/kWh	2.77

### 3.9.6 Tarifat e energjisë termike

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave.

Skematikisht, Metodologjia tarifore tregohet si më poshtë:




Fig. 3.5 Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Nga paraqitja skematike vërehet se kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësojë asetet e veta, koston e humbjeve të rrjetit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Procesi i përcaktimit të tarifave dhe aprovimit të tyre është bërë në dy hapa:

1. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale, bazuar në : informatat dhe të dhënat e parashikuara në aplikacionin për tarifa; ii) informatat e paraqitura gjatë raportimit rregullativ të realizimeve në sezonin e kaluar 2018/2019; dhe iii) bashkërendimi mes realizimeve aktuale dhe atyre të projektuara, që është bazuar në dallimin midis të hyrave të planifikuara dhe atyre aktuale të sezonit të kaluar të ngrohjes.
2. Llogaritja e tarifave bazuar në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe në strukturën tarifore.

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të NQ Termokos SH.A. për sezonin 2019/2020, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:

- a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i aseteve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitali punues; dhe
  - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostos së lejuar për humbjet në rrjet.

ZRRE-ja ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e Termokosit. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellë me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2019/2020.

Në kuadër të shqyrtimit tarifor për NQ Termokos, ZRRE ka hartuar Raportet Rregullative për përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara dhe për përcaktimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2019/2020.

Pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse të shqyrtimit tarifor, në seancën e 14 tetorit 2019, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për NQ Termokos për sezonin 2019/2020, në vlerë prej 6,472,902 euro. Tarifat e reflektuara nga HLM të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2019-2020, janë zbritur në vlerë mesatare prej 3.85% - Tarifat sipas konsumit të matur janë zbritur për 6.8%; ndërsa tarifat sipas sipërfaqes së ngrohur (për m<sup>2</sup>) janë zbritur për 2.37%.

Vendimet e nxjerra:

- V\_1187\_2019 -për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) për NQ Termokos që do të mblidhen nga tarifrat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2019/2020;
- V\_1188\_2019 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2019/2020;

Sa i përket NQ Gjakovës, gjithashtu ZRRE ka ndërmarr një vlerësim gjithëpërfshirës të performancës financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, që ka përfshirë realizimet e sezoneve të kaluara. Bazuar në këtë vlerësim janë nxjerr këto përfundime:

- Gjendja aktuale financiare dhe çmimi i lartë i lëndës djegëse – mazutit, kushtëzojnë një furnizim të kufizuar me mazut e rrjedhimisht dhe prodhim dhe furnizimi të kufizuar me energji termike; duhet theksuar se blerja/furnizimi me mazut tërësisht është i varur nga subvencionet prej Buxhetit të Kosovës gjegjësisht nga ndarjet e pritshme të buxhetit të vitit 2020, i cili ende nuk është miratuar.
- Po ashtu kostot tjera operative dhe të mirëmbajtjes reflektojnë mundësitë e limituara financiare në atë masë sa të mundësojnë një operim bazik dhe furnizim të kufizuar me energji termike.
- Në këtë aspekt, furnizimi me energji termike është i kufizuar për një periudhë tre-mujore (muajt më të ftohtë të sezonit, dhjetor – shkurt) e gjithashtu numri të përgjysmuar të konsumatorëve gjegjësisht të sipërfaqeve ngrohëse të konsumatorëve.
- Gjithashtu, gjendja e vështirë financiare pamundëson çfarëdo vetë-financimi të investimeve të reja në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Gjakovës, që do ndikonte në zvogëlimin e humbjeve në rrjet dhe në stabilimentet e prodhimit të ngrohjes, që aktualisht vlerësohen mjaft të mëdha. Ndërlidhur me këtë duhet theksuar se, sa i përket projekteve zhvillimore, tërë aktiviteti është

përqendruar në projektin për ndërtimin e ngrahores së re dhe njësisë së kogjenerimit me biomasë i financuar nga BE.

Vlerësimet e lartë përshkruara të komponentëve kryesorë për shqyrtim tarifor, argumentojnë se aktualisht është shumë e vështirë të bëhet çfarëdo planifikimi (parashikimi) real dhe mjaftueshëm i saktë për të ndërmarrë një shqyrtim të mirëfilltë tarifor, që do rezultonte me përcaktim korrekt të të Hyrave të lejuara dhe tarifave për sezonin 2019/2020. Rrjedhimisht Bordi i ZRRE në seancën e dt. 27 nëntor 2019, pas shqyrtimit të kërkesës së NQ Gjakovë dhe Vlerësimit të stafit profesional përkatës të ZRRE-së, ka marrë vendim që tarifave të energjisë termike të NQ Gjakovës për sezonin 2019/2020 të mbesin të njëjta me ato të vitit të kaluar deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

- V\_1193\_2019 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike, për konsumatorët fundorë të NQ Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2018/2019.

Struktura dhe nivelet e tarifave të Energjisë termike për NQ Termokos dhe NQ Gjakova është paraqitur si më poshtë.

Tab. 3.22 Struktura e tarifave të energjisë termike për vitin 2019

Tarifat e energjisë termike - Sezoni 2019/2020					
Komponentët e tarifës me matje	Njësia	NQ Termokos		NQ Gjakova	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/kW/muaj]	0.78		0.91	
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile)	[€/MWh]	36.25		58.76	
Komponentët e tarifës pa matje	Njësia	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.11	0.14	0.09	0.12
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.65	0.81	0.88	1.27
Gjithsej tarifa për konsumatorët pa matje	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.76	0.95	0.97	1.39

### 3.10 Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Rregullatori në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë është përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, ndërmjet dy të licencuarve, si dhe në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmetimit, apo shpërndarjes së energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, si dhe transmetimit, rrjedhave ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Sipas dispozitave të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë që të parashtrijnë ankesa që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga furnizuesi ose operatori i sistemit, e që këto ankesa fillimisht duhet t'i drejtohen furnizuesit si organi i shkallës së parë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe nxjerr përgjigje brenda afatit ligjor. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes mund t'i drejtohet Rregullatorit për shqyrtim të mëtutjeshëm të ankesës së tij.




Rregullatori gjatë vitit 2019 ka regjistruar 75 ankesa zyrtare të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e Furnizuesit, si dhe ka kthyer në rishqyrtim 128 ankesa te Furnizuesi dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Gjatë vitit 2019 numri i ankesave të regjistruara në Rregullator është rreth 41.33% më i ulët se numri i ankesave të regjistruar gjatë vitit 2018. Rregullatori përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postës elektronike, si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Numri i ankesave të pranuar sipas kategorive të konsumatorëve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

*Tab. 3.23 Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive, 2019*

Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive	Numri	Përqindja [%]
Konsumator shtëpiak	58	77.33
Konsumator komercial	15	20.00
Konsumator industrial	2	2.67
Gjithsej	75	100.00

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre.




*Fig. 3.6 Numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre*

Më poshtë është paraqitur sqarimi i natyrave të ankesave të konsumatorëve të regjistruara për vitin 2019:

- **Kontestimi i faturave të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për rastet e gabimeve në lexim dhe leximeve jo të rregullta, e që me këtë rast konsiderohet se kanë dhënë një pasqyrim jo të saktë të gjendjes reale të shpenzimit të energjisë elektrike.


- **Kontestimi i ngarkesave shtesë**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet shtesë nga faturimi i rregullt. Këto ankesa janë si rezultat i mos regjistrimit të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike, si rrjedhojë e defektit të ndonjë sistemi matës.
- **Kontestimi i borxhit të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me problemet rreth mos definimit të saktë të borxhit të energjisë elektrike të pa inkasuar nga ana e furnizuesit në rastet e shitblerjes së pronës, dhe për pronat që kanë qenë të uzurpuara.
- **Kontestimi i faturave të energjisë termike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet e energjisë termike të bëra na NQ “Termokos”, të cilat ndërlidhen me cilësinë e ngrohjes dhe sipërfaqes së faturuar.

Gjatë vitit 2019, Rregullatori ka zgjidhur 263 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të zgjidhura, 192 prej tyre janë vendosur në favor të konsumatorëve apo shprehur në përqindje 73.00%, aprovuara pjesërisht janë 12 apo 4.56%, ndërsa 59 ankesa të konsumatorëve apo 22.43% janë refuzuar si të pabaza. Të gjitha ankesat e shqyrtuara nga ana e operatorëve, e të cilat janë proceduar te Rregullatori, janë rishqyrtuar edhe njëherë nga Rregullatori me qëllim të vërtetimit të zgjidhjes së plotë të ankesave sipas kërkesave të konsumatorëve, si dhe janë njoftuar konsumatorët. Në të gjitha rastet e rishqyrtuara konsumatorët janë pajtuar me zgjidhjet e ofruara.



*Fig. 3.7 Ankesat e zgjidhura, 2019*

Numri i ankesave të konsumatorëve, të regjistruara dhe zgjidhura nga Rregullatori sipas viteve është paraqitur në figurën e mëposhtme.



*Fig. 3.8 Ankesat e konsumatorëve të regjistruara dhe zgjidhura 2011-2019*

### 3.10.1 Kontestet ndërmjet dy të licencuarve

Në bazë të nenit 17, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe dispozitave ligjore të neni 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, Rregullatori përveç kompetencave që ka në shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve kundër ndërmarrjes së energjisë, ka kompetencë edhe në zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy të licencuarve.

Kah fundi i vitit 2018 Operatori i Sistemi të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A ka iniciuar kontest në Rregullator kundër Korporatës Energjetike të Kosovës SH.A lidhur me kundërshtimin e faturës nr.OST-P-03-2-2018. Kontesti i ngritur nga KOSTT SH.A kundër KEK SH.A lidhur me kundërshtimin e faturës nr.OST-P-03-2-2018, ka të bëjë me çështjen e kompensimit të energjisë së furnizuar në muajin mars 2018 nga KEK sipas programit të kompensimit ndaj Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (OST) të Evropës.

Kontesti i ngritur nga KOSTT SH.A kundër KEK SH.A nuk ka mundur të zgjidhet nga Rregullatori gjatë vitit 2018 për arsye se ka ardhur në fund të vitit 2018, andaj ka mbetur të shqyrtohet dhe të përfundohet në fillim të vitit 2019. Lidhur me këtë Rregullatori me datë 21.02.2019 pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të dërguara nga të dy të licencuarit KOSTT SH.A dhe KEK Sh.A, i është përgjigjur të dy të licencuarve me një shkresë zyrtare duke i theksuar se, pasi që të dy ndërmarrjet e energjisë nuk kanë marrëveshje me shkrim për mundësimin e kthimit të programit të kompensimit ndaj OST-ve të Evropës përmes tepricave të KEK, e të cilën kërkesë e ka aprovuar Kryeministri i Republikës së Kosovës, kontesti i tillë nuk mund të trajtohet nga Rregullatori, pasi që është jashtë kontrollit dhe kompetencës së saj, andaj zgjidhjen e këtij kontesti të dy të licencuarit do të duhej ta kërkojnë nga aksionarët e të dy ndërmarrjeve dhe jo nga Rregullatori.

### 3.10.2 Vendimet e Bordit të Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të Departamentit për

Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) si instancë e shkallës së parë në Bordin e Rregullatorit si instancë e shkallës së dytë.

Gjatë vitit 2019 konsumatorët kanë parashtruar 6 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK. Nga 6 ankesat e regjistruara, Bordi i Rregullatorit i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza.

Furnizuesi KESCO gjatë vitit 2019 ka parashtruar 24 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK. Nga 24 ankesat e regjistruara Bordi i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 Bordi i Rregullatorit ka shqyrtuar 4 rekomandime të nxjerra nga DMK për ankesat e konsumatorëve komercial dhe industrial, me ç'rast Bordi ka aprovuar të gjitha këto rekomandime.

### 3.10.3 Aktivitetet tjera në mbrojtjen e konsumatorëve

ZRRE gjatë këtij viti raportues, përveç ankesave të regjistruara, stafi i Rregullatorit ka zhvilluar edhe 1,687 takime dhe 1,021 biseda telefonike me palët, përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme kontraktuale mes konsumatorëve dhe të licencuarve. Gjatë komunikimit me konsumatorët, stafi i Rregullatorit i ka sqaruar çështjet e ngritura nga konsumatori, si dhe ka udhëzuar palët për rregullat, procedurat, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji.

Gjatë vitit 2019 Rregullatori ka pranuar edhe 15 ankesa të konsumatorëve përmes postës, të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'u drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'i drejtohen Rregullatorit për zgjidhjen e ankesave të tyre. Vlen të theksohet se natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, si dhe kompensim dëmi. Rregullatori në të gjitha këto raste i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre.

Ashtu edhe si viteve të mëhershme, por edhe gjatë vitit 2019 Rregullatori ka pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ku gjatë këtij viti raportues ka pranuar edhe disa ankesa të konsumatorëve nga ky institucion. Këto ankesa janë pranuar dhe shqyrtuar nga ana e Rregullatorit në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjatë vitit 2019 një numër i vendimeve të Rregullatorit janë apeluar nga palët e pakënaqura në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve administrative. Rregullatori gjatë vitit 2019 në bazë të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka përgatitur 22 përgjigje në padi kundër paditësve KEDS, KESCO dhe konsumatorëve ndaj vendimeve të Bordit të Rregullatorit. Përveç përgjigjeve në padi, duhet theksuar se gjatë këtij viti raportues Rregullatori ka qenë i angazhuar edhe në 28 seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë si palë e paditur. Vlen të theksohet se edhe si vitet paraprake po ashtu edhe në këtë vit raportues numri i proceseve gjyqësore që Rregullatori ka ndjekur është i lartë dhe po kërkon angazhim mjaft të madh.

Është më rendësi të theksohet se deri më tani asnjë vendim i Rregullatorit në procedurën administrative nuk është kthyer në rishqyrtim si pasojë e moszbatimit të ligjshmërisë nga organi

administrativ, por që të gjitha këto padi kundër vendimeve të Rregullatorit janë refuzuar si të pabaza duke lënë në fuqi vendimet e atakuara.

### 3.11 Procesi i certifikimit të OST (KOSTT)

Si rezultat i kërkesave të dala nga Direktiva 2009/72 dhe Rregullorja 714/2009 të transpozuar në Legjislacionin për Energji të Kosovës e që kanë të bëjnë edhe me shturjen pronësore të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, ZRRE ka hartuar dhe aprovuar Rregullën për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (prill 2017). Në përputhje me këtë Rregull, ZRRE me date 03.05.2018 ka pranuar Aplikacionin për Certifikimin pronësor të KOSTT.

Tërë procesi i vlerësimit të aplikacionit të KOSTT nga ZRRE, është bërë në bashkëpunim dhe koordinim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Ky proces është përmbyll me 15.02.2019 me Vendimin e ZRRE nr. V\_1107\_2019 me të cilin ka Certifikuar Operatorin e Sistemit të Transmisionit, si operator i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës, me të cilën është vërtetuar se janë përmbushur kriteret e shturjes pronësore dhe pavarësisë vendimmarrëse nga veprimtaria e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe të Komunitetit të Energjisë. Ky proces është vlerësuar i suksesshëm edhe nga Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

Sipas kërkesave të legjislacionit si më lartë, ZRRE me date 14.10.2019, me Vendimin nr 1186\_2019 ka aprovuar Zyrtarin e pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmisioni ndërsa me date 27.11.2019 ZRRE ka aprovuar edhe Programin e pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

## 4 BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA

ZRRE ka treguar transparencë të plotë në ushtrimin e funksionit të saj duke mbajtur seancat e Bordit të hapura për publikun dhe duke publikuar të gjitha vendimet. Përmes komunikatave, njoftimeve, përgatitjes së buletinit dhe publikimeve të tjera në faqen elektronike dhe atë në Facebook është informuar publiku i gjerë me kohë për të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e ZRRE. Gjate kësaj periudhe janë publikuar 20 komunikata për shtyp, 11 njoftime, 2 Buletinet dhe janë shpallur 7 diskutime publike.

Gjatë përmbushjes së obligimeve që ka ZRRE, në hartimin dhe aprovimin e legjislacionit sekondar si dhe të shqyrtimeve të tjera rregullative, me qëllim të përfshirjes dhe informimit të të gjitha palëve të interesuara, publikon dhe zhvillon konsultime të ndryshme publike. Gjatë vitit 2019, ZRRE ka zhvilluar 7 diskutime të tilla publike.

- Me 6 shkurt 2019, ZRRE ka vendosur në diskutim publik draft dokumentin për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik për Siguri të Furnizimit. Ky dokument përshkruan kriteret për matjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, Procesin për vlerësimin e vendosjes së obligimit të shërbimit publik dhe Taksën për Sigurinë e Furnizimit mbi furnizuesit.
- Gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin tarifar 2019 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU), ZRRE ka përgatitur raportet konsultative me propozimet fillestar për MAR-et e azhuruara:
  - Raporti Konsultativ FSHU 2019
  - Raporti Konsultativ KOSTT 2019
  - Raporti Konsultativ OSSH 2019
- Me qëllim të konsultimit me të gjitha palët e interesuara, raportet e lartpërmendura janë nxjerr në diskutim publik me 22 shkurt 2019. Po ashtu të gjitha dokumentet tjera të ndërlydhura me këtë proces janë publikuar në faqen zyrtare të ZRRE.
- Me 26 prill 2019, ZRRE ka vendosur në diskutim publik draftin e Rregullës për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike. Qëllimi i nxjerrjes së Rregullës për Standardet e Cilësisë së Shërbimeve të Energjisë Elektrike është që të përcaktojë treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit.
- ZRRE, me 2 maj 2019, ka vënë në diskutim publik Raportin Konsultativ për “Mekanizmin e Mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike)”. Rishqyrtimi i këtyre mekanizmave ka ardhur si rrjedhojë e rishikimit të Udhëzimit Administrativ 05/2017, për caqet e BRE-ve nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Ministrisë për Zhvillim Ekonomik.
- Në qershor 2019, ZRRE ka publikuar për diskutim publik Planin Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar të Ndërmarrjes së ngrohjes qendrore NP “Termokos” sh.a. Plani Zhvillimor paraqet masat që do të merren për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe për të siguruar furnizim sa më të mirë me energji termike (ngrohje qendrore), duke përfshirë planifikimet për projektet

rehabilituese dhe të zgjerimit të infrastrukturës së sistemit të ngrohjes qendrore në komunën e Prishtinës, gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme.

- Me 20 shtator është publikuar për diskutim publik Raporti Rregullativ për Shqyrtimin Tarifor për sezonën 2019/2020 të NP Termokos.
- ZRRE ka vënë në diskutim publik po ashtu Planin Zhvillimor 2020-2029 të Operatorit të Shpërndarjes 2020-2029.

#### 4.1 Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës

##### **Takimet në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

ZRRE sipas afateve të parapara ligjore, ka paraqitur Raportin Vjetor për vitin 2018 dhe e ka paraqitur para Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e mbajtur me 18 qershor 2019. Raporti është, miratuar nga Komisioni por për shkak të zhvillimeve politike nuk ka rritur të shqyrtohet në seancë plenare.

Me 20 prill 2019, ZRRE me kërkesë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik ka diskutuar me Odën Ekonomike, atë Amerikane dhe Klubin e Prodhuesve për kërkesat dhe vështirësitë që mund të kenë bizneset dhe prodhuesit me hapjen e tregut. Përfaqësuesit e odave kanë kërkuar me këtë rast nga ZRRE që të shtyhet hapja e tregut të energjisë elektrike në mënyrë që të krijohen kushte më të përshtatshme për liberalizim e mirëfilltë.

##### **Takim informues me Komisionin Parlamentar për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis e planifikim hapësinor**

Me 16 korrik 2019, në ZRRE, përfaqësues të Bordit dhe ekspert të Rregullatorit për energji kanë mbajtur një takim informues me deputet të Komisionit Parlamentar për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis e planifikim hapësinor. Qëllimi i këtij takimi ka qenë informimi i deputetëve me procesin e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të nga Burimet e Ripërtitshme të Energjisë (BRE) konkretisht në lidhe me disa projekte, për ndërtimin e hidrocentraleve, për të cilat anëtarët e Komisionit Parlamentar kanë shtruar pyetje dhe kanë kërkuar sqarime më të hollësishme.





*Fig. 4.1 – Takim pune me Komisionin Parlamentar për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis e planifikim hapësinor 2019, Prishtinë*

Deputetët kanë kërkuar sqarime në lidhje me procesin dhe procedurën e lëshimit të autorizimit, duke shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me paqartësitë dhe reagimet e qytetarëve në lidhje me disa nga këto projekte.

Përfaqësuesit e ZRRE kanë prezantuar para deputetëve procesin që udhëhiqet nga ZRRE, proces ky i mbështetur në Ligjet e Energjisë dhe Rregullën e Autorizimit.

#### **Marrëveshja me Odën e Afarizmit të Kosovës**

Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe ofrimit të mbështetjes në zhvillimin ekonomik në vend, me 29 janar 2019, ZRRE ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Afarizmit të Kosovës (OAK).

Përmes këtij memorandumi, ZRRE dhe OAK janë pajtuar, që në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre.

Po ashtu ZRRE dhe OAK janë pajtuar që të këmbëjnë informacione lidhur me aktivitetet e tyre dhe të bizneseve anëtare. Sipas memorandumit këmbimi i informacioneve do të bëhet në bazë të kërkesave të autorizuara të të dy palëve dhe në pajtim të plotë me ligjet në fuqi.



*Fig. 4.2 – Nënshkrimi i marrëveshjes me OAK 2019, Prishtinë*

ZRRE përmes këtij memorandumi, ka theksuar edhe njëherë se do të ketë prioritet përfshirjen e të gjitha palëve, në proceset e shqyrtimeve të planeve zhvillimore të rrjetit të Transmetimit dhe Shpërndarjes si dhe gjatë proceseve të tjera rregullative që janë me interes të përgjithshëm.





## 4.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

### Bashkëpunimi dhe marrëveshjet e reja me Rregullatorët Rajonal dhe palët e tjera

#### *Marrëveshja e Bashkëpunimit me KRRE (ERC)*

Me 19 nëntor 2019, ZRRE ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin Rregullativ për Energji dhe Ujë (KRRE) të Republikës së Maqedonisë Veriore. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje shpreh interesin e përbashkët të të dy institucioneve për të bashkëpunuar në përmbushjen e obligimeve të tyre për rregullimin e sektorëve të energjisë të të dyja vendeve. Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshje, të dy autoritetet rregullative janë pajtuar që të shkëmbejnë informata mbi praktikat e aplikuara, gjatë përmbushjes së obligimeve që janë në interes të përbashkët publik të të dyja vendeve. Shkëmbimi i përvojave do të aplikohet në fushën e Politikave rregullative në sektorin e energjisë, përvojave në monitorimin e aktiviteteve të licencuara, metodologjitë e aplikuara në përcaktimin e tarifave për aktivitetet energjetike, ndërtimin e gjeneratorëve të rinj të BRE-ve dhe mënyrat e mbështetjes së projekteve nga BRE-të, si dhe praktika të tjera të aplikuara që do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të të dy institucioneve.



Fig. 4.3 –Nënshkrimi i marrëveshjes me ERC 2019, Prishtinë

#### *Marrëveshja e bashkëpunimit me ERE*

ZRRE me 13 dhjetor 2019 ka nënshkruar Marrëveshje të Bashkëpunimit me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë. Kjo është marrëveshja e dytë, pas asaj të nënshkruar në vitin 2013, që Rregullatorët e të dyja vendeve po nënshkruajnë me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe përshtatjes me rrethanat e reja të krijuara në sektorin e energjisë. Me këtë marrëveshje dy rregullatorët kanë vënë në pah mundësitë për të përqendruar përpjekjet e tyre të përbashkëta mbi zhvillimin e një strukture të qëndrueshme rregullatore në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit në nivel rajonal dhe atë dypalësh.



Fig. 4.4 –Nënshkrimi i marrëveshjes me ERE 2019, Prishtinë

## Aktivitetet e partneritetit me NARUC

### Adresimi i çështjes së konsumatorëve në nevojë

Tema e mbrojtjes së Konsumatorëve në nevojë në sektorin e energjisë, që është trajtuar në Punëtorinë e mbajtur në gusht 2019, ka qenë pjesë e Aktivitetit të Partneritetit që ka ZRRE me Shoqatën Kombëtare të Komisioneve Rregullative të Shërbimeve (NARUC). Partneriteti në mes ZRRE dhe NARUC është mbështetur që nga viti 2008 nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Duke marrë parasysh që Rregullatori ka një rol të rëndësishëm në trajtimin e mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin e energjisë si pjesë e partneritetit me NARUC, ZRRE është angazhuar për të kuptuar më mirë shkallën në të cilën konsumatorët në nevojë do të preken nga heqja e ndër subvencionimit, metodat përmes të cilave do të klasifikohen këta konsumatorë, dhe mundësitë e politikave që janë në dispozicion në Kosovë për të adresuar këtë çështje. Si pjesë e këtij aktiviteti me 20 gusht është mbajtur edhe një punëtori me palët e tjera të përfshira, në mënyrë që të trajtohet kjo problematikë në nivel më të gjerë ndërinstitucional.



Fig. 4.5 Punëtorja për Konsumatorët në nevojë - gusht 2019, Prishtinë

Gjithashtu Stafi i ZRRE gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë edhe në Tri grupe të tjera që NARUC ka organizuar me qëllim të mbështetjes së sektorit të energjisë në vendet e rajonit.

### Siguria Kibernetike

ZRRE po ashtu ka qenë pjesë e programit të NARUC për zhvillimin e politikave të Sigurisë Kibernetike. Me këtë qëllim tre përfaqësues të ZRRE kanë marrë pjesë në dy punëtori që janë organizuar nga

NARUC dhe USAID gjatë vitit 2019. Punëtorja e parë është mbajtur në Varshavë nga 10 deri me 12 Prill, 2019 ku temë ishte “Rregullimi efektiv i sigurisë kibernetike”. Ndërsa Punëtorja e dytë në Shkup me 28-29 tetor me temë “Udhëzimet për tarifa për sigurinë kibernetike”.

Qëllimi i këtyre tryezave ishte njohja e rregullatorëve me udhëzimet për përcaktimin e tarifave për të përmirësuar gjendjen në sistemin elektro-energetik lidhur me sigurinë kibernetike. Po ashtu pjesëmarrësit janë udhëzuar për qasjen që rregullatorët duhet të ndjekin me qëllim të avancimit të përgatitjeve të tyre për aspektet e sigurisë kibernetike.

### 4.3 Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare

Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ZRRE-ja si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Në vijim janë paraqitur aktivitet kryesore dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, në konferencat ndërkombëtare, tryezat punuese apo takimet multilaterale dhe bilaterale.

#### 4.3.1 Pjesëmarrja në Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB)

Komuniteti i Energjisë (KE) është organizatë ndërkombëtare e themeluar përmes Traktatit ndërkombëtarë (i ashtuquajtur Traktati i Komunitetit të Energjisë) në tetor 2005 në Athinë, ku marrin pjesë vendet e Bashkimit Evropian dhe regjionit të Evropës juglindore dhe të Detit të Zi. Aktivitetet e KE gjatë vitit 2018 janë fokusuar drejt përmbushjes së synimeve të përbashkëta: implementimin e “acquis communautaire”, zhvillimin e kornizës rregullative të harmonizuar në nivel regjional, si dhe liberalizimin dhe integrimin e tregjeve të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Palët Kontraktuese të KE janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Në cilësinë e pjesëmarrësve janë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa Norvegjia, Turqia, Armenia dhe kanë statusin e Vëzhguesit.




Fig. 4.6 Shtetet anëtare të Komunitetit për Energji të Evropës Juglindore

Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) është një komponentë kyçe strategjike e Unionit Evropian (UE) për Evropën Jug-Lindore dhe një mjet efektiv i para-aderimit, që synon të zgjerojë përfitimet nga Tregu rajonal për Energji, para se vendet e rajonit të bëhen anëtarë të UE.

Institucionet kryesore të KE-së janë: Këshilli i Ministrave (KM), Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (GPNL), Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), Sekretariati i KE i vendosur në Vjenë, dhe katër forumet këshilluese: për energji elektrike, gaz natyror, çështjet sociale dhe naftën.

**Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB – “Energy Community Regulatory Board”)** është institucion i themeluar sipas nenit 58 të TKE, që përbëhet nga Autoritet Rregullative të palëve kontraktuese, pjesëmarrësve dhe vëzhguesve. ECRB ka rolin e një trupi koordinues të autoriteteve rregullative për harmonizimin e kornizës rregullative, shkëmbimin e njohurive, dhe zhvillimin e praktikave për zbatimin e Traktatit.

Bazuar në dispozitat e Traktatit të KE, ECRB ka këto përgjegjësi:

- këshillon Këshillin Ministror si dhe PHLG-së, për çështje statusore, teknike dhe rregullative;
- lëshon rekomandime për palët, në pajtim me dispozitat e Traktatit, për mosmarrëveshje ndër-kufitare, etj;
- merr masa ndaj palëve, nëse autorizohet nga KM;
- ndihmon bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve rregullative;
- jep rekomandime dhe përgatitë raporte, në lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë; dhe
- kërkon përmbushjen e detyrimeve nga palët sipas TKE.

Për përmbushjen e përgjegjësive, ECRB është e organizuar në grupe punuese të cilat zhvillojnë aktivitetet në fushat përkatëse. ECRB udhëhiqet nga kryetari i zgjedhur për çdo vit nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacional, dhe nënkryetari i cili është i deleguar nga Komisioni Evropian.




Fig. 4.7 Struktura e Bordit Rregullativ të Komunitetit të energjisë

### 4.3.2 Aktivitetet e Rregullatorit në kuadër të ECRB-së

Sipas obligimeve ndaj KE-së, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet në ECRB dhe në çdo grup punues, si dhe merr pjesë aktivisht në punën e Bordit dhe grupeve punuese përkatëse. Aktivitetet e grupeve përkatëse janë paraqitur në vijim:

#### 4.3.2.1 Grupi Punues për Energji Elektrike

Ky Grup punues, gjatë vitit 2019, ka zhvilluar aktivitetet dhe takimet e rregullta në kuadër të fushëveprimtarisë së vet; për punë më efektive ky grup ka të formuar edhe nëngrupet ('Task Force'-TF) e tij, përshkrimi dhe aktivitetet e të cilave janë të paraqitura në vijim:

- **TF1 – Hapja e tregut me shumicë të energjisë elektrike**

Me qëllim që të mbështes hapjen efektive të tregut regional të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë, ky nëngrup është fokusuar në aktivitetet për mbështetjen rregullative, integrimin e tregjeve 'një-ditë-para' dhe 'brenda-ditës' në Evropën Jug-lindore. Po ashtu aktivitetet janë fokusuar në dhënien e inputeve të koordinuara për përshtatjet e Regulloreve të BE-së: 1223/2015 për Alokim të kapaciteteve dhe Menagjim të kongestionit dhe 1719/2016 për Alokimin e mëhershëm të kapaciteteve. Në kuadër të kësaj TF janë hartuar një numër dokumentesh, ndër të cilat: i) Raporti për aktivitetet e tregimit në tregjet 'një-ditë-para' dhe 'brenda-ditës'; dhe ii) Raporti mbi statusin tregjeve 'brenda-ditës' në Palët kontraktuese;

- **TF2 – Balancimi i tregut të integruar**

Implementimi i mekanizmave balancues të bazuar në treg dhe ndërlidhja e tregjeve nacionale të balancimit në tregun regjional do të promovoj formimin transparent të çmimeve të balancimit, do të nxis konkurrencën në blerjen e shërbimeve të balancimit dhe do të ketë ndikim pozitiv në stabilitetin e rrjetit të transmetimit. Ky proces ka marrë një shtysë (nxitje) shtesë nga Iniciativa WB 6.

Në këtë aspekt aktivitetet e nëngrupit TF-2 kanë rezultuar me finalizimin e Raporteve për: i) planet për zhvillimin e tregjeve të balancimit; dhe ii) Analizimin e formimit të çmimit të imbalancave në Palët Kontraktuese; si dhe Inputin e koordinuar rregullativ për balancimin ndër-kufitarë.

- **TF3 – Monitorimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike**

Monitorimi i Tregut është një komponentë kyçe e përgjegjësive rregullative, gjë që është përcaktuar edhe me “*acquis communautaire*”; njoftimi i plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore mundëson promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

Në këtë kontekst aktivitetet janë përqendruar në hartimin e dokumenteve si: i) Raporti i monitorimit të zhvillimit të tregut me shumicë të energjisë elektrike në Palët kontraktuese; dhe ii) Udhëzimet për monitorimin e tregut të EJL.

- **TF4 – Monitorimi i tarifave të transmetimit bazuar në R838 / 2010**

Në kuadër të kësaj task force janë vlerësuar ngarkesat vjetore të sistemit të transmisionit për gjeneruesit e energjisë elektrike (G-charges) që aplikohen në Palët kontraktuese, si dhe rekomandimet përkatëse për harmonizim në nivel të Komunitetit të energjisë.

#### 4.3.2.2 Grupi Punues për Gaz (GPG)

Ky grup punues aktivitetet e veta i përqendron në çështjet e rregullimit të sektorit të gazit natyror, harmonizimin e kornizës rregullative në nivel rajonal dhe çështjet tjera të ndërlidhura me zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror në rajonin e EJL. Me qëllim të efikasitetit dhe trajtimit të çështjeve specifike janë krijuar nëngrupet e veçanta (“Task Force” – TF).

- **TF1 – Monitorimi i tregut me shumicë të gazit natyror**

Monitorimi i tregut është një komponentë kyçe e përgjegjësive rregullative sepse njoftimi i plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore mundëson promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit

Në kuadër të këtij nëngrupi aktivitetet janë përqendruar në hartimin e: Raportit të monitorimit të zhvillimit të tregut me shumicë të gazit në Palët kontraktuese; dhe Inputeve mbi aspektet e funksionimit të tregjeve të gazit në Palët kontraktues për Raportin e Monitorimi të tregjeve të gazit të ACER-it.

- **TF2 – Transparenca**

Monitorimi i transparencës ka përfshirë dy komponentë: Vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat për transparencë të ‘*acquis communautaire*’ të Komunitetit të energjisë, dhe aktivitetin e përbashkët me ‘MedReg’ për krahasimin e arritjeve të transparencës. Puna në kuadër të kësaj task force është konkretizuar me hartimin e 2 raporteve: i) Raporti për



pajtueshmërinë e Palëve kontraktuese me kërkesat për transparencë të ‘acquis communautaire’ të Komunitetit të energjisë; dhe ii) Raporti i përbashkët ECRB-MedReg mbi transparencën.

○ **TF3 – Implementimi i Kodeve të rrjetit**

Me adoptimin nga Komuniteti i Energjisë të Kodeve të rrjetit të Pakos së tretë, implementimi i këtyre kodeve nga Palët kontraktuese është ndër detyrat parësore në agjendën e Komunitetit të Energjisë. Në këtë aspekt Autoritetet rregullative duhet të identifikojnë dhe përzgjedhin modelin më të mirë për implementimin e kodeve të rrjetit.

Aktivitetet në kuadër të kësaj task force janë përqendruar në monitorimin e kongestionit në pikat interkonektive duke konsideruar tregtimin e kapaciteteve në tregjet dytësore dhe përdorimin e kapacitetit ‘me ndërprerje’.

○ **TF4 – Koordinimi i Sistemeve të transmissiionit dhe shpërndarjes**

Koordinimi mes operatorëve të sistemeve të transmissiionit dhe shpërndarjes së gazi ka marrë një rëndësi më të madhë në procesin e hapjes së tregut dhe zhvillimit të kodeve të rrjetit duke përfshirë edhe ndërveprimin mes këtyre dy sistemeve. Aktivitetet janë fokusuar në koordinimi e zhvillimit dhe mirëmbajtjes të rrjeteve të transmissiionit dhe shpërndarjes, kualitetit të gazit në nivel të transmissiionit dhe shpërndarjes, si dhe në modelet e aplikuara për balancim. Në këtë aspekt është përgatitur Raporti analitik për çështjet e përbashkëta të kodeve të rrjetit të transmissiionit dhe shpërndarjes.

#### **4.3.2.3 Grupi punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë**

Në kuadër të ECRB ekziston grupi punues për konsumatorë me nëngrupet e veta, i cili merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve, tarifat dhe çmimet me pakicë, marrëdhëniet kontraktuale mes furnizuesit dhe konsumatorëve, si dhe kualitetin e furnizimit me energji dhe rregullimin e cilësisë së tensionit.

○ **TF1 – Monitorimi i tregut me pakicë**

Monitorimi i tregut është një komponentë themelore e përgjegjësiive rregullative; njoftimi i plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore mundëson që rregullatorët të krijojnë një kornizë efektive që balancon nevojat e pjesëmarrësve të tregut dhe promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficientësinë e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

Në këtë aspekt aktivitetet e këtij nëngrupi përfshijnë: i) hartimin e Raportit të monitorimit mbi funksionimin e tregjeve me pakicë të energjisë elektrike dhe gazit natyrorë në KE; dhe ii) dhënien e inputeve për Raportin e ACEER-CEER për monitorimin e zhvillimit të tregjeve me pakicë.

○ **TF2 – Mbrojtja e konsumatorëve**

Mbrojtja e konsumatorëve konsiderohet si ndër detyrat kryesore të Autoriteteve rregullative, e rrjedhimisht kjo përgjegjësi përcillet edhe në organizatat regjionale/ndërkombëtare si ECRB, CEER dhe MEDREG. Vlerësohet se bashkëpunimi i këtyre 3 trupave regjional është me rëndësi në shkëmbimin e përvojave më të mira dhe efikase në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Ndër aktivitetet kryesore të kësaj task force ka qenë mbajtja e Punëtorisë



tre-palëshe ECRB-CEER-MEDREG ku janë shqyrtuar aspekte të shumta të mbrojtjes së konsumatorëve

○ **TF3 – Kualiteti i furnizimit**

Arritja e një shkalle të kënaqshme të kualitetit të furnizimit në vazhdimësi mbetet një aktivitet bazë i Autoriteteve rregullative, e po ashtu edhe monitorimi i kualitetit të furnizimit me energji elektrike dhe gaz. Aktivitetet e kësaj task force kanë rezultuar me hartimin e Raportit krahasues të përbashkët ECRB-CEER për kualitetin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz, në të cilën janë paraqitur të dhënat respektive për kualitetin e furnizimit në 'Palët kontraktuese' dhe analizat përkatëse.

○ **TF4 – Prodhuesit vetë-konsumues ('Prosumers')**

Në vijim të zhvillimeve të fundit teknologjike, e veçanërisht të teknologjive të BRE-ve (solare fotovoltaike), është rritur interesimi i konsumatorëve për instalimin e këtyre teknologjive për gjenerim dhe vetë-konsum. Në këtë kontekst është i nevojshëm zhvillimi i një kornize specifike, transparente dhe gjithëpërfshirëse për trajtimin e prodhuesve vetë-konsumues të energjisë.

Në kuadër të aktiviteteve përkatëse kjo task-force ka ndërmarrë një hulumtim i cili ka përfshirë: Vlerësimin e niveleve të kapacitetit për kualifikim si konsumatorë vetë-prodhues; procedurat ligjore për pranimin në skemën prodhuesve-vetë-konsumues; identifikimin e barrierave potenciale; dhe ka dhënë rekomandimet për përmirësimet në qasjen ndaj prodhuesve vet-konsumues.

○ **TF5 – Humbjet në rrjetet e energjisë elektrike**

Duke qenë se humbjet drejtpërdrejt ndikojnë në tarifa, atëherë zvogëlimi i humbjeve në rrjet është gjithnjë në fokus të aktiviteteve rregullative me qëllim të rritjes së efikasitetit të operimit të sistemit. Në këtë drejtim kjo task forcë ka hartuar raportin për humbjet e energjisë në rrjet, ku janë dhënë krahasimet me nivelit të humbjeve në EU dhe në Palët kontraktuese të KE, si dhe ka identifikuar praktikatat për llogaritje e humbjeve në rrjet.

#### **4.3.2.4 Grupi punues për REMIT dhe Siguri kibernetike**

Në kuadër të këtij grupi kanë funksionuar 4 task forca:

○ **TF1 – Aspektet procedurale:**

Ku janë trajtuar çështje për hartimin e akteve procedurale për raportim dhe formatin e raportimit, si dhe trajtimin e informatave konfidenciale.

○ **TF2 – Regjistrimi dhe nevojat për teknologji informative:**

Është zhvilluar formati i regjistrimit të pjesëmarrësve të tregut të Palëve kontraktuese si dhe një regjistri në nivel të ECRB-së.

○ **TF3 – Implementimi i Rregullores REMIT nr. 1227/2011:**

Ku janë vlerësuar aspekte të implementimit korrekt të kësaj rregullore dhe ngritja e kapaciteteve profesional për të adresuar çështje të implementimit të rregullores REMIT.

○ **TF4 – Siguria kibernetike:**

Marrë parasysh digjitalizimin në rritje në sektorin e energjisë kjo task forcë ka trajtuar aspekte të ndryshme të sigurisë kibernetike dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për të rritur sigurinë kibernetike në Palët kontraktuese të KE-së.

#### 4.3.3 Pjesëmarrja e Rregullatorit në takimet e organizuara nga institucionet ndërkombëtare

Duke marrë parasysh se rregullimi në sektorin e energjisë është lëmi e cila zhvillohet me një dinamizëm atëherë këto zhvillime nevojiten të përcillen në vazhdimësi. Rregullatori i kushton vëmendje të veçantë pjesëmarrjes në takime, tryeza punuese dhe trajnime. Përveç kontributit të dhënë në këto takime dhe tryeza punuese kjo ndikon në ngritjen e njohurive të stafit të Rregullatorit, si dhe fitimin e përvojës nga praktikatat e rregullimit rajonal dhe ndërkombëtar, që është e domosdoshme për ngritje profesionale.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur një varg takimesh rajonale, tryeza punuese dhe trajnime që kanë kontribuar në ngritjen e mëtejme të njohurive të punonjësve të Rregullatorit, mbi rregullimin e sektorit të energjisë në përputhje me standardet e BE-së.

Më poshtë janë radhitur takimet, tryezat punuese dhe trajnimet të mbajtura gjatë vitit 2019:

- 29 janar 2019 - Takimi i 42-të i Grupit punues për konsumatorë dhe tregut me pakicë në kuadër të ECRB, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri;
- 26 shkurt 2019 - Takimi 46<sup>të</sup> i grupit për energji elektrike të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri;
- 14 shkurt 2019 - Punëtorja “Zbatimi i kodeve të rrjetit të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë”, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri;
- 4-5 prill 2019 - Kongresi i 29-të i EAPM (Asociacioni Evropian për menaxhimin e njerëzve), organizuar nga EAPM dhe Asociacioni Slloven i Burime Njerëzore; Bled, Slloveni;
- 4-5 prill 2019 - Punëtorja “Analiza e kost benefitit të projekteve infrastrukturore të Gazit”; në Budapest, Hungari;
- 27 - 28 maj 2019 - Takimi 47<sup>të</sup> i Grupit për Energji Elektrike (EWG) të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Athinë, Greqi;
- 28 dhe 29 maj 2019 - Forumi i 24<sup>të</sup> për Energji Elektrike i Athinës organizuar nga Komisioni Evropian; Athinë, Greqi;
- 24 - 25 qershor 2019 – Takimi i 43-të i Grupit Punues për Konsumatorë dhe tregut me pakicë në kuadër të ECRB si dhe tryezës së dytë të përbashkët të organizuar në mes CEER-MEDREG-ECRB, organizuar nga Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë; Bruksel, Belgjikë;
- 25 qershor 2019 – Punëtorja e 2-të trilaterale CEER-ECRB-MEDREG Workshop, organizuar nga Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë; Bruksel, Belgjikë;
- 20 shtator 2019 - Forumi i 7<sup>të</sup> i Vjenës për Ligjet Evropiane të Energjisë, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Sektori i Ligjeve për Unionin Evropian i Shkollës për Rregullim e Florencës, Qendra e Robert Schuman për Studime të Avancuara (RSCAS), Instituti i Universitetit Evropian (EUI) i Florencës së Italisë; Vjenë, Austri;

- 23-24 shtator 2019 – Konferenca e 18-të Trajnimi Investimet në energji dhe rregullimi, në Riga, Letoni;
- 03-04 tetor 2019 – Konferencë “100 vjet të interpretimit të konferencave”, “Reflektim mbi të kaluarën dhe perspektivat e së ardhmes”, organizuar nga International Labour Organization – ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës); Gjenevë, Zvicër;
- 17 tetor 2019 – Trajnim për tarifën e shpërndarjes së gazit dhe energjisë elektrike, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri;
- 16-17 tetor 2019 – Trajnim – Barazia Gjinore dhe diversiteti në Autoritetet Rregullatore Kombëtare të Energjisë; organizuar nga Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë; Bruksel, Belgjikë;
- 23 tetor 2019 - Takimi 48<sup>të</sup> i grupit për energji elektrike të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë;
- 24 tetor 2019 - Takimi i dytë i grupit punues për REMIT, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë;
- 25-28 tetor 2019 – Trajnim Identifikimi i menaxhimit të rrezikut në procesin e tenderimit, menaxhimi i procesit të prokurimit; Stamboll, Turqi;
- 28-29 tetor 2019 – Punëtori teknike – Udhëzime për tarifa për sigurinë kibernetike; organizuar nga NARUC dhe USAID; Shkup, Maqedoni e Veriut;
- 05 dhe 06 nëntor 2019 - Takimi 48<sup>të</sup> i grupit për energji elektrike të ECRB - Punëtorja e 3-të ACER - ECRB për Rregulloren (BE) 2015/1222 (CACM), organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austria;
- 14 nëntor 2019 - Shkolla e trajnimit rregullator: Integrimi i BRE-ve, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri;
- 15-18 nëntor 2019 – Trajnim Roli i kontrollit të brendshëm në organizata buxhetore dhe ndërmarrje publike, në menaxhimin e financave publike; Stamboll – Turqi;
- 5-6 dhjetor 2019 Takimi i Grupit punues për konsumatorë dhe tregje me pakicë në kuadër të ERRAs, organizuar nga Asociacioni i Rregullatorëve të Energjisë; Budapest, Hungari;
- 11 dhjetor 2019 – Takimi i shtatë i grupit punues për Sigurinë e Furnizimit: nën grupi i energjisë elektrike; organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në bashkëpunim me Komisionin Evropian; Vjenë, Austri;

#### 4.4 Aktivitetet e prokurimit

Rregullatori është duke u përballur me shumë probleme si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, operimi i zyrës është vështirësuar nga procedurat e stërzgjatura të ndjekura nga AQP, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit. Kjo ka bërë që zyra akoma të mbetet pa shërbime dhe furnizime të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të saj.

## 5 RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN

Rregullatori financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mbliidhen nga ndërmarrjet dhe operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

### 5.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar të hyra në shumë prej 1,329,192.29€. Duke pasur parasysh që shuma totale e buxhetit të shpenzuar nga ZRRE në vitin 2019 është 699,215.18€, të hyrat e pashpenzuara në shume prej 629,977.11€, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Tab. 5.1 Të hyrat

Përshkrimi	Shuma
Të hyrat vetanake 2019	1,329,192.29 €
Shpenzimet 2019	(699,215.18) €
Të hyrat e derdhura në Buxhetin e Republikës së Kosovës	629,977.11 €

### 5.2 Buxheti

Kuvendi i Kosovës me ligjin nr.06/L-133 Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 836,789€, i cili në tërësi është alokuar si grant qeveritar, përkundër faktit që me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE financohet nga të hyrat vetanake dhe vetëm në rastet kur këto të hyra janë të pamjaftueshme, atëherë ZRRE mund të shfrytëzoj ndarje buxhetore në formë të grantit qeveritar. Sipas kategorive ekonomike buxheti i ZRRE-së është si në vijim:

Tab. 5.2 Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	523,457.00 €
Mallra dhe shërbime	219,332.00 €
Shpenzime komunale	22,000.00 €
Shpenzime kapitale	72,000.00 €
Gjithsej	836,789.00 €

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës ( vendimi nr: 03/115 ), buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 108,671.25€ dhe atë 47,060.25€ në kategorinë ekonomike “paga dhe mëditje”, 14,000.00 ne kategorinë ekonomike “mallra dhe shërbime”, 5,611.00 ne kategorinë ekonomike “shpenzime komunale” dhe 42,000.00€ në kategorinë ekonomike “shpenzime kapitale”. Shprehur në përqindje buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 12.98 %.

Është me rëndësi të theksohet se buxheti i ZRRE-së është shkurtuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fund të vitit 2019, për shkak të mos shpenzimit të tij. Arsyeja e mos shpenzimit të buxhetit në kategorinë “paga dhe mëditje” është mos plotësimi i pozitës së Kryesuesit të Bordit dhe katër pozitive të stafit gjatë tërë vitit 2019, ndërsa mos shpenzimi i buxhetit në kategoritë “mallra dhe shërbime” dhe “shpenzime kapitale” ka ndodhur për shkak të mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga ana e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP).

*Tab. 5.3 Buxheti final*

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	476,396.75 €
Mallra dhe shërbime	205,332.00 €
Shpenzime komunale	16,389.00 €
Shpenzime kapitale	30,000.00 €
Gjithsej	728,117.75 €

### 5.3 Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2019, ZRRE ka shpenzuar 699,215.18€.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë si vijon:

*Tab. 5.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike*

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	476,396.75 €
Mallra dhe shërbime	184,955.44 €
Shpenzime komunale	15,089.99 €
Shpenzime kapitale	22,773.00 €
Gjithsej	699,215.18 €

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e mbetur pas shkurtimeve është 96.03%.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën 5.5.

*Tab. 5.5 Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje*

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	476,396.75 €	476,396.75 €	- €	100.00%
Mallra dhe shërbime	205,332.00 €	184,955.44 €	20,376.56 €	90.08%
Shpenzime komunale	16,389.00 €	15,089.99 €	1,299.01 €	92.07%
Shpenzime kapitale	30,000.00 €	22,773.00 €	7,227.00 €	75.91%
Gjithsej	728,117.75 €	699,215.18 €	28,902.57 €	96.03%




Fig. 5.1 Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2019

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tab. 5.6 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe meditjet	Shuma
Pagat neto	396,181.18 €
Tatimi në të ardhura personale	34,844.59 €
Kontributi pensional i punëdhënësit	22,685.49 €
Kontributi pensional i të punësuarve	22,685.49 €
Gjithsej	476,396.75 €

Në këtë kategori të shpenzimeve janë shpenzuar gjithsej 476,396.75€ dhe e gjithë shuma është shpenzuar për pagat e rregullta të stafit të Rregullatorit. Me përjashtim të mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, të cilat paguhen nga mallrat dhe shërbimet, Rregullatori, mëditje tjera nuk paguan.

*Tab. 5.7 Mallrat dhe shërbimet*

Mallrat dhe shërbimet	Shuma
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit	280.00 €
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	13,351.33 €
Mëditje për udhëtim zyrtar jasht vendit	18,883.95 €
Akomodimi për udhëtime zyrtare jasht vendit	9,375.37 €
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jasht vendit	3,368.12 €
Shpenzime për Internet	906.88 €
Shpenzimet e telefonisë mobile	5,143.32 €
Shpenzimet postare	219.40 €
Shërbimet arsimit dhe trajnimit	10,745.00 €
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	4,273.97 €
Shërbime shtypjeje	1,021.50 €
Shërbime kontraktuese tjera	- €
Shpenzimet për anetaresim	6,560.00 €
Mobilje	2,940.00 €
Kompjuter	3,989.70 €
Hardver për TI	1,605.20 €
Pajisje tjera	- €
Furnizime për zyrë	2,837.42 €
Furnizim me pije	3,111.90 €
Akomodimi	- €
Derivate për gjenerator	94.20 €
Karburant për vetura	6,358.35 €
Regjistrimi i automjeteve	420.00 €
Sigurimi i automjeteve	771.24 €
Taksë komunale e rregjistrimit të automjeteve	40.00 €
Sigurimi i ndërtesave	6,745.20 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1,574.20 €
Mirëmbajtja e ndërtesave	3,984.31 €
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	2,701.00 €
Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	- €
Qiraja për ndërtesa	49,140.00 €
Qiraja për pajisje	646.44 €
Qiraja për makineri	11,951.04 €
Reklamat dhe konkurset	- €
Drekat zyrtare	7,056.40 €
Pagesa e tatimit në qira	4,860.00 €
Gjithsej	184,955.44 €

Siç shihet nga tabela 5.7, shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë kategori të shpenzimeve është 184,955.44€.

Shpenzimet buxhetore në baze të aktiviteteve janë si vijon:

*Tab. 5.8 Shpenzimet sipas aktiviteteve*

Shpenzimet sipas aktiviteteve	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit	45,258.77 €
Shërbimet e telekomunikimit	6,050.20 €
Shpenzimet për shërbimet	22,819.87 €
Blerja e mobileve dhe pajisjeve	8,534.90 €
Blerje tjera mallra dhe shërbime	5,949.32 €
Derivate dhe lende djegëse	6,452.55 €
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	7,976.44 €
Mirëmbajtja	8,259.51 €
Qiraja	66,597.48 €
Shpenzimet e marketingut	- €
Shpenzimet e përfaqësimit	7,056.40 €
Gjithsej	184,955.44 €

*Tab. 5.9 Shpenzimet komunale*

Shpenzimet komunale	Shuma
Rryma	13,754.21 €
Uji	449.48 €
Shpenzimet e telefonit	886.30 €
Gjithsej	15,089.99 €

*Tab. 5.10 Shpenzimet kapitale*

Shpenzimet kapitale	Shuma
Pajisje të teknologjisë informative	22,773.00 €
Gjithsej	22,773.00 €

Në këtë kategori të shpenzimeve ZRRE për vitin 2019 ka planifikuar buxhet prej 72,000.00€, për realizimin e dy projekteve, prej të cilave është realizuar vetëm njëri, ndërsa projekti i dytë në vlerë të parashikuar prej 42,000.00€, nuk është realizuar për shkak të moskryerjes së procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, përkundër faktit se iniciimi i procedurave nga ZRRE është bërë në fillim të vitit 2019.



## 6 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

### 6.1 Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike

Sistemi energjetik në Republikën e Kosovës është i përbërë nga gjenerimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike, konsumatorët e parregulluar, si dhe konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë edhe furnizuesit dhe tregtarët me shumicë.

**Gjenerimi** - është kryesisht i bazuar në termocentrale me linjit (TC A dhe TC B) dhe HC Ujmani në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe HC dhe BRE tjera në pronësi private.

**KOSTT** - është operator i vetëm i transmetimit dhe tregut dhe është 100 % në pronësi të Kuvendit të Kosovës. Operon me dy licenca të ndara, licencë për operim të sistemit të transmetimit dhe licencë për operim të tregut. Operatori i tregut ka përgjegjësi organizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, ndërsa Operatori i Sistemit të Transmetimit ka përgjegjësi transmetimin e energjisë elektrike, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, si dhe balancimin e sistemit.

**KEDS** - është operator i vetëm i shpërndarjes dhe është në pronësi private. Ky operator është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe menaxhimin e gjeneratorëve të kyçur në sistemin e shpërndarjes.

**KESCO** - është furnizues që ka licencë për furnizim me energji elektrike, duke përfshirë Obligimin e Shërbimit Publik të përcaktuar nga Rregullatori për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Përveç kësaj Rregullatori i ka caktuar edhe obligimin e furnizuesit të mundësisë së fundit.

**Furnizues tjerë** – deri më tani janë të licencuar 7 furnizues të energjisë elektrike, të cilët janë në pronësi private por ende nuk kanë filluar me operim komercial.

Sistemi elektroenergjetik i Kosovës është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike bazë, e cila bazohet në linjit si lëndë e parë, por jo edhe për mbulimin e ngarkesave maksimale dhe balancimin e sistemit i cili mbetet sfidë e madhe për të gjithë pjesëmarrësit në sektor.

Kosova ka kapacitete të instaluar prodhuese prej 1,431 MW, përfshirë edhe kapacitetet gjeneruese nga BRE, megjithatë kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,099 MW, prej të cilave termocentralet (TC) me linjit përbëjnë rreth 87.36 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga HC Ujmani me 2.91 %, centralin me erë "Kitka" (Air Energy) me 2.95 % dhe BRE tjera (hidrocentralet, panelet solare dhe centralet me erë) me 6.78 %.

Këto kapacitete në periudhën më të madhe do të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën, si edhe për të eksportuar, por për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe jofleksibilitetit të mjaftueshëm për t'iu përshtatur kërkesës në periudha të ndryshme e sidomos në kohën e pikut, atëherë nevojiten importe por ndonjëherë edhe eksporte për balancimin e sistemit. Futja e gjeneratorëve nga BRE-të rritë kapacitetin operativ të gjenerimit, por në shumicën e rasteve ato janë të pa parashikueshme dhe janë në regjimin e prioritetit të dispeçimit, prandaj nuk kanë ndikim në përmirësimin e balancimit të sistemit energjetik, madje ndonjëherë i rrisin jobalancet.

Figura më poshtë paraqet prodhimin, importin, eksportin dhe kërkesën e energjisë elektrike gjatë dhjetë viteve të fundit.




Fig. 6.1 Prodhimi, importi dhe kërkesa e energjisë 2009 - 2019

### 6.1.1 Tregu i energjisë elektrike

Sektori i energjisë elektrike është i ndërlidhur në mënyrë të pandashme me tregun rajonal dhe më gjerë.

Në kuadër të aktiviteteve për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike është krijimi i bursave të tregut një-ditë-para (day ahead) dhe tregut brenda-ditës (intraday), si dhe bashkimi i tregjeve. Gjatë vitit 2019 anëtarë të grupeve punuese si përfaqësuesit e të dy vendeve, Kosovë – Shqipëri, kanë mbajtur disa takime të përbashkëta në lidhje me planin e veprimit për kryerjen e këtyre aktiviteteve për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për formimin e Bursës dhe bashkimit të tregut ndërmjet dy vendeve.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë përfshinë tregtimin bilateral të energjisë elektrike dhe tregtimin për të balancuar sistemin e energjisë elektrike. Bazuar në legjislacionin në fuqi, prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar t’iu ofrojnë kapacitetin e tyre në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuar në treg të gjithë konsumatorëve në tregje me shumicë dhe pakicë duke përfshirë edhe atyre me obligime të shërbimit publik. Të gjithë konsumatorët në treg kanë të drejtën e ndërrimit të furnizuesit të tyre.

Siç është cekur më lartë, për shkak të fleksibilitetit të ulët të sistemit për t’iu përshtatur kërkesës si dhe për shkak të kërkesës së lartë në kohën e pikut, lind nevoja për importe gjegjësisht eksporte të energjisë elektrike. Nga gjithsej kërkesa për energji elektrike në nivel të vendit 6,001 GWh (përfshirë edhe humbjet në transmetim dhe shpërndarje), pjesa më e madhe mbulohet nga prodhimi (gjeneratorët) vendor, kurse pjesa tjetër mbulohet nga importet e energjisë elektrike.

Tabela më poshtë paraqet balancimin e sistemit, prej nga shihet se vendi ynë gjatë vitit 2019 ka qenë neto importues.

*Tab. 6.1 Balancimi i sistemit elektroenergetik*

Balancimi i sistemit elektroenergetik 2019	GWh
Prodhimi nga gjeneratorët në transmetim	5,650
Prodhimi nga gjeneratorët në shpërndarje	68
Importi	928
Gjithsej energjia në disponim	6,646
Eksporti	905
Net import/eksport	-24
Devijimet e sistemit (marrje nga sistemi)	-260
Transiti	1,696
Kërkesa nacionale	6,001
Humbjet në transmetim	105
Konsumi i konsumatorëve në rrjetin e transmetimit	464
Konsumi LLOMAG	110
Ngarkimi në rrjetin e shpërndarjes	5,322
Humbjet në shpërndarje	1,378
Neto konsumi në shpërndarje	3,944

Pjesëmarrja e transitit në rrjetin e sistemit të transmetimit në periudha më të hershme ka qenë shumë më e lartë (madje edhe mbi 50%), por ka trend të rënies sidomos me rritjen e kërkesës vendore. Në vitin 2019, pjesëmarrja e transitit në rrjetin e sistemit të transmetimit është rreth 20.2%.

Lidhur me operimin e rrjetit transmetues duhet përmendur edhe pamundësinë e KOSTT-it për alokimin e kapaciteteve transmetuese për shkak të mos njohjes së KOSTT-it si zonë/bllok rregullues. Alokimi i kapaciteteve do të krijonte të hyra për KOSTT-in që do të mund të shfrytëzoheshin për mirëmbajtjen dhe riparimin e kapaciteteve transmetuese, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja transmetuese aty ku paraqiten ngulfatje të rrjetit. Edhe më tutje alokimin e kapaciteteve për linjat e Kosovës e bënë Operatori i sistemit të transmetimit të Serbisë (EMS), si dhe mbledhë të hyrat financiare nga ky alokim.

Implementimi i marrëveshjes së nënshkruar për energjinë elektrike në mes Kosovës dhe Serbisë ende nuk është realizuar edhe pse ka qenë i paraparë qysh në nëntor 2015, që do të rregullonte funksionimin e KOSTT si zonë/bllok rregullues, alokimin e kapaciteteve, etj.

Për sigurinë e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike nevojitet funksionimi i rregullt i rrjetit të transmetimit, rrjetit të shpërndarjes dhe gjenerimit, përfshirë edhe importin dhe eksportin e energjisë elektrike.

Në figurën 6.2 është paraqitur rrjedha e energjisë elektrike nga gjenerimi, transmetimi deri te shpërndarja te konsumatorët, si dhe rrjedhat e energjisë elektrike drejt rrjeteve rajonale dhe nga rrjetet rajonale përfshirë transitin.




Fig. 6.2 Rrjedhat e energjisë elektrike në sistem në vitin 2019

### 6.1.2 Adekuacia (mjaftueshmëria) e gjenerimit dhe siguria e furnizimit

Gjenerimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, por vlen të theksohet se gjenerimi i energjisë elektrike së bashku me importin plotësojnë kërkesën nacional të energjisë elektrike.

Kapaciteti i përgjithshëm operativ i gjeneratorëve në Kosovë është 1,099 MW, derisa ngarkesa maksimale gjatë këtij viti ka qenë 1,253 MW, andaj raporti i adekuacisë së gjenerimit ndaj ngarkesës maksimale është 87.7 %.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur në baza mujor ngarkesat maksimale dhe minimale gjatë vitit 2019.

Tab. 6.2 Ngarkesat maksimale dhe minimale në vitin 2019

Ngarkesa 2019	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h
Maksimale	1,178	1,105	1,003	887	915	810	759	805	776	927	939	1,253
Minimale	618	535	458	364	327	289	332	349	313	348	417	545

Vlen të theksohet se ngarkesat maksimale ndodhin gjatë sezonit dimëror për shkak të konsumit të energjisë elektrike për ngrohje.

Adekuacia e sistemit të transmetimit përmban rezerva të mjaftueshme për të mundur rrjedha të energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës vendore, përshirë edhe mbulimin e ngarkesës maksimale (pikut), si dhe për të mundur transit nëpër linjat interkonektive.

Tabela më poshtë tregon ngarkesat maksimale dhe minimale ( $P_{max}$  dhe  $P_{min}$ ) të sistemit elektroenergetik të Kosovës ndër vite, kohën e ndodhjes së tyre, prodhimin, si dhe importin dhe eksportin përkatës të energjisë elektrike.

*Tab. 6.3 Ngarkesat maksimale dhe minimale të sistemit elektroenergetik*

Viti	Ngarkesa maksimale							Ngarkesa minimale						
	Pmax			Prodhimi	Importi	Eksporti	Devijimi*	Pmin			Prodhimi	Importi	Eksporti	Devijimi*
	[MW]	Data	Ora	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	Data	Ora	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]
2015	1,129	31.12	20:00	825	308	0	-4	272	30.08	04:00	250	0	50	-72
2016	1,160	31.12	18:00	797	321	0	42	246	12.06	06:00	711	0	310	155
2017	1,161	11.01	20:00	660	415	0	86	286	3.06	06:00	733	50	440	57
2018	1,203	31.12	18:00	787	271	0	145	265	27.06	06:00	577	5	430	-113
2019	1,253	31.12	18:00	861	348	16	60	289	7.06	06:00	435	15	140	21

\* Devijimi i sistemit ndaj sistemit interkonektiv

Energjia elektrike për mbulimin e humbjeve gjatë vitit 2019 ka vazhduar të blihet në tregun konkurrues të energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes sigurohen në mënyrë proporcionale nga energjia e mbetur nga KEK pas alokimit të energjisë për shërbimin universal. Nëse energjia e pranuar nga KEK nuk është e mjaftueshme për mbulimin e humbjeve, atëherë pjesa tjetër e energjisë së nevojshme sigurohet nga importi.

## 6.2 Burimet primare të energjisë

Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit si burim primar i energjisë, që mundësojnë një siguri të prodhimit të energjisë elektrike afatgjate, mirëpo mbetet si problem ndikimi në mjedis për shkak të emetimit të gazrave serrë dhe ndotësve tjerë. Po ashtu vendi ynë disponon me potenciale të BRE-ve siç janë: energjia e ujit, energjia e erës, energjia diellore, biomasa, etj.

### 6.2.1 Prodhimi dhe konsumi i linjtit

Prodhimi i linjtit në vitin 2019 ka qenë 8.06 mil. ton, ndërsa konsumi 8.38 mil. ton, sasi këto që janë më të mëdha në krahasim me vitin 2018.

Prodhimi dhe konsumi i linjtit sipas muajve, për vitin 2019 është paraqitur në tabelën 6.4.

*Tab. 6.4 Prodhimi dhe konsumi i linjtit në vitin 2019*

Prodhimi/konsumi i linjtit	Totali	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Prodhimi i linjtit (t*1000)	8,063	664	798	807	788	525	421	505	580	758	759	855	603
Konsumi i linjtit (t*1000)	8,382	861	755	859	604	541	491	603	635	654	809	780	790
Konsumi i linjtit në treg (t*1000)	266	19	23	20	17	23	23	21	24	27	27	23	19

Në figurën e mëposhtme mund të shihet prodhimi dhe konsumi i linjit gjatë viteve 2009 – 2019.




Fig. 6.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitet 2009 – 2019

## 6.3 Prodhimi i energjisë elektrike

### 6.3.1 Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë janë kryesisht nga termocentralet të cilat përbëjnë 90.02 % të kapacitetit instalues apo 87.36 % të kapacitetit operativ, dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale dhe burimet të ripërtrishme të energjisë (hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike).

Kapaciteti i njësive gjeneruese është paraqitur në tabelën e mëposhtme sipas llojit të burimit primar, kapacitetit instalues dhe operativ, kufijtë minimal dhe maksimal të prodhimit si dhe vitit të futjes në operim.

*Tab. 6.5 Kapacitetet gjeneruese në sistemin elektroenergetik të Kosovës*

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
TC Kosova A1	65	Nuk operon		1962
TC Kosova A2	125	Nuk operon		1964
TC Kosova A3	200	144	100-130	1970
TC Kosova A4	200	144	100-130	1974
TC Kosova A5	210	144	100-135	1975
TC Kosova A	610	432		
TC Kosova B1	339	264	180-260	1983
TC Kosova B2	339	264	180-260	1984
TC Kosova B	678	528		
HC Ujmani	35.00	32.00		1983
HC Lumbardhi	8.08	8.00		(1957) 2006
HC Dikanci	4.02	3.34		(1957) 2013
HC Radavci	1.00	0.90		(1934) 2010
HC Burimi	0.95	0.85		(1948) 2011
Gjithsej HC (jasht skemës mbështetëse)	49.05	45.09		
EGU Belaja	8.06	8.06		2016
EGU Deçani	9.81	9.81		2016
HC Hydroline-Albaniku III	4.27	4.27		2016
HC Brod II	4.80	4.80		2015
HC Restelica 1&2	2.28	2.28		2016
HC Brodi III	4.70	4.70		2016
HC Brezovica	2.10	2.10		2017
HC Orqusha	4.00	4.00		2019
HC Lepenci 3	10.00	10.00		2019
Wind Power	1.35	1.35		2010
Air Energy-Kitka	32.40	32.40		2018
PV LedLight Technology	0.10	0.10		2015
PV ONIX SPA	0.50	0.50		2016
PV Birra Peja	3.00	3.00		2018
PV Frigo Food Kosova	3.00	3.00		2018
PV Eling	0.40	0.40		2019
PV SGE	3.00	3.00		2019
Gjithsej BRE (në skemën mbështetëse)	93.77	93.77		
Gjithsej	1,430.82	1,098.86		

Gjatë viteve të fundit ka rritje në kapacitetet e instaluara gjeneruese nga BRE-të, të cilat vazhdojnë të futën në operim si investime private.

### 6.3.2 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i gjithëmbarshtëm i energjisë elektrike në vitin 2019 ka qenë 5,718 GWh, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5,311 GWh, që do të thotë se ka një rritje prej 7.7 %. Ndërsa, krahasuar me bilancin e


energjisë elektrike për vitin 2019 prodhimi është realizuar rreth 100.4 %. Prodhimi përfshirë edhe shpenzimet vetanake sipas njësive dhe muajve gjatë vitit 2019 është paraqitur në tabelën 6.6.

*Tab. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2019*

Prodhuesit MWh	Gjithsej	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
TC A3 bruto	480,607	53,486	99,208	92,632	0	0	0	0	0	38,339	53,890	62,209	80,844
TC A4 bruto	902,513	48,481	2,178	106,821	76,224	69,197	102,018	109,452	104,914	84,429	89,860	95,680	13,258
TC A5 bruto	983,352	103,544	85,548	20,014	108,590	108,656	58,449	111,611	89,490	106,738	55,234	25,310	110,166
TC A Shpenzvet	288,186	26,756	24,590	26,144	22,456	21,909	18,890	25,449	23,252	27,887	23,585	22,061	25,207
<b>TC A prag</b>	<b>2,078,286</b>	<b>178,755</b>	<b>162,344</b>	<b>193,323</b>	<b>162,358</b>	<b>155,944</b>	<b>141,578</b>	<b>195,615</b>	<b>171,152</b>	<b>201,620</b>	<b>175,398</b>	<b>161,138</b>	<b>179,061</b>
TC B1 bruto	2,197,730	213,445	193,807	213,132	146,196	217,275	194,766	199,422	211,817	41,276	207,255	191,527	167,811
TC B2 bruto	1,478,370	207,993	168,232	193,618	100,464	0	0	0	31,673	208,940	175,010	196,105	196,335
TC B Shpenzvet	350,632	39,080	39,930	37,739	24,010	19,735	18,523	18,687	22,587	22,757	36,042	36,515	35,029
<b>TC B prag</b>	<b>3,325,468</b>	<b>382,358</b>	<b>322,109</b>	<b>369,011</b>	<b>222,650</b>	<b>197,540</b>	<b>176,243</b>	<b>180,736</b>	<b>220,903</b>	<b>227,459</b>	<b>346,223</b>	<b>351,117</b>	<b>329,118</b>
HC+BRE Transmetim	246,088	15,657	18,842	21,596	25,954	29,632	23,395	17,842	18,277	17,989	9,821	25,448	21,633
BRE Shpërndarje	67,965	1,540	3,430	5,774	8,759	12,388	12,259	5,613	3,184	2,150	2,087	4,153	6,629
<b>Gjithsej</b>	<b>5,717,806</b>	<b>578,309</b>	<b>506,725</b>	<b>589,704</b>	<b>419,722</b>	<b>395,503</b>	<b>353,476</b>	<b>399,806</b>	<b>413,516</b>	<b>449,218</b>	<b>533,530</b>	<b>541,856</b>	<b>536,442</b>
Bilanci 2019	5,696,334	564,230	515,533	603,493	406,245	338,507	369,308	372,847	381,574	550,125	533,300	503,277	557,895
Raporti tot./bil	100.4%	102.5%	98.3%	97.7%	103.3%	116.8%	95.7%	107.2%	108.4%	81.7%	100.0%	107.7%	96.2%

Duhet të theksohet se 11.82 % e energjisë nga bruto prodhimi i termocentraleve është konsumuar nga vet termocentralet si shpenzim vetanak. Një pjesë e këtyre shpenzimeve vetanake (për të dy gjeneratorët TC Kosova A dhe TC Kosova B) realizohet drejtpërsëdrejti nga impiantet e brendshme, ndërsa pjesa tjetër futet në sistemin e transmetimit dhe pastaj konsumohet nga termocentralet.

Figura e mëposhtme paraqet pjesëmarrjen e gjeneratorëve në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në vitin 2019.



*Fig. 6.4 Prodhimi i njësive gjeneruese në vitin 2019*

Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2019 ka qenë 246.1 GWh dhe është më i lartë për 0.4 % krahasuar me vitin 2018. Ndërsa prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes



ka qenë 67.9 GWh në vitin 2019, dhe është më i lartë krahasuar me vitin 2018 për 16.8 %, meqenëse janë futur në operim dy gjeneratorë fotovoltaike dhe tre hidro – gjeneratorë me kapacitet gjithsej prej 22.08 MW.

Tabelat e mëposhtme paraqesin prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të të kyçura në rrjetin e transmetimit, përkatësisht në rrjetin e shpërndarjes.

*Tab. 6.7 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2019*

BRE në transmetim	Kapaciteti instalues	Prodhimi	Pjesëmarrja në prodhim*
	MW	MWh	%
HC Ujmani	35.00	82,891	33.68
HC Kaskada Lumbardh	25.95	72,661	29.53
Air Energy/Kitka	32.40	90,535	36.79
<b>Gjithsej BRE</b>	<b>93.35</b>	<b>246,088</b>	<b>100%</b>

\* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në transmetim

*Tab. 6.8 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2019*

BRE në distribucion	Kapaciteti instalues	Prodhimi	*Pjesëmarrja në prodhim
	MW	MWh	%
Hydroline	4.27	8,150	11.99
Dikanci	4.02	8,413	12.38
Radavci	1.00	3,464	5.10
Burimi	0.95	1,197	1.76
Eurokos-JH	4.80	23,292	34.27
HC Brezovica	2.10	3,673	5.40
HC Orqusha	4.00	4,047	5.95
HC Lepenci 3	9.99	5,135	7.55
Me ere	1.35	113	0.17
Solar-C	0.10	118	0.17
Solar-Feti	0.10	92	0.13
Solar Onix	0.50	685	1.01
Solar Birra Peja	3.00	4,130	6.08
Solar Frigo Food	3.00	4,128	6.07
Centrali solar"Eling"	0.40	537	0.79
Centrali Solar Green En	3.00	790	1.16
<b>Gjithsej BRE</b>	<b>42.58</b>	<b>67,965</b>	<b>100%</b>

\* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në distribucion

### **Operimi i njësive gjeneruese**


Operimi i njësive gjeneruese gjatë vitit 2019 ka qenë i përafërt me parashikimet në bilancin energjetik. Pjesëmarrja më e madhe në prodhimin e përgjithshëm është nga TC Kosova A dhe TC Kosova B, që gjithashtu kanë realizuar prodhim të përafërt me parashikimet në bilancin energjetik, si dhe kanë pasur disponueshmëri të lartë në punë duke realizuar orët në operim afërsisht sipas parashikimit në bilanc.

Krahasuar me vitin e kaluar numri i rënieve nga operimi i njësive gjeneruese me linjit ka qenë më i vogël. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha llojet e ndaljeve dhe disponueshmëria e termocentraleve për vitin 2019, ku vërehet se njësitë gjeneruese TC Kosova A3 dhe TC Kosova A4 nuk kanë rënë asnjëherë nga sistemi.

*Tab. 6.9 Ndalesat e njësive gjeneruese 2019*

2019	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	3	3	3	2	1
Ndalesat e paplanifikuara	4	5	1	8	7
Rëniet	0	0	2	2	7
Gjithsej ndalesa	7	8	6	12	15
Orë pune	3,271	6,262	6,802	7,652	5,275

Orët e operimit të njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B në formë grafike janë paraqitur në figurën e mëposhtme dhe kanë qenë afërsisht njëjtë me planifikimin, me variacione sipas njësive, ku njësia B1 ka operuar 87.4 % të vitit, derisa njësia B2 ka operuar 60.2 % të vitit.



*Fig. 6.5 Operimi i njësive gjeneruese në vitin 2019*

Figura e mëposhtme paraqet prodhimin e njësive gjeneruese për periudhën 2009 – 2019.




Fig. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2009 – 2019

## 6.4 Sistemi i transmetimit

Sistemi i transmetimit në Kosovë, operohet nga KOSTT që është përgjegjës për sigurinë dhe besueshmërinë e operimit të sistemit elektroenergjetik. Rrjeti i transmetimit ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar rrjedhat e energjisë në sistem.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe Evropian përmes linjave interkonektive me:

- Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Linja interkonektive 400 kV NS Kosovë B – NS Kashar (Tiranë) është finalizuar në vitin 2016 përfshirë lëshimin me sukses në punë testuese, por për shkaqe politike ende nuk është futur në operim të rregullt.

Marrëveshja e nënshkruar për Rregullimin Sekondar Frekuencë/Fuqi në mes të KOSTT dhe OST të Shqipërisë po ashtu mbetet e pa implementuar meqë KOSTT ende nuk ka filluar të operoj si zonë/bllok rregullues në kuadër të ENTSO-E.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1, përveç linjës Prizren 2 – Rahovec e cila mbetet me furnizim radial.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit:

*Tab. 6.10 Nënstacionet në rrjetin e transmetimit*

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1200
400/110	KOSTT	2	4	1200
220/110	KOSTT	3	9	1350
220/35	Feronikel	1	2	320
220/35/10(20) (Besiana)	KOSTT	1	1	40
220/10(20) (Besiana)	KOSTT	-	1	40
220/10(20)	KOSTT	1	2	80
110/35/10(20)	KOSTT	6	7	277.5
110/35/6.3	Trepça	1	2	126
110/6.3	Trepça	-	2	63
110/35	Ujmani	1	1	20
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/10(20)	KOSTT	14	26	949.5
110/35	KOSTT	7	19	641
110/10	KOSTT	2	8	252
35/110 (Deçan)	Kelkos	-	1	40
Gjithsej		41	90	6,639

*Tab. 6.11 Linjat në rrjetin e transmetimit*

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	279.5
220	KOSTT	240.8
110	KOSTT	892.5
Gjithsej		1,412.8

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë instaluese transformuese, gjatësinë e linjave, si dhe centralet e kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.7 Të dhënat bazë të rrjetit të transmetimit

#### 6.4.1 Rrjedhat e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Nëpër rrjetin e transmetimit ka rrjedha të konsiderueshme të energjisë për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve nga prodhimi vendor dhe importi por edhe për eksportet eventuale të tepriceve të energjisë elektrike, e po ashtu edhe për energjinë e cila transitohet nga vendet tjera. Transiti i energjisë elektrike nëpër rrjetin e Kosovës në vitin 2019 ka qenë rreth 28.3 % krahasuar me kërkesën, dhe kjo energji ngarkon rrjetin duke shtuar humbjet, amortizimin e rrjetit, si dhe nevojën për mirëmbajtje të rrjetit të transmetimit. Kompensimi për ngarkimin e rrjetit nga transiti bëhet përmes Mekanizmit ITC.

Figura e mëposhtme paraqet rrjedhat e energjisë nëpër të gjitha linjat ndërlidhëse (interkonektive) në të dyja drejtimet (hyrje, dalje).




Fig. 6.8 Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse (interkonektive)

#### 6.4.2 Investimet në sistemin e transmetimit

Gjatë vitit 2019 në rrjetin e transmetimit janë bërë investime për përkrahje të ngarkesës dhe gjenerimit. Më poshtë janë paraqitur projektet kryesore të ndara në:

##### *Projektet që kanë përfunduar në vitin 2019 dhe janë në afat garantues njëvjeçar*

Në Q3 të vitit 2016 janë nënshkruar kontratat për projektet, që financohen nga BERZH/KOSTT dhe të cilat kanë përfunduar gjatë vitit 2019. Këto projekte janë në afatin garantues njëvjeçar.

- Ndërtimi i nënstacioneve të reja GIS me dy transformatorë 2x40MVA dhe linjat/kabllo transmetuese:
  - 110/10(20) kV – NS Prishtina 6 ( Dardania) dhe dy fusha 110 kV HIS në NS Prishtina 4
  - 220/10(20) kV – NS Drenasi 2

- 110/10(20) kV – NS Mitrovica 2 (Ilirida)

#### **Projektet që janë në vazhdimësi dhe duhet të përfundojnë në vitin 2020**

Vazhdimësia e punëve është deri Q2 2020 për projektet:

- Linja 110 kV e njëfishtë ajrore NS Rahoveci – NS Theranda (janë përfunduar 80%),
- Linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, nga pika e prerjes së linjës NS Kosova A – NS Lipjan, deri në NS Fushë Kosova, (15%)

\*\*Për shkak të vonesave në marrjen e lejeve ndërtimore ka vonesa në implementimin e projekteve bazuar në kontratë.

#### **Projektet që kanë filluar në vitin 2018/2019, janë në implementim dhe janë në vazhdimësi, duhet të përfundojnë në vitin 2022**

- Punimi i kyçjeve në rrjet të qytetit të ujit dhe kanalizimit në NS Prizreni 1, NS Prizreni 3, NS Lipjani, NS Viti, NS Ferizaji 1 ( në vazhdimësi për NS tjera);
- Renovimi i ndërtesave Komanduese në: NS Deçani, NS Lipjani, NS Burim, NS Viti, NS Prishtina 3, NS Prizreni 3, NS Gjakova 2, NS Besiana, NS Vitia, NS Gjakova 1 (në vazhdimësi për NS tjera);
- Furnizimi me pjesë rezervë për linja vjerrëse dhe shtrënguese, OPGW, joint-box dhe pajisje tjera përcjellëse;
- Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione;
- Realizimi i furnizimit të pandërprerë të infrastrukturës të operimit të sigurtë të sistemit të transmetimit në kohë reale të OS;
- Furnizimi me monitor digjital të murit të QND dhe demontimi i monitorit ekzistues në QND;
- Furnizim me harduer;
- Furnizimi me pajisje për adoptim të funksioneve të SCS;
- Blerja e Softuerit DLP dhe softuerit për auditim të Bazave të të Dhënave.

Këto projekte janë të financuara nga KOSTT.

### **6.4.3 Ngarkesat maksimale dhe kërkesa për energji në sistemin elektroenergjetik**

Për të analizuar funksionimin e sistemit elektroenergjetik, ndër të tjera rëndësi ka edhe vlera e ngarkesave maksimale (pikut) e për këtë merren zakonisht pesë (5) ngarkesat maksimale të realizuara në orë dhe ditë të ndryshme të vitit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) për vitin 2019.

*Tab. 6.12 Vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) në vitin 2019*

Ngarkesa maksimale P <sub>max</sub> (MW)	Data	Ora
1,253	12/31/2019	18:00
1,193	12/29/2019	18:00
1,178	1/8/2019	18:00
1,177	1/4/2019	18:00
1,138	1/14/2019	18:00

Ngarkesa maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës është regjistruar me 31 dhjetor 2019 në orën 18:00 në vlerë 1,253 MW, që është më e lartë se ngarkesa maksimale në vitin 2018 (1,203 MW).

Kërkesa ndryshon në periudha ditore dhe sezonale, dhe për shkak të këtij ndryshimi vështirësohet balancimi i sistemit. Për të parë këtë ndikim, sidomos për rastin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, është me rëndësi analiza e diagramit ditor të konsumit për çdo orë të ditës për tërë periudhën vjetore.

Në diagramin më poshtë është paraqitur kërkesa, prodhimi dhe shkëmbimi i energjisë elektrike, nga ku shihet se prodhimi është më i lartë se kërkesa gjatë orëve të natës, ndërsa gjatë periudhës ditore, posaçërisht në orët e mbrëmjes, kërkesa ka rritje të dukshme dhe është më e lartë se prodhimi. Pra, brenda të njëjtës ditë, në orët e ditës (tarifa e lartë) prodhimi nuk e mbulon kërkesën dhe nevojitet të importohet energji elektrike, ndërsa gjatë natës (tarifa e ulët) ka teprica të energjisë elektrike të cilat duhet të eksportohen.




Fig. 6.9 Diagrami ditor si mesatare vjetore për orë për vitin 2019

Dallimi në mes të mesatares mujore të maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë muajve të vitit 2019 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.






Fig. 6.10 Mesatarja mujore e kërkesës dhe ngarkesat maksimale/minimale ditore 2019

Dallimi në mes prodhimit dhe kërkesës së përgjithshme mund të vërehet edhe në diagramet e mëposhtme si në baza ditore po ashtu edhe sezonale. Diagramet paraqesin muajt karakteristikë janar – sezoni dimëror dhe korrik – sezoni veror. Po ashtu nga diagramet shihet se në çdo ditë ka importe dhe eksporte të energjisë elektrike me sistemin rajonal, varësisht prej prodhimit dhe konsumit vendor. Luhatjet e konsumit janë në bazë ditore, ndërsa ka edhe ndryshime në mes kërkesës në sezonin dimër-verë, mesatarja e maksimumeve mbi 1000 MWh/h në janar, dhe në mes 600-700 MWh/h në korrik.




Fig. 6.11 Realizimi për orë i prodhimit, konsumit dhe shkëmbimit, janar 2019




Fig. 6.12 Realizimi për orë i prodhimit, konsumit dhe shkëmbimit, korrik 2019

#### Reduktimet si pasojë e mungesës së energjisë elektrike

Me gjithë përpjekjet për eliminimin e reduktimit të furnizimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike, gjatë viteve janë realizuar reduktime. Bordi i ZRRE në fund të vitit 2018 ka nxjerrë vendimin për ndalimin e reduktimeve për mungesë të energjisë, përveç në rastet kur rrezikohen stabilitetet, prandaj në vitin 2019 nuk ka pasur reduktime për mungesë të energjisë elektrike.

Figura më poshtë paraqet reduktimet për mungesë të energjisë elektrike ndër vite.




Fig. 6.13 Reduktimet e konsumit gjatë viteve 2009 - 2019

#### 6.4.4 Kërkesa për energji elektrike dhe humbjet në rrjetin e transmetimit

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike në vitin 2019 ka qenë 6,001 GWh dhe paraqet një rritje të konsiderueshme prej 5.8 % krahasuar me vitin 2018, kur ka qenë 5,671 GWh, kurse krahasuar me parashikimin në bilancin elektroenergetik 2019 kërkesa është për 1.19 % më e ulët.

Në tabelën 6.13 është paraqitur kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në transmetim të realizuara në vitin 2019 dhe të krahasuara me bilancin elektroenergetik 2019.

*Tab. 6.13 Kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në rrjetin e transmetimit në vitin 2019*

2019	Kërkesa bruto realizim	Kërkesa bruto bilanci	Raporti Realiz./Bilanc	Humbjet në transmetim realizimi		Humbjet në transmetim bilanci	
	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	696,427	669,672	104.00	13,753	1.97	12,675	1.89
Shkurt	556,085	594,769	93.50	9,791	1.76	11,127	1.87
Mars	549,544	550,690	99.79	10,450	1.90	13,036	2.37
Prill	479,939	478,081	100.39	8,473	1.77	8,068	1.69
Maj	464,029	424,842	109.22	6,910	1.49	7,146	1.68
Qershor	388,948	403,144	96.48	6,225	1.60	7,276	1.80
Korrik	416,678	430,868	96.71	6,337	1.52	7,935	1.84
Gusht	429,125	444,789	96.48	6,688	1.56	8,388	1.89
Shtator	389,873	416,327	93.65	6,239	1.60	11,101	2.67
Tetor	456,911	478,523	95.48	8,103	1.77	10,682	2.23
Nëntor	504,932	548,713	92.02	9,175	1.82	11,017	2.01
Dhjetor	668,711	632,886	105.66	13,345	2.00	12,242	1.93
<b>Gjithsej</b>	<b>6,001,202</b>	<b>6,073,305</b>	<b>98.81</b>	<b>105,489</b>	<b>1.76</b>	<b>120,692</b>	<b>1.99</b>

Kërkesa për energji elektrike ka pasur rritje të vazhdueshme deri në vitin 2011, ndërsa nga viti 2011 ka stabilizim të kërkesës, me luhatje të vogla nga viti në vit, dhe në vitin e fundit vërehet një rritje që mund të shihet në figurën e mëposhtme.



*Fig. 6.14 Kërkesa e përgjithshme në sistemin elektroenergetik 2009-2019*

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike ndahet në konsumin e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit, konsumin në sistemin e shpërndarjes (përfshirë humbjet), konsumin vetanak për

nevojat e stabilimenteve prodhuese, si dhe humbjet e transmetimit, dhe kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme e ndarë sipas kategorive për vitin 2019.

*Tab. 6.14 Kërkesa sipas kategorive dhe humbjet e energjisë*

Kërkesa për energji 2019	Total
	MWh
Konsumi bruto në shpërndarje*	5,321,999
Konsumatorët e parregulluar	464,110
Konsumi intern i KEK-ut	109,604
Humbjet në transmetim	105,489
<b>Kërkesa e përgjithshme</b>	<b>6,001,202</b>
Shpenzimet vetanake të KEK nga transmetimi	135,411

(\*) Energjia elektrike e pranuar në shpërndarje nga transmetimi + prodhimi në shpërndarje

Vlera e energjisë elektrike për shpenzime vetanake në vitin 2019, që është marrë nga rrjeti i transmetimit është 108 GWh për gjeneratorët e TC Kosova A dhe 27 GWh për TC Kosova B, apo gjithsej 135 GWh.


Kërkesa për energji elektrike ndryshon sipas periudhës së shpenzimit por edhe sipas kategorive të konsumatorëve, dhe kjo është paraqitur në formë tabelare në vijim ku janë përfshirë edhe humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (humbjet teknike dhe komerciale)

*Tab. 6.15 Pjesëmarrja e kategorive të ndryshme në kërkesën e përgjithshme 2019*

2019/GWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Konsumi në amvisëri	2,515	289.4	223.2	230.2	199.7	198.1	173.2	177.8	189.3	164.8	188.6	206.0	275.2
Konsumi komercial	1,020	101.2	89.0	84.9	75.2	74.9	74.6	85.7	90.6	77.1	78.5	84.9	103.1
Konsumi industrial	873	72.2	50.8	77.1	74.4	76.1	69.8	77.9	78.4	69.1	80.8	74.9	72.2
Humbjet komerciale	694	105.0	101.1	72.7	60.7	54.2	23.4	24.2	19.5	27.6	44.2	63.4	98.0
Humbjet teknike	684	103.6	71.8	63.4	52.2	46.4	35.2	37.2	37.2	36.0	46.7	56.7	97.1
Humbjet në transmetim	105	13.8	9.8	10.4	8.5	6.9	6.2	6.3	6.7	6.2	8.1	9.2	13.3
Kons. i mbr. i KEK-ut	110	11.3	10.3	10.9	9.3	7.5	6.5	7.5	7.5	9.1	10.0	9.9	9.8
<b>Gjithsej</b>	<b>6,001</b>	<b>696.4</b>	<b>556.1</b>	<b>549.5</b>	<b>479.9</b>	<b>464.0</b>	<b>388.9</b>	<b>416.7</b>	<b>429.1</b>	<b>389.9</b>	<b>456.9</b>	<b>504.9</b>	<b>668.7</b>

Në tabelën 6.15 paraqitet ndryshimi i kërkesës sipas muajve, te disa kategori ky ndryshim është mjaft i theksuar, si p.sh. konsumi familjar dhe humbjet komerciale që janë më të larta në sezonin dimëror, gjë që është kryesisht për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Humbjet në sistemin e transmetimit, që një periudhë të konsiderueshme (vitet 2011-2019) janë në nivel të pranueshëm falë investimeve të bëra nga KOSTT-i. Humbjet në rrjetin e transmetimit të Kosovës janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë. Në figurën 6.15 janë paraqitur humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit ndaj kërkesës përgjithshme të sistemit elektroenergjetik të Kosovës.



*Fig. 6.15 Humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit 2009-2019*

Në figurë janë paraqitur humbjet në përqindje të kalkuluar ndaj kërkesës vendore, ndërsa për nivelin e humbjeve në transmetim ndikon e tërë energjia e futur në sistemin e transmetimit. Pra për kalkulimin e përqindjes së humbjeve ndaj ngarkimit të rrjetit të transmetimit duhet që të përfshihen përveç kërkesës vendore edhe rrjedhat tjera siç është transiti si dhe energjia për shpenzimet vetanake të gjeneratorëve, etj. Përqindja e humbjeve në transmetim e llogaritur në këtë formë është 1.25 %.

Sipas vendimit të qeverisë të vitit 2012 për transferin e një pjese të asetëve të sistemit të shpërndarjes në sistemin e transmetimit, pika matëse në mes dy rrjeteve është në anën sekondare të transformatorëve (35 kV apo 10 kV). Në NS Vallaq, KOSTT nuk ka arritur të vendos njehsorët interval në anën sekondare, prandaj në mekanizmin balancues për kalkulimin e humbjeve në transmetim janë marrë vlerat nga njehsorët interval të vendosur në anën primare të transformatorëve. Sipas matjeve për jo balance (që bazohen në njehsorë interval) humbjet në rrjetin e transmetimit janë 105.5 GWh, ndërsa nga leximet mujore në anën sekondare të transformatorëve në NS Vallaq humbjet në rrjetin transmetues janë 108.8 GWh. Në të njëjtën mënyrë energjia e konsumuar në veri është 294.3 GWh, ndërsa sipas matjeve mujore në anën sekondare të transformatorëve në NS Vallaq kjo vlerë është 290.5 GWh.

## 6.5 Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstacionet përkatëse të nivelit 35/x kV, 10(20)/0.4 kV dhe 6/0.4 kV.

Të dhënat bazike të nënstacioneve dhe linjave përfshirë kapacitetin, transformimin dhe gjatësinë e linjave të sistemit të shpërndarjes janë paraqitur në tabelat në vijim.

*Tab. 6.16 Nënstationet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH*

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia e instaluar (MVA)
35/10	KEDS	44	94	662
35/10	Privat	10	14	63
35/20	KEDS	1	1	4
35/6 kV	Privat	5	8	43
35/0.4kV	Privat	17	23	22
10(20)/0.4	KEDS	2,487	2,579	1,324
10(20)/0.4	Privat	2,394	2,404	1,147
10/20	KEDS	3	3	8
10/0.4	KEDS	2,865	2,865	868
10/0.4	Privat	1,247	1,253	606
6(3)/0.4	KEDS	66	66	13
6/0.4	Privat	1	1	1
Gjithsej		9,141	9,312	4,762

*Tab. 6.17 Linjat në OSSH*

Tensioni (kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjithsej (km)
35 kV	KEDS	482	131	613
10(20) kV	KEDS	1,471	474	1,946
10 kV	KEDS	4,165	904	5,069
6 kV	KEDS	42	8	50
3 kV	KEDS	4	1	5
0.4 kV	KEDS	17,187	2,445	19,632
Gjithsej		23,351	3,963	27,314

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë transformuese (VA), gjatësinë e linjave, si dhe centralet kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.16 Të dhënat bazë të sistemit të shpërndarjes

### 6.5.1 Investimet në sistemin e shpërndarjes

Investimet në Rrjetin e Shpërndarjes rrisin funksionimin e sistemit të shpërndarjes në mënyrë që të arrihet një furnizim i besueshëm me energji elektrike, të rritet kapaciteti i rrjetit ekzistues. Investimet përfshijnë projekte në rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët si dhe në projekte në digjitalizimin dhe modernizimin e rrjetit siç janë SCADA, njehsorët e mençur PLC etj.

Realizimi i investimeve të vitit 2019 përfshinë projekte që janë planifikuar për vitin 2019 dhe si vazhdimësi të viteve të kaluara. Projektet janë përzgjedhur duke analizuar nevojën për investime në fushat më kritike duke i vlerësuar ato përmes kriterëve të përparësisë për të arritur objektivat kryesore të investimeve, siç janë:

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe jo teknike,
- Furnizimi i besueshëm dhe më cilësor me energji elektrike,

- Rritja e kapaciteteve ekzistuese të rrjetit dhe modernizimi i rrjetit.

Projektet janë zgjedhur duke analizuar kriteret teknike si:

- Humbjet,
- Ngarkesa e rrjetit,
- Rëniet e tensionit,
- Nr. i ndërprerjeve,
- Kërkesa e energjisë,
- Rritja e konsumit,
- Vjetërsia e rrjetit,
- Numri i konsumatorëve.

Projektet e tensionit të mesëm në 2019 janë realizuar kryesisht në zonat Ferizaji, Fushë Kosova dhe Dragash për të zgjidhur problemet e rritjes së shpejtë të konsumit, mbingarkesës së rrjetit dhe përmirësimit të parametrave teknik.

Projektet e përfortimit në rrjetin e tensionit të ulët janë realizuar në Podujevë, Drenas, Prishtinë, Deçan, Gjakovë dhe Mitrovicë.

Projektet e investimeve të vitit 2019 janë paraqitur në dy pjesë, si "Projektet brenda fushëveprimit të viteve të kaluara të përfunduara në vitin 2019" dhe "Projektet e investimeve të planifikuara për vitin 2019".

#### [Projektet brenda fushëveprimit të viteve të kaluara të përfunduara në vitin 2019](#)

##### [Investimet në daljet 10 kV](#)

###### *Projekti: Hogoshti (Viti i planifikuar: 2018)*

Dalja 10 kV Hogoshti furnizohet nga NS Berivojca dhe është dalja më e gjatë në Kosovë. Me këtë rast bëhet ndarja e daljes në dy dalje, dhe nga ky investim do të përfitojnë 1968 konsumatorë. Projekti ka përfunduar në vitin 2019.

###### *Projekti: Zahaqi –Kastrati (Viti i planifikuar: 2018)*

Në daljet Zahaqi furnizohen shumë biznese. Me këtë investim shkarkohet ngarkesa nga dalja Kastrati, pasi një nga degët e saj do të furnizohet nga Zahaqi. Edhe dalja Fusha e Pejës lidhet në Zahaq. Nga ky investim përfitojnë 1913 konsumatorë, i cili ka përfunduar në vitin 2019.

###### *Projekti: Fushe Kosova 2 - Apollonia (Viti i planifikuar: 2018)*

Investimet në daljet Fushe Kosova 2 dhe Apollonia shkarkojnë daljen Apollonia, ngarkesa e të cilës është në rritje. Nga ky investim kanë përfituruar 971 konsumatorë, ndërsa projekti ka përfunduar në vitin 2019.

###### *Projekti: Plemetin - Fidanishte (Viti i planifikuar: 2018)*

Investimet në daljet Plemetin dhe Fidanishte shkarkon daljet Plemetin, Lumi i madh dhe Palaj dhe përfitojnë konsumatorët e daljeve Plemetin, Lumi i Madh, Shkabaj dhe Palaj, me një numër të përgjithshëm prej 2476 konsumatorëve. Ky projekt ka përfunduar në vitin 2019.

##### [Shndërrimi i daljeve në nivelin 20 kV](#)

Që nga viti 2017, OSSH ka filluar konvertimin e daljeve 10 kV në nivelin e tensionit 20 kV. Projektet që kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2019 janë paraqitur si më poshtë.

###### *Projekti: Breznica (Viti i planifikuar: 2017)*



Në këtë dalje investimet kanë filluar në vitin 2018, ndërsa transformatori ngritës i tensionit dhe energjizimi i daljes në nivelin e tensionit 20 kV është bërë në vitin 2019. Nga ky projekt përfitojnë 576 konsumatorë.

*Projekti: Drenica (Viti i planifikuar: 2017)*

Dalja Drenica është zgjedhur si pilot projekt për konvertim në nivelin e tensionit 20kV, dhe me këtë investim përfitojnë rreth 2611 konsumatorë. I gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, por energjizimi i daljes në nivelin e tensionit 20 kV është bërë në vitin 2019.

*Projekti: Runiku (Viti i planifikuar: 2018)*

Investimet në daljen Runiku në Skenderaj janë bërë në shndërrim nga niveli i tensionit 10kV në 20kV. Zbatimi dhe energjizimi i projektit ka vazhduar në vitin 2019 dhe përfundon në vitin 2020. Nga ky investim përfitojnë 1772 konsumatorë.

#### Projektet e përforcimit të rrjetit në tensionin e ulët

Një numër i projekteve të përforcimit në tensionin e ulët janë bartur nga vitet e kaluara në vitin 2019. Për shkak të disa pengesave nga vitet 2015 deri 2018 në vitin 2019 janë bartur 92 projekte.

#### Projektet investive të planifikuara në 2019

##### Investimet në rrjetin e tensionit të mesëm (TM)

*Projekti: Linja e re 35 kV nga NS-Zhur 35/10 kV në NS-Dragash 35/10 kV (Viti i planifikuar: 2019)*

Në kuadër të projekteve emergjente, është ndërtuar linja 35 kV nga NS-Zhur 35/10 kV në NS-Dragash 35/10 kV. Implementimi i projektit ka filluar në Mars 2019, dhe ka përfunduar në Gusht 2019.

*Projekti: Investimi në rrjetin 35 kV dhe 20 kV në Fushë Kosova (Viti i planifikuar: 2019)*

Po ashtu në kuadër të projekteve emergjente janë ndërtuar linjat e reja 35 kV dhe dy nënstacionet e reja 35/20 kV në qendër të qytetit. Daljet 10 kV planifikohen të shndërrohen në nivelin e tensionit 20 kV, duke përdorur topologjinë e unazore mes nënstacioneve. 15,134 konsumatorë do të përfitojnë nga ky projekt. Projektet në nivelin 35 kV, si dhe në 20 kV, pritet të përfundojnë në tremujorin e parë të vitit 2020.

*Projekti: Investimi në rrjetin 35kV dhe 10 kV në Ferizaj (Viti i planifikuar: 2019)*

Linjat e reja 35 kV janë planifikuar mes nënstacioneve TL/TM dhe TM/TM, në kuadër të investimeve emergjente, duke krijuar kështu një topologji unazore në rrjetin 35 kV. Numri i përgjithshëm i konsumatorëve që do të përfitojnë nga investimi është 23,283. Projektet në nivelin 35 kV si dhe në 10 kV pritet të përfundojnë në tremujorin e parë të vitit 2020.

##### Investimet në rrjetin e tensionit të ulët

Investimet në tensionin e ulët në Planin e Investimeve 2019 janë realizuar në rajonet Podujevë, Drenas, Prishtinë, Deçan, Gjakovë dhe Mitrovicë. Numri i përgjithshëm i projekteve në rrjetin TU është 114.

Investimet e bëra në projektet e tensionit të ulët përfshijnë:

- Transformatorë të rinj në zonat që kanë nevojë për investime,
- Zëvendësimi i transformatorëve ekzistues me ata të ri për rritjen e kapacitetit,
- Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët,

- Përforcimi i rrjetit të tensionit të mesëm brenda fushëveprimit të projekteve të TU, në përputhje me planet e ardhshme të daljeve të TM,
- Vendosja e MMO-ve, që do të thotë lëvizja e njehsorëve jashtë në shtyllë ose në ormanë tokësorë të njehsorëve,
- Kyçja e konsumatorëve në njehsorët e vendosur jashtë shtëpive.

Si përfundim, për të gjitha investimet e vitit 2019 përfshirë investimet e bartura dhe planifikuara në vitin 2019, në rrjetin TM dhe TU, janë shpenzuar materiale si më poshtë:

- Transformatorë 102 copë,
- Shtylla 9,240 copë,
- Kuti të njehsorëve 9,232 copë,
- Panel shpërndarës 128 copë,
- KIOSK 21 copë,
- Kthina 191 copë,
- Kabllo 1,326,656 m,
- Përçues 309,999 m,
- Koka kabllorike 2,570 copë.

#### Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit të TM dhe TU

Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit të TM dhe TU ka qenë ndër punët kryesore të realizuara gjatë vitit 2019, të paraqitura më poshtë:

- Ndërimi i shtyllave të TM dhe TU,
- Pastrimi i trasesë së rrjetit të TU dhe TM si masë preventive në krijimin e kushteve për punë të linjave pa qenë të afektuar nga faktorët e jashtëm si degët e pemëve etj.,
- Ndërimi i përçuesve dhe shtrëngim i tyre, ndërim i izolatorëve, shkarkuesve të mbitensionit, konzollave dhe çdo elemente tjetër që mund që të bëhet burim i prishjes,
- Zhvendosja e linjave 10 kV dhe 0.4 kV me qëllim të mirëmbajtjes dhe rregullimit sa më të lehtë të prishjeve,
- Përforcimi i bazamaneteve të trafoshtyllave, shtyllave të konstruksionit metalik,
- Rregullimi i trafo-blindave, konstruksionit metalik të tyre,
- Ndërimi i transformatorëve të dëmtuar.

Gjatë vitit 2019 janë pastruar nga vegjetacioni gjithsej 204 linja 0.4, 10(20) dhe 35 kV me gjatësi 319.69 km.

#### Realizimi i Projekteve PLC

Për zvogëlimin e humbjeve komerciale dhe teknike gjatë vitit 2019 janë realizuar 73 projekte PLC në shtatë distrikte, ku janë afektuar 5,028 konsumatorë.

#### Realizimi i projekteve me rënie të tensionit në nivelin 0.4 kV.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar gjithsej 168 projekte që kanë rënie të tensionit në nivelet 10(20) dhe 0.4 kV dhe që kanë afektuar 4,886 konsumatorë. Janë shpenzuar material të shumta si, përçues, kablllo, lidhëse, stabilimente shpërndarëse, ndërprerësa, shtylla, e tjera, si dhe 74 transformatorë.

- Lidhëse kabllorike 1,555 copë,
- Papuqe 5,471 copë,
- Koka kabllorike 602 copë,
- Kabull 166,868 m,

- Stabilimente shpërndarëse 7 copë,
- Përçues 17,409 kg,
- Kthina 41 copë,
- Ndarës 39 copë,
- Izolatorë 5,408 copë,
- Gëzhoja 5,085 copë,
- Ndërprerës te TU 73 copë,
- Panele te TU 106 copë,
- Kutia të njehsorëve 1,244 copë,
- Shtylla 2,231 copë,
- Shkarkues te mbitensionit 461 copë,
- Transformator 74 copë.

#### Investimet në pikën matëse

OSSH ka investuar në vendosjen e njehsorëve të rinj, duke i ndërruar ata mekanikë me njehsorë digjital, me mundësi leximi nga distanca. Gjatë vitit 2019 janë investuar njehsorët si në vijim:

- 2,922 njehsorë me matje direkte me komunikim GSM GPRS,
- 18,078 njehsorë me matje direkte me PLC,
- 196 njehsorë me matje gjysmë indirekte dhe indirekte, prej të cilëve 148 janë njehsorë të ri dhe 48 njehsorë të ndërruar,
- 10,039 njehsorë mekanik që janë ndërruar me digjital,
- 25,972 njehsorë të dedikuar për lidhje të reja.

#### Investimet në SCADA

Projekti SCADA është planifikuar të ndërtohet në tri faza. Faza e parë dhe e dytë e projektit tashmë kanë përfunduar, ndërsa faza e tretë pritet të përfundohet në fund të vitit 2020, siç paraqitet më poshtë:

- Me fazën e parë të projektit të SCADA-s është bërë monitorimi dhe kontrollimi i 21 NS;
- Me fazën e dytë të projektit të SCADA-s është bërë monitorimi dhe kontrollimi i 19 NS;
- Qendra Kryesore e Kontrollës së SCADA-s dhe serverët kanë mbaruar në vitin 2018;
- Integrimi i DMS/OMS/Qendrës së Thirrjeve/GIS/CIS është në vazhdim;
- Faza e tretë e projektit të SCADA do të filloj së shpejti dhe është paraparë të përfundoj në fund të vitit 2020.

### **6.5.2 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje**

OSSH është e organizuar në shtatë distrikte: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjlani.

Të dhënat për konsumin, humbjet teknike dhe komerciale si dhe të dhëna tjera janë të llogaritura sipas distrikteve dhe sipas muajve të vitit.

Konsumi më i lartë është realizuar në distriktin e Prishtinës me 32 % ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, ndërsa konsumi më i ulët është në distriktin e Gjilanit me 8.4 % të konsumit të përgjithshëm.

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje sipas distrikteve përfshirë edhe humbjet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën 6.18. Të dhënat për distriktin e Mitrovicës përfshijnë edhe konsumin në veri i cili është konsideruar në kategorinë e humbjeve komerciale.

*Tab. 6.18 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2019*

Distriktet	Ngarkesa në distrikte	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtina	1,688,271	1,319,059	212,889	12.61	156,323	9.26	369,211	21.87
Mitrovica	774,088	334,388	72,307	9.34	367,393	47.46	439,700	56.80
Peja	579,057	430,467	80,834	13.96	67,757	11.70	148,591	25.66
Gjakova	469,995	364,637	79,406	16.89	25,953	5.52	105,358	22.42
Prizreni	670,820	541,162	91,756	13.68	37,903	5.65	129,658	19.33
Ferizaji	692,440	567,867	95,266	13.76	29,307	4.23	124,573	17.99
Gjilani	447,328	386,736	51,052	11.41	9,541	2.13	60,592	13.55
Gjithsej	5,321,999	3,944,315	683,508	12.84	694,177	13.04	1,377,684	25.89

Në tabelën 6.19 janë paraqitur kërkesa (ngarkesa), energjia e faturuar si dhe humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje sipas muajve.

*Tab. 6.19 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje në vitin 2019*

Muajt	Ngarkesa	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	633,129	424,555	103,560	16.36	105,014	16.59	208,574	32.94
Shkurt	515,867	342,900	71,823	13.92	101,144	19.61	172,967	33.53
Mars	485,515	349,400	63,438	13.07	72,677	14.97	136,115	28.04
Prill	420,106	307,209	52,167	12.42	60,729	14.46	112,896	26.87
Maj	406,102	305,499	46,374	11.42	54,229	13.35	100,604	24.77
Qershor	337,905	279,250	35,216	10.42	23,438	6.94	58,654	17.36
Korrik	359,745	298,249	37,250	10.35	24,246	6.74	61,495	17.09
Gusht	371,582	314,905	37,176	10.00	19,501	5.25	56,677	15.25
Shtator	338,372	274,750	35,986	10.64	27,637	8.17	63,623	18.80
Tetor	392,928	302,010	46,739	11.90	44,179	11.24	90,918	23.14
Nëntor	446,781	326,684	56,675	12.69	63,421	14.20	120,097	26.88
Dhjetor	613,968	418,903	97,103	15.82	97,962	15.96	195,065	31.77
<b>Totali i realizuar</b>	<b>5,321,999</b>	<b>3,944,315</b>	<b>683,508</b>	<b>12.84</b>	<b>694,177</b>	<b>13.04</b>	<b>1,377,684</b>	<b>25.89</b>
<b>Totali sipas bilanc</b>	<b>5,158,260</b>	<b>3,740,590</b>	<b>537,204</b>	<b>10.41</b>	<b>880,466</b>	<b>17.07</b>	<b>1,417,670</b>	<b>27.48</b>

Humbjet teknike sipas të dhënave të dërguara nga OSSH arrijnë vlerën 12.84 %, ku ndikim në nivelin e lartë të këtyre humbjeve kanë vjetërsia e rrjetit, gjatësia e linjave, kualiteti dhe lloji i përcuesve dhe transformatorëve, ngarkimi i pajisjeve, si dhe mirëmbajtja e tyre.

Humbjet komerciale janë mjaft të larta, dhe përbëjnë 7.51 % të gjithsej kërkesës në shpërndarje, por kësaj duhet shtuar edhe energjia e pa faturuar në pjesën veriore të Kosovës që përbën 5.53 % (294 GWh) të kërkesës së përgjithshme në shpërndarje, prandaj gjithsej humbjet jo-teknike janë 13.04 %.

Humbjet totale në sistemin e shpërndarjes janë të matura dhe paraqesin diferencën mes energjisë në hyrje të shpërndarjes dhe energjisë së faturuar. Meqenëse nuk mund të maten veçmas humbjet teknike dhe ato komerciale, atëherë ndarja e këtyre humbjeve bëhet përmes kalkulimit të humbjeve teknike përmes softuerëve përkatës, ndërsa humbjet komerciale më tej kalkuloohen si diferencë mes humbjeve totale dhe atyre teknike.

Kërkesa e energjisë elektrike në shpërndarje në vitin 2019 është realizuar në vlerën 5,322 GWh, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5,120 GWh, që paraqet një rritje përafërsisht 3.94 %.

Kërkesa në sistemin e shpërndarjes ka rritje të vazhdueshme, sikurse edhe kërkesa e përgjithshme, dhe kjo rritje është paraqitur në figurën 6.17, ku janë paraqitur të dhënat nga viti 2009 deri 2019.




Fig. 6.17 Kërkesa për energji elektrike në sistemin e shpërndarjes 2009-2019

Edhe përkundër investimeve të realizuara deri më tani në rrjetin e shpërndarjes, humbjet e energjisë elektrike ende mbeten të larta dhe paraqesin problem shqetësues për sektorin e energjisë elektrike. Humbjet po ashtu kanë ndikim negativ edhe në furnizimin e konsumatorëve dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve të furnizimit dhe shpërndarjes, si dhe tërë sektorin e energjisë.

Zvogëlimi i humbjeve komerciale ka ndikim pozitiv edhe në uljen e konsumit, e me këtë edhe në zvogëlimin e ngarkesës së rrjetit dhe humbjet teknike.

Kostoja e humbjeve të energjisë elektrike deri në nivelin e përcaktuar nga Rregullatori mbulohet nga tarifa e konsumatorëve. Operatori i sistemit të shpërndarjes bënë përpjekje të vazhdueshme për zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje, mirëpo pavarësisht zvogëlimit të humbjeve ndër vite, OSSH nuk ka arritur të përmbush caqet e përcaktuara nga Rregullatori, që do të thotë se kostoja e pjesës së tejkaluar e këtyre caqeve bartet nga vet OSSH.

Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat për humbjet teknike, komerciale dhe humbjeve gjithsej në shpërndarje nga viti 2009 deri 2019, ku shihet trendi i zvogëlimit të humbjeve por edhe luhatjet në nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale.




Fig. 6.18 Humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje për periudhën 2009-2019

Në përgjithësi humbjet e energjisë elektrike në OSSH janë zvogëluar nga 27.9 % sa ishin në vitin 2018 në 25.9 % ndaj kërkesës në shpërndarje.

## 6.6 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike ka të bëjë me shitjen e energjisë elektrike tek konsumatorët fundor dhe përfshinë furnizimin e konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal dhe konsumatorëve të parregulluar.

Furnizimi me energji elektrike gjatë vitit 2019 është realizuar nga furnizuesi me obligim të shërbimit universal, i cili ka furnizuar konsumatorët me çmime të rregulluara si dhe konsumatorët me çmime të parregulluara për të cilët është mbajtur llogari e veçantë.

Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të faturuar edhe më tutje mbetet dominues me rreth 57.06 %, e pasuar nga konsumi komercial me 22.48 %, e pastaj nga konsumi industrial me 19.81 %, dhe në fund nga konsumi në ndriçimin publik me 0.65 %. Kërkesa bruto është rritur për 5.83 %, konsumi i konsumatorëve familjar është rritur rreth 5.97 %, konsumi i konsumatorëve komercial po ashtu ka ngritje prej 7.7 % si dhe konsumi në industri ka ngritje prej 24.01 % në krahasim me vitin e kaluar.

Në figurën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive të konsumit krahasuar me konsumin e përgjithshëm (e paraqitur me humbje dhe pa humbje).




Fig. 6.19 Pjesëmarrja e kategorive të konsumit - me dhe pa humbje 2019

### 6.6.1 Faturimi dhe arkëtimi

Energjia e faturuar në sistemin e shpërndarjes në vitin 2019 ka qenë 3,944 GWh dhe paraqet rreth 74.1 % ndaj ngarkesës së sistemit të shpërndarjes, e që krahasuar me vitin 2018 është më e lartë për 2.03 pikë përqindje.

Tabela 6.20 paraqet faturimin, arkëtimin për energji dhe arkëtimin bruto të shpërndarjes si dhe raportin mes faturimit dhe arkëtimin për energji sipas muajve për vitin 2019, ku shihet se në disa muaj ky raport është më i lartë se vlera 100 %, që nënkupton se në këta muaj është arkëtuar energjia elektrike e faturuar për muajt paraprak.

Tab. 6.20 Faturimi dhe arkëtimi sipas muajve në shpërndarje për vitin 2019

Shpërndarja 2019	Ngarkesa	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi për energji	Arkëtimi bruto	Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	€	%
Janar	633,129	424,555	28,430,862	24,437,335	25,192,853	86.0%
Shkurt	515,867	342,900	23,600,410	23,703,165	24,406,514	100.4%
Mars	485,515	349,400	24,266,194	23,947,375	24,797,457	98.7%
Prill	420,106	307,209	21,699,458	22,330,858	23,035,833	102.9%
Maj	406,102	305,499	21,564,261	26,613,326	27,462,796	123.4%
Qershor	337,905	279,250	20,146,707	19,065,438	19,768,969	94.6%
Korrik	359,745	298,249	21,681,433	20,712,256	21,534,596	95.5%
Gusht	371,582	314,905	22,881,862	22,465,745	23,329,739	98.2%
Shtator	338,372	274,750	20,204,952	20,695,328	21,503,833	102.4%
Tetor	392,928	302,010	21,643,358	20,359,614	21,161,936	94.1%
Nëntor	446,781	326,684	23,194,877	20,368,900	21,179,043	87.8%
Dhjetor	613,968	418,903	28,892,444	22,214,341	23,347,856	76.9%
Gjithsej	5,321,999	3,944,315	278,206,817	266,913,681	276,721,423	95.9%

Energjia elektrike e faturuar dhe arkëtuar (bruto) në shpërndarje si dhe raporti mes faturimit dhe arkëtimit bruto nga viti 2009 deri në 2019 është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.20. Faturimi dhe arkëtimi në shpërndarje gjatë viteve 2009-2019

Niveli i arkëtimit vetëm për energji në shpërndarje ka qenë 95.94%, ndërsa arkëtimi bruto ndaj faturimit në shpërndarje për vitin 2019 ka qenë 99.47 %, kurse kur llogariten edhe konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmetimit të cilët arkëtimi është 100 %, atëherë arkëtimi i përgjithshëm arrin në 99.51 %.

Konsumi i kategorizuar sipas nivelit të tensionit dhe grupeve të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike për vitin 2019 është dhënë në tabelën 6.21.

Tab. 6.21 Energjia elektrike e faturuar sipas kategorive tarifore 2019

Kategoritë (MWh)	Gjithsej	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
220 kV (Ferronikeli)	371,177	34,029	12,911	34,482	34,090	35,554	31,857	35,538	35,318	27,986	35,001	30,701	23,709
110 kV (Trepça)	20,592	1,758	1,724	2,002	1,747	1,735	1,675	1,495	1,540	1,550	1,789	1,584	1,993
110 kV (Sharrcem)	72,341	2,504	5,443	6,240	6,187	6,221	4,758	6,042	6,455	6,661	9,131	6,824	5,875
35 kV	47,011	3,555	3,345	3,995	3,905	3,826	3,885	4,204	4,136	3,851	4,088	4,006	4,215
10 kV	362,320	30,350	27,339	30,401	28,423	28,725	27,601	30,573	30,919	29,008	30,828	31,795	36,359
Amv isnia	2,515,348	289,413	223,193	230,154	199,655	198,094	173,171	177,799	189,279	164,782	188,590	206,032	275,186
0.4 kV I	392,798	36,798	33,729	31,019	29,357	29,661	29,858	34,771	35,226	30,237	32,296	32,613	37,234
0.4 kV II	598,291	61,774	53,003	51,586	43,745	43,227	43,028	49,017	53,291	44,647	43,515	49,195	62,264
Ndriqimi publik	28,546	2,665	2,291	2,246	2,125	1,965	1,708	1,886	2,055	2,224	2,691	3,044	3,645
<b>Gjithsej faturuar</b>	<b>4,408,424</b>	<b>462,847</b>	<b>362,978</b>	<b>392,124</b>	<b>349,233</b>	<b>349,009</b>	<b>317,541</b>	<b>341,324</b>	<b>358,218</b>	<b>310,947</b>	<b>347,930</b>	<b>365,793</b>	<b>450,480</b>
Konsumi KEK	109,604	11,253	10,349	10,855	9,335	7,506	6,529	7,521	7,542	9,064	9,960	9,867	9,821
Humbjet KEDS	1,377,684	208,574	172,967	136,115	112,896	100,604	58,654	61,495	56,677	63,623	90,918	120,097	195,065
Humbjet KOSTT	105,489	13,753	9,791	10,450	8,473	6,910	6,225	6,337	6,688	6,239	8,103	9,175	13,345
<b>Gjithsej</b>	<b>6,001,202</b>	<b>696,427</b>	<b>556,085</b>	<b>549,544</b>	<b>479,939</b>	<b>464,029</b>	<b>388,948</b>	<b>416,678</b>	<b>429,125</b>	<b>389,873</b>	<b>456,911</b>	<b>504,932</b>	<b>668,711</b>



Energjia elektrike e shpenzuar në sistemin e transmetimit dhe në sistemin e shpërndarjes në vitin 2019 ka qenë 4,518 GWh, ndërsa energjia e faturuar ka qenë 4,408 GWh, e që shprehur në vlerë monetare (përfshirë edhe TVSH) është 306.0 mil€, ndërsa arkëtimi bruto është 304.5 mil€.

Tabela e mëposhtme paraqet faturimin, arkëtimin, si dhe raportin në mes arkëtimin dhe faturimit.

*Tab. 6.22 Faturimi dhe arkëtimi në vitin 2019*

Energjia e faturuar dhe arkëtuar 2019	Ngarkuar	Faturuar	Faturimi	Arkëtimi bruto	Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	%
Konsumatorët e rregulluar	5,321,999	3,944,315	278,206,817	276,721,423	99.47%
Konsumatorët e parregulluar	464,110	464,110	27,801,482	27,801,482	100.00%
Gjithsej	5,786,109	4,408,424	306,008,300	304,522,905	99.51%

Më poshtë është paraqitur tabela me të dhënat për numrin e konsumatorëve sipas kategorive, faturimin dhe konsumin mesatar për pikat matëse sipas kategorive.

*Tab. 6.23 Numri i konsumatorëve dhe faturimi sipas kategorive për vitin 2019*

Konsumi sipas kategorive 2019	Pika matëse (PM)	Gjithsej faturimi	Konsumi per PM	Pjesëmarrja në konsum
	copë	MWh	MWh	
220 kV (Ferronikeli)	1	371,177	371,177	8.42%
110 kV (Trepça + Sharrcem)	2	92,933	46,466	2.11%
35 kV	35	47,011	1,343	1.07%
10 kV	390	362,320	929	8.22%
Familjar (amvisëria)	517,486	2,515,348	4.86	57.06%
0.4 kV I	2,543	392,798	154	8.91%
0.4 kV II	82,912	598,291	7.22	13.57%
Ndriqimi publik	2,307	28,546	12	0.65%
Total	605,676	4,408,424	420,094	100.00%

### **Çmimi mesatar i energjisë elektrike**

Varësisht nga kategoria e konsumatorëve, niveli i tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe shfrytëzimi i energjisë elektrike në tarifa të ndryshme sipas kohës në të cilën është shfrytëzuar energjia, ndryshon edhe çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike. Ky çmim mesatar i shitjes (pa TVSH) është paraqitur në figurën 6.21. Çmimi mesatar i shitjes poashtu ndryshon edhe sipas distrikteve varësisht nga koncentrimi i aktiviteteve komerciale/industriale që shfrytëzojnë energji elektrike në periudha të caktuara.

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është 5.68 €cent/kWh që është pak më i lartë se në vitin 2018, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është 7.33 €cent/kWh që është pak më i ulët se çmimi mesatar në vitin 2018.




Fig. 6.21 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike 2019 (pa TVSH)

Në figurën më poshtë janë paraqitur çmimet mesatare të energjisë elektrike për konsumatorët familjar dhe jo-familjar për dhjetë vitet e fundit, çmime të cilat nuk përfshijnë TVSH.





Fig. 6.22 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike (pa TVSH) ndër vite

Çmimi mesatare pa TVSH për konsumatorët familjar është paraqitur në figurën e mëposhtme për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 për disa shtete, të nxjerra nga Eurostat, meqë mungojnë ende të dhënat për gjashtëmujorin e dytë. Të dhënat e Eurostat-it janë të kategorizuara sipas konsumit, dhe në figurë është paraqitur vlera e konsumit prej 2500-5000 kWh, që më së afërmi i korrespondon konsumit mesatar të një familjeje kosovare.



\*Burimi i të dhënave nga EUROSTAT

Fig. 6.23 Çmimet mesatare për konsumatorët familjar për 6 mujorin e parë 2019 (pa TVSH)

## 6.7 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Kërkesa për energji elektrike në sistemin elektroenergjetik të Kosovës mbulohet nga gjenerimi vendor dhe nga importi i cili realizohet përmes linjave ndërkufitare.

Kërkesa totale për energji elektrike në vend është mbuluar nga importi në nivelin prej 15.47 %, duke shënuar rritje për rreth 0.9 pikë përqindje në raport me vitin e kaluar e që ishte rreth 14.55 %.

Përmes linjave interkonektive nga sistemi rajonal në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, kanë hyrë 2,481,130 MWh, ndërsa kanë dalë 2,197,154 MWh, ku 283,977 MWh paraqet ndryshimin në mes hyrje-dalje, ndërsa kjo ndahet në neto importin dhe devijimet ndaj sistemit rajonal.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive me vendet fqinje.

Tab. 6.24 Rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive për vitin 2019

Rrjedha në linjat interkonektive MWh	400 kV		220 kV		110 kV		Gjithsej	
	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim
Shqipëria			279,079	195,874			279,079	195,874
Maqedonia	84,457	1,400,701					84,457	1,400,701
Mali i Zi	600,799	362,143					600,799	362,143
Sërbia	1,390,934	59,663	108,958	61,211	16,902	117,563	1,516,795	238,436
Gjithsej	2,076,191	1,822,506	388,038	257,085	16,902	117,563	2,481,130	2,197,154
Bilanci		-253,685		-130,952		100,661		-283,977

Importi i realizuar për vitin 2019 ka qenë 928,492 MWh, me të cilin janë plotësuar mungesat e energjisë sidomos në kohën e pikut në sezonin e dimrit kur kërkesa ishte e papërballueshme për prodhimin vendor.

Kjo sasi përfshinë energjinë elektrike të importuar për konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar, për humbjet në rrjetin e transmetimit dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes, e cila është siguruar përmes kontratave komerciale si dhe përmes shkëmbimit energji për energji në mes të KEK dhe KESH.

Importi i energjisë elektrike për vitin 2019 ka qenë rreth 13 pikë përqindje më i lartë se sa në vitin 2018 që ishte 825,182 MWh.

Energjia elektrike e importuar me kontrata komerciale gjatë vitit 2019 ka qenë 894,062 MWh në vlerë prej 50,132,368 €, me çmim mesatar prej 56.07 €/MWh. Edhe pse në HUPX çmimi mesatar i vitit 2019 krahasuar me çmimin mesatar të vitit 2018 ka qenë më i ulët për vetëm 0.64 €/MWh, tek ne krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit çmimi mesatar i importit është më i ulët për 10.27 €/MWh.

Të dhënat për importet dhe eksportet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën në vijim.

*Tab. 6.25 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për vitin 2019*

Importi/Eksport MWh	Importi me kontrata	Importi si shkëmbim	Gjithsej Importi	Eksporti me kontrata	Eksporti si shkëmbim	Gjithsej Eksporti	Net Imp/Eksp
Janar	110,407	0	110,407	27,995	0	27,995	-82,412
Shkurt	49,284	18,360	67,644	38,069	4,414	42,483	-25,161
Mars	47,474	0	47,474	108,020	13,547	121,567	74,093
Prill	82,430	0	82,430	47,640	5,293	52,933	-29,497
Maj	94,176	5,650	99,826	29,155	2,892	32,047	-67,779
Qershor	68,856	0	68,856	44,891	4,731	49,622	-19,234
Korrik	56,903	4,960	61,863	56,942	8,243	65,185	3,322
Gusht	86,865	0	86,865	69,001	10,029	79,030	-7,835
Shtator	42,451	0	42,451	100,093	14,358	114,451	72,000
Tetor	51,050	5,460	56,510	127,829	35,381	163,210	106,700
Nëntor	63,263	0	63,263	109,922	241	110,163	46,900
Dhjetor	140,903	0	140,903	45,346	957	46,303	-94,600
Gjithsej	894,062	34,430	928,492	804,903	100,086	904,989	-23,503

Duke pasur parasysh lakoren e konsumit gjatë orëve brenda ditës, dhe jo-fleksibilitetin e njërive gjeneruese për të përcjellë konsumin, shihet se në raste të ndryshme paraqiten mungesa dhe teprica të energjisë, madje kjo ndodhë edhe në të njëjtën ditë. Pra në disa orë të së njëjtës ditë ka importe dhe eksporte të energjisë elektrike, edhe për faktin se hapja e tregut ka ndikuar që konsumatorët të zgjedhin burimin e furnizimit me energji, pa u kufizuar në burimet vendore të prodhimit.

Tepricat e energjisë elektrike janë kryesisht në orët e natës (në kohën e tarifës së ulët). Në këto periudha edhe në sistemet rajonale paraqiten teprica, rrjedhimisht rriten ofertat për energji gjatë natës, dhe kjo ndikon që çmimet e eksportit të jenë dukshëm më të ulëta se sa çmimet e importit.

Energjia elektrike e eksportuar me kontrata komerciale gjatë vitit 2019 ka qenë 804,903 MWh me çmim mesatar prej 39.69 €/MWh. Përveç eksportit me kontrata, gjithashtu është eksportuar edhe një sasi e energjisë elektrike si shkëmbim (energji për energji) në mes të KEK dhe KESH. Sasia e energjisë së eksportuar si shkëmbim është 100,086 MWh. Gjithsej eksporti i energjisë elektrike për

vitin 2019 ka qenë 904,989 MWh, e që është rreth 34 pikë përqindje më i lartë se sa në vitin 2018 që ishte 676,815 MWh.

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lartë, në vitin 2019 Kosova ka qenë neto importuese e energjisë elektrike dhe atë në sasi prej 23,503 MWh, të paraqitura sipas muajve në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.24 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike në vitin 2019

Çmimi i importit dhe eksportit të energjisë elektrike gjatë viteve 2000 - 2019 ka shënuar ngritje dhe rënie. Më poshtë është dhënë figura ku janë paraqitur çmimet e importit dhe eksportit nga viti 2000 deri 2019.




Fig. 6.25 Çmimi mesatar i importit dhe eksportit gjatë viteve

## 6.8 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Bordi i ZRRE konform dispozitave ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L-084 dhe Ligjit për Energjinë Elektrike Nr.05/L – 085, me datë 05.06.2019 ka miratuar Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike. Qëllimi i Rregullës në fjalë është të përcaktohen treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit.

Shërbimet e furnizimit me energji elektrike të cilat janë të përfshira në rregull janë:

- cilësia e shërbimit;
- furnizimi pandërprerë; dhe
- cilësia e tensionit.

Në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike janë të paraqitura treguesit (indikatorët) individual dhe të përgjithshëm të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike, treguesit e furnizimit të pandërprerë, si dhe treguesit e cilësisë së tensionit.

Duhet theksuar se standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë element i rëndësishëm i rregullimit të sektorit të energjisë. Këto standarde përcaktohen në mënyrë që cilësia e furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, si dhe cilësia e tensionit të konsumatorët të përmirësohet vazhdimisht prej ndërmarrjes së energjisë.

Edhe gjatë këtij viti raportues janë monitoruar standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike sipas fushave në vijim:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit; dhe
- Cilësia komerciale.

### 6.8.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e sistemit energjetik, përkatësisht paraqet numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve për çdo konsumator brenda një viti.

Gjatë vitit 2019, kontinuiteti i furnizimit me energji elektrike është monitoruar nga Rregullatori për të dy operatorët e sistemit: Operatorin e sistemit të transmetimit (OST) dhe Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH).

Kontinuiteti i furnizimit matet me anë të indekseve:

- SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem;
- SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem; dhe
- ENS - Energjia e pafurnizuar.

#### 6.8.1.1 Indekset matëse të raportuara nga OST

Indekset matëse të raportuara nga KOSTT për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2019 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 1.89 orë;

- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.37 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.52;
- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.41;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 1.556 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.402 GWh.




Fig. 6.26 Indikatorët matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për KOSTT për vitin 2019

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga KOSTT për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2015 – 2019.



Fig. 6.27 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për KOSTT për periudhën 2015 - 2019

Sipas të dhënave të raportuara nga KOSTT për indeksin matës SAIDI, konstatohet se në total ky indeks zbritje apo përmirësim prej -1.30 % gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018, e kjo kryesisht për shkak të punimeve të bëra në rrjetin e transmetimit. Duhet theksuar se te indeksi SAIDI gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018 ka rritje të ndërprerjeve të planifikuara dhe atë për 1.58 %, e kjo për shkak të punimeve të bëra në rrjetin e transmetimit, ndërsa ka zbritje të ndërprerjeve të paplanifikuara prej -13.65 %.

Për indeksin matës SAIFI, nga të dhënat e raportuara konstatohet se në total ky indeks gjatë vitit 2019 ka zbritje apo përmirësim prej -103.23% në krahasim me vitin 2018. Duhet theksuar se te indeksi SAIFI gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018 ka zbritje të këtij indeksi te ndërprerjet e planifikuara prej -32.69 %, si dhe zbritje te ndërprerjet e paplanifikuara prej -192.68 %.

Ndërsa sa i përket energjisë së pafurnizuar – ENS, gjatë vitit 2019 ka zbritje apo përmirësim të këtij indeksi për -31.26 % në krahasim me vitin 2018, respektivisht ka zbritje te ndërprerjet e planifikuara prej -40.87 %, ndërsa rritje te ndërprerjet paplanifikuara 6.35 %.

#### 6.8.1.2 Indekset matëse të raportuara nga OSSH

Indekset matëse të raportuara nga OSSH mbi standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2019 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka 20.47 orë;
- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 48.35 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 6.76;



- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 47.26;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 10.74 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 33.51 GWh.




Fig. 6.28 Indeksat matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për vitin 2019

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur indeksat matëse të raportuara nga OSSH për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2011 – 2019.




Fig. 6.29 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për periudhën 2011-2019

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se indekset matëse SAIDI, SAIFI në vitin 2019 në përgjithësi kanë pasur përmirësim të theksuar në krahasim me vitin 2018, e kjo si rezultat i investimeve të bëra rrjetin e shpërndarjes.

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës SAIDI gjatë vitit 2019, vërehet se ka përmirësim të dukshëm të këtij indeksi krahasuar me vitin 2018, që do të thotë se në vitin 2019 ka zbritje të ndërprerjeve për -60.07 % në krahasim me vitin 2018. Duhet theksuar se gjatë analizave më detale të bëra indeksit – SAIDI, vërehet se në vitin 2019 ka zbritje për ndërprerjet e planifikuara prej -119.49 % në krahasim me vitin 2018, si dhe zbritje për ndërprerjet e paplanifikuara për -34.91 % në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Nga analiza e bërë indeksit matës SAIFI, vërehet se gjatë vitit 2019 vërehet se ka përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2018, që do të thotë se në vitin 2019 ka zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të energjisë elektrike për konsumator – SAIFI dhe atë për -24.31 % në krahasim me vitin 2019. Gjatë analizave më detale të bëra indeksit – SAIFI, vërehet se në vitin 2019 ka zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të planifikuara për konsumator (SAIFI) për -92.90 % në krahasim me vitin 2019, si dhe zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të paplanifikuara për konsumator për -14.49 % në krahasim me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019 energjia e pafurnizuar (ENS) në përgjithësi ka përmirësim krahasuar me vitin 2018, e që sipas të dhënave vërehet se në vitin 2019 ka zbritje për -12.52 % në krahasim me vitin 2018. Në vitin 2019 ka zbritje të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të planifikuara për -65.08 % në krahasim me vitin 2018, ndërsa rritje të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të paplanifikuara për 4.52 %, në krahasim me vitin 2018.

### **6.8.2 Cilësia e tensionit**

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Gjatë vitit 2019, numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët në OSSH lidhur me cilësinë e tensionit ka qenë 278 ankesa, prej të cilave janë zgjidhur 156 apo 56.12 %, në proces të shqyrtimit janë 72 apo 25.90 %, ndërsa të pa zgjidhura kanë mbetur 50 ankesa apo 17.99 %.




Fig. 6.30 Ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit në vitin 2019


Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e statusit të ankesave të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit në OSSH për vitin 2019.



Fig. 6.31 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2019

Pra, nga figura e mësipërme vërehet se OSSH nga 156 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit, prej tyre 128 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 82.05 %, ndërsa 50 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 17.95 %.

Më poshtë në figurë janë paraqitur ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit sipas viteve, ku shihet se deri në vitin 2017 ka pasur rritje të vazhdueshme të ankesave të konsumatorëve për cilësi të tensionit, ndërsa në vitin 2018 dhe 2019 vërehet se kemi rënie të ankesave të konsumatorëve për cilësi të tensionit, dhe atë 2019 në krahasim me vitin 2018 ka rënie prej 184.89 %



*Fig. 6.32 Ankesat për cilësi të tensionit sipas viteve*

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, në Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes së shpërndarjes.

### 6.8.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Rregullimi i cilësisë komerciale merr parasysh marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit.

Me qëllim të analizimit të cilësisë komerciale, të dhënat e marra nga i licencuari janë paraqitur në dy kategori të cilat prekin drejtpërdrejt çështjet e konsumatorëve. Këto kategori janë:

- Kyçjet/lidhjet e reja;
- Pëlqime energjetike; dhe
- Ankesat e konsumatorëve

#### 6.8.3.1 Lidhjet e reja


Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, hyjnë edhe lidhjet e reja, përmes së cilave evidentohet se sa shpejtë ndërmarrja e energjisë merr masa për realizimin e kyçjeve/lidhjeve të reja.

Gjatë viti 2019 në KESCO janë regjistruar gjithsej 27,664 kërkesa të rregullta për lidhje të re për grupet tarifore 4, 5, 6, 7 dhe 8, ndërsa janë aprovuar 25,830 apo 93.37 % kërkesa për lidhje të reja, ndërsa pjesa e mbetur është në proces të regjistrimit. Duhet të ceket se kërkesa për lidhje të reja të bartura nga viti paraprak kanë qenë 1,774.

Nga të dhënat e KESCO-s, shihet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja më së shumti kërkesa ka pasur nga konsumatorët shtëpiak (grupi tarifor 5, 6 dhe 7) 19,539 apo 70.63 %, pasuar nga kërkesat për lidhje të reja të grupit tarifor komercial 0.4 kV Kategoria II – grupi tarifor 4 që kanë qenë 3,726 apo 13.47 %, ndërsa kërkesa për grupit tarifor 8 - Ndriçimi publik kanë qenë 195 apo 0.70 %. Gjithashtu duhet theksuar se prej numrit të përgjithshëm të kërkesave për lidhje të reja, 4,204 kërkesa apo 15.20 % kanë qenë të kategorive të padefinuara, e kjo për shkak se aplikuesit për


lidhje të re në kërkesat e tyre nuk kanë specifikuar kategorinë e konsumatorit dhe këto kërkesa regjistrohen te kjo kategori.

Nga numri i përgjithshëm i regjistrimeve të aplikuesve si konsumatorë në programin e faturimit “CCP”, konsumatorë shtëpiak janë 21,976 apo 85.08 %, pasuar nga grupi tarifor 4 (0.4 kV Kategoria II – komercial) me 3,608 regjistrime apo 13.97 %, si dhe grupi tarifor 8 (ndriçimi publik) me 246 regjistrime apo 0.95 %.



*Fig. 6.33 Lidhjet e reja sipas distrikteve për vitin 2019*

Nga diagrami i mësipërm vërehet se për vitin 2019 nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja, më së shumti kërkesa janë regjistruar në distriktin e Prishtinës prej 8,955 apo 32.37 %, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 5,089 apo 18.40 %, ndërsa më së paku kërkesa për lidhje të reja janë regjistruar në distriktin e Pejës prej 2,414 apo 8.73 %. Gjithashtu, duhet theksuar se sa i përket regjistrimeve të kërkesave në programin e faturimit nga numri i përgjithshëm, më së shumti regjistrime ka qenë në distriktin e Prishtinës prej 8,037 apo 31.11 %, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 4,569 apo 17.69 %, ndërsa më së paku regjistrime janë evidentuar në distriktin e Gjakovës prej 1,946 apo 7.53 %.



*Fig. 6.34 Lidhjet e reja sipas viteve*

Nga diagrami i mësipërm vërehet se gjatë vitit 2019 ka pasur 5.42 % më shumë kërkesa për lidhje të reja se sa në vitin 2018, dhe 0.51 % më pak regjistrime të konsumatorëve se sa në vitin 2018.

### 6.8.3.2 Pëlqimet Elektroenergjetike

Nga të dhënat e prezantuara shihet se gjatë vitit 2019 në KEDS janë parashtruar 1,557 kërkesa për Pëlqime Elektroenergjetike, ndërsa të bartura nga viti 2018 kanë qenë 45 pëlqime.

*Tab. 6.26 Pëlqimet Elektroenergjetike për vitin 2019*

Distriktet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Prishtina	12	22	45	33	29	25	41	28	37	44	40	26	382
Mitrovica	10	15	6	17	20	11	13	11	13	27	12	14	169
Peja	6	10	8	8	12	16	16	7	11	6	14	10	124
Gjakova	6	11	11	7	13	7	9	9	11	11	5	9	109
Prizreni	9	14	23	18	12	6	25	24	14	14	12	10	181
Ferizaj	15	36	43	31	52	18	38	35	34	46	38	48	434
Gjilani	13	15	15	16	13	8	11	13	13	11	14	16	158
<b>Gjithsej</b>	<b>71</b>	<b>123</b>	<b>151</b>	<b>130</b>	<b>151</b>	<b>91</b>	<b>153</b>	<b>127</b>	<b>133</b>	<b>159</b>	<b>135</b>	<b>133</b>	<b>1,557</b>


Nga tabela e mësipërme vërehet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2019, më së shumti kërkesa janë regjistruar në distriktin e Ferizajit dhe atë 434 apo shprehur në përqindje 27.87 %, pasuar nga distrikti i Prishtinës prej 382 apo 24.53 %, ndërsa më së paku kërkesa ka pasur në distriktin e Gjakovës prej 109 apo 7.00 %.

**Tab. 6.27 Pëlqimet Elektroenergjetike sipas distrikteve për vitin 2019**

Distriktet	Kërkesa për PEE 2019	Të shqyrtuara - PEE	Të shqyrtuara - Informatë	Në proces	Dërguar departamenteve tjera
Prishtina	382	266	103	8	17
Mitrovica	169	99	60	2	9
Peja	124	85	35	1	9
Gjakova	109	78	23	1	8
Prizreni	181	119	48	1	18
Ferizaj	434	282	135	7	26
Gjilani	158	101	51	5	5
<b>Gjithsej</b>	<b>1,557</b>	<b>1,030</b>	<b>455</b>	<b>25</b>	<b>92</b>

Nga tabela e mësipërme nga 1,557 kërkesa të aplikuesve për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2019 dhe 45 të bartura nga viti 2018 janë shqyrtuar dhe lëshuar Pëlqimi Elektroenergjetik 1,030 kërkesa, 455 kërkesa janë shqyrtuar dhe është dhenë palëve Informatë lidhur me kërkesën e tyre për Pëlqim Elektroenergjetik, ndërsa sipas të dhënave të KEDS-it 92 kërkesa tjera gjithashtu janë shqyrtuar, por që sipas departamentit të Pëlqimeve Elektroenergjetike në kuadër të KEDS-it është konstatuar se këtyre kërkesave nuk duhet t’iu lëshohet Pëlqimi Elektroenergjetik, por që këto kërkesa janë deleguar të departamentet tjera, pjesa e mbetur prej kërkesave janë në proces të shqyrtimit.

Më poshtë është paraqitur diagrami i kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike për periudhën sipas viteve 2014 – 2019, dhe nga diagrami shihet qartë se për çdo vjet ka rritje të kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike nga aplikuesit për kyçje.


**Fig. 6.35 Kërkesat për pëlqimet eektroenergjetike për periudhën 2014 – 2019**

### 6.8.3.3 Ankesat e konsumatorëve te furnizuesi - KESCO

Sipas të dhënave të raportuara të KESCO-s gjatë vitit 2019 numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruar në Departamentin për Konsumator në KESCO është 6,841 dhe të bartura nga viti i kaluar kanë qenë 857 ankesa, ndërsa të zgjidhura/përfunduara janë 6,102.

Më poshtë është paraqitur grafiku i ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura për vitin 2019 sipas distrikteve.




Fig. 6.36 Ankesat dhe numri i konsumatorëve sipas distrikteve, 2019

Nga figura e mësipërme shihet se përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të regjistruar në KESCO gjatë vitit 2019 është në distriktin e Prishtinës 57.93 %, pasuar nga distrikti i Ferizajit me 12.50 %, ndërsa përqindja më e ulët është në distriktin e Gjakovës prej 4.25 %. Duhet theksuar se numrin më të madh të ankesave në distriktin e Prishtinës është kryesisht se Distrikti i Prishtinës ka edhe numrin më të madh të konsumatorëve në Kosovë. Gjithashtu nga figura e mësipërme shihet se përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të zgjidhura nga Departamenti i Konsumatorëve në KESCO në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të zgjidhura në nivel vendi është në distriktin e Prishtinës prej 56.36 %, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 13.65 %, ndërsa më e ulëta është në distriktin e Prizrenit prej 4.38 %.

Më poshtë është paraqitur raporti i ankesave të konsumatorëve të parashtruara në KESCO me numrin e faturave/konsumatorëve sipas muajve.



Tab. 6.28 Raporti i ankesave dhe numrit të konsumatorëve sipas muajve për vitin 2019

Muaji	Ankesa	Numri i faturave / konsumatorëve	Raporti ankesa/konsumator
Janar	819	582,425	0.14%
Shkurt	747	583,930	0.13%
Mars	568	585,590	0.10%
Prill	496	587,633	0.08%
Maj	609	589,963	0.10%
Qershor	484	591,850	0.08%
Korrik	535	594,265	0.09%
Gusht	485	596,751	0.08%
Shtator	480	598,301	0.08%
Tetor	580	601,159	0.10%
Nëntor	514	602,847	0.09%
Dhjetor	524	605,694	0.09%
<b>Gjithsej</b>	<b>6,841</b>	<b>7,120,408</b>	<b>0.10%</b>

Nga të dhënat e raportuara nga furnizuesi KESCO shihet se numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2019 është 6,841 e që paraqet 1.13 % të numrit total të konsumatorëve, gjegjësisht 0.10 % ndaj numrit të përgjithshëm të faturave vjetore.

Nga të dhënat vërehet se përqindja më e lartë e ankesave të përfunduara në raport me ankesat e regjistruara për periudhën janar – dhjetor 2019 është realizuar në distriktin e Gjakovës (raporti ankesa të përfunduara/ankesa të regjistruara) prej 100.69 %, pasuar nga distrikti i Gjilanit me 100.30 %, ndërsa më e ulëta në distriktin e Pejës me 82.21 %. Vlen të theksohet se në disa distrikte ka përqindje më të lartë se 100 %, e kjo për arsye se përveç ankesave të regjistruara të asaj periudhe, distriktet kanë arritur t’i shqyrtojnë edhe disa ankesa të bartura nga viti i kaluar.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të regjistruara dhe të përfunduara sipas natyrës së ankesave për vitin 2019.




Fig. 6.37 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2019

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet e natyrës së ankesave:

*B1 - Pagesë e pa regjistruar*

*B2 - Bilanci fillestar gabim*

*B3 - Mosmarrja e faturave*

*B4 - Mbilimiti*

*B5 - Ndryshim i paushallit*

*B6 - Lexim jo korrekt*

*B7 - Lexim jo i rregullt*

*B8 - Njehsori jo i saktë*

*B9 - Kërkesa për shlyerje të borxhit*

*B10 - Shkyçja pa njoftim*

*B11 - Të tjera*

*B12 – Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike (Rikthimi i humbjeve)*

Nga të dhënat e raportuara nga KESCO për vitin 2019, vërehet se nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve më së shumti ankesa ka pasur lidhur me njehsorin jo të saktë prej 1,713 apo shprehur në përqindje prej 25.04 %, pasuar nga ankesat lidhur me lexime jo korrekte prej 1,367 apo shprehur në përqindje prej 19.98 %, ndërsa më së paku ankesa ka pasur lidhur me shkyçjen pa njoftim dhe atë vetëm 12 ankesa apo 0.18 %.

Sipas të dhënave të KESCO, në vitin 2019 ankesat e konsumatorëve të regjistruara e të cilat kanë qenë lidhur me gabimet në lexim në pikën matëse (lexim jo korrekt dhe lexim jo i rregullt) kanë qenë 1,589 apo shprehur në përqindje 23.23 % nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të parashtruar, në vitin 2018 numri ankesave që kanë qenë lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse kanë qenë 1500, në vitin 2017 kanë qenë 3,955, në vitin 2016 kanë qenë 4,504, si dhe në vitin 2015 kanë qenë 5,312. Nga kjo shihet qartë se numri i ankesave të konsumatorëve lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse është në rënie e sipër dhe kjo fal mënyrës së re të leximit të pikës matëse me anë të pajisjes së dorës (ang. "Hand Held Unit"), e cila ka përmirësuar dukshëm leximin e pikave matëse dhe ka zvogëluar mundësinë e gabimeve gjatë leximit të pikës matëse, ngase leximi dhe faturimi bëhet në të njëjtën kohë.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave të zgjidhura nga KESCO për vitin 2019, apo më saktësisht statusi i ankesave të zgjidhura.




Fig. 6.38 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2019

Nga figura e mësipërme vërehet se KESCO nga 6,102 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve, prej tyre 2,694 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 44.15 %, ndërsa 3,408 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 55.85 %.

Numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruara në vitin 2019 është 6,841, në vitin 2018 është 8,040, në vitin 2017 është 11,350, në 2016 është 11,180, në vitin 2015 ka qenë 12,926, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 17,655 siç janë paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.39 Ankesat e konsumatorëve në KESCO sipas viteve

## 7 SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe në Zveçan. Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson afërsisht 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë. Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga 4 sisteme të energjisë termike (ngrohjes qendrore) me një kapacitet të instaluar prodhues i cili vlerësohet të jetë rreth 332 MW<sub>TH</sub>. Ngrohtorja Termomit, Mitrovicë dhe e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përgjigjen kërkesave për licencim / rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja, kështu që pamundësohet sigurimi i të dhënave përkatëse të azhurnuara; për këtë arsye në vijim paraqiten të dhëna të detajuara për NQ Termokos dhe NQ Gjakova

### 7.1.1 Impiantet e prodhimit të energjisë termike

Impiantet për prodhimin e energjisë termike të NQ Termokos përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 120 MW<sub>TH</sub>, dhe ngrohtorja ndihmëse në Qendrën klinike universitare me kapacitet prej 14 MW<sub>TH</sub>. Me kyçjen e stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, këtij kapaciteti i është shtuar edhe kapaciteti i instaluar i kogjenerimit prej 140 MW<sub>TH</sub>. Duhet theksuar se kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë dekomisionuar por ato do të shërbejnë si kapacitet rezervë për tu aktivizuar në rastet e ndonjë avarie eventuale në njësitë e TC Kosova B.

Ngrohtorja e qytetit Gjakova është e pajisur me dy kaldaja me mazut me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 38.6 MW<sub>TH</sub> – njëra me kapacitet 20 MW<sub>TH</sub> dhe tjetra 18.6 MW<sub>TH</sub>.

### 7.1.2 Sistemet e Shpërndarjes të Energjisë Termike

Sistemet e shpërndarjes së energjisë termike në Kosovë përbëhen nga rrjeti primar i shpërndarjes që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjër tek shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Termokosit ka një gjatësi traseje prej rreth 41 km respektivisht gjatësi tubacioni prej 82 km. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë i cili gjendet në Bregun e Diellit dhe 465 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Përpos rrjetit ekzistues të shpërndarjes, në vitin 2014 është ndërtuar edhe rrjeti i transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej rreth 10.5 km.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Gjakova shtrihet në gjatësi prej rreth 15.5 km trase respektivisht tubacion në gjatësi 31 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 180 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tab. 7.1 Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW]	Kapaciteti operacional [MW]	Rrjeti i energjisë termike	
			Gjatësia e rrjetit (trasesë) [km]	Nr. i nënstacioneve
	2 x 58 = 116	2 x 49.3 = 98.6	Rrjeti i shpërnd.	
TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 7 = 14	2 x 6.3 = 12.6	41.0	475
	1 x 4 = 4	3.6	Rrjeti i Transp.	(aktive-465)
	[Kogjenerimi] 2 x 70 = 140	2 x 68.7 = 137.4	10.5	
<b>Nën-total</b>	<b>274.0</b>	<b>252.2</b>	<b>51.5</b>	<b>475</b>
NQ GJAKOVA (Gjakovë)	1 x 20 = 20	1 x 14.8 = 14.8	Rrjeti i shpërnd.	302
	1 x 18.6 = 18.60	1x13.02 = 13.02	15.5	(aktive-180)
<b>Nën-total</b>	<b>38.6</b>	<b>27.8</b>	<b>15.5</b>	<b>302</b>
<b>Total</b>	<b>312.6</b>	<b>280.0</b>	<b>67.0</b>	<b>777 (Aktive - 645)</b>

## 7.2 Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike

### 7.2.1 Zhvillimet në NQ Termokos

Furnizimi kualitativ dhe i qëndrueshëm me energji termike në vitet e fundit, ka bërë që të shtohet interesimi për përfshirje sa më të gjerë të konsumatorëve të qytetit të Prishtinës në sistemin e NQ Termokos. Me qëllim të plotësisimit të kërkesave në rritje për kycje në sistemin e NQ Termokos, gjatë vitit 2019 janë aktualizuar një numër i projekteve zhvillimore, kryesisht në rrjetin e shpërndarjes, që janë në faza të ndryshme të zhvillimit.

Në maj 2019 ka filluar realizimi i Projektit të Komisionit Evropian IPA 2015: Rehabilitim i rrjetit e nënstacioneve, si dhe zgjerim i rrjetit dhe nënstacione të reja. Në kuadër të këtij projekti, ekzekutimi i punimeve ndërtimore dhe instaluese do të përfshijë këto komponente kryesore:

- Rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes (zëvendësimi i tubacioneve të vjetra me gypa të rinjë të paraizoluara) – 3.28 km trase respektivisht 6.5 km tubacion; rehabilitimi përfshin rajonet: Qendër: 1 km trase, Dardani: 0.79 km trase, Kodra e Diellit: 1.18 km trase, Ulpiana 0.24 km trase dhe Kalabri një segment shumë i shkurtër prej vetëm 0.07 km.
- Rehabilitimin e 100 nënstacioneve termike – Dardania: 26, Qendra: 9, Ulpiana: 21, Kodra e Diellit: 8, QKUK: 5 dhe Institucione të ndryshme: 31 nënstacione termike. Në kuadër të rehabilitimit përfshihet edhe instalimi i 100 valvulave rregulluese (kontrolluese) te presionit diferencial.
- Zgjerimi i rrjetit në total 3.96 km trase respektivisht 7.92 km tubacion i ri – Qendra: 0.66 km trase, Kodra e Diellit: 0.048 km trase, 0.574 km trase, Dardania: 0.617 km trase, Kalabria: 1.028 km trase dhe Mati: 1.035 km trase.
- 51 Nënstacione termike të reja – Qendra: 9, Ulpiana: 4, Kalabria: 31, Mati: 5 dhe 1 Nënstacion termik i Objektivit i drejtorisë së Doganave të Kosovës.



*Fig. 7.1 Pamje nga punimet në rehabilitimin e rrjetit dhe nënstacioneve*

Me finalizimin e këtij projekti do të arrihet që të reduktohen humbjet e energjisë termike dhe të përmirësohet kualiteti i ngrohjes në disa pjesë ku janë më problematike, si dhe me zgjerim të rrjetit do të shtohet numri i konsumatorëve që përfitojnë furnizim me energji termike (ngrohje qendrore), respektivisht arrihet të shtohet sipërfaqja për ngrohje të hapsirave që mbulohet nga shërbimi i furnizimit me ngrohje qendrore nga Termokos.

Në vazhden e përpjekjeve për adresimin e zgjerimit të sistemit të ngrohjes qendrore por edhe çështjeve ambientale është inicuar edhe projekti për përfitimin e energjisë termike nga panele solare. Konkretisht në nëntor 2019 është prezantuar Studimi i Parafizibilitetit i financuar në bashkëpunim mes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Ky projekt përfshin impiantet e kolektorit të energjisë diellore (panelet solare) në një sipërfaqe prej rreth 73,000 m<sup>2</sup> dhe rezervuarin e ujit të ngrohtë me vëllim prej rreth 540,000 m<sup>3</sup> dhe planifikohet të ketë kapacitet maksimal të nxehtësisë prej 29MW. Me këtë do të mundësohet ofrimi i ngrohjes (pra mundësi zgjerimi i sistemit) për lagjet Arbëria dhe Tophane, të cilat aktualisht nuk janë të kyçura në sistemin e NQ Termokos. Përveç që do të sigurojë ngrohje të mjaftueshme dhe cilësore për mijëra konsumatorë të rinj të këtyre dy lagjeve, do të ndikonte që të eliminohet edhe përdorimi i thëngjillit dhe drurit të zjarrit për ngrohje individuale të shtëpive dhe ndërtesave, që do të kontribuonte dukshëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Në mars 2018 është nënshkruar marrëveshja financiare mes Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Kosovës për mbështetje financiare në kuadër të Programit për sektorin e energjisë VIII dhe IX – projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit të NQ Termokos. Ky projekt që udhëhiqet nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) është në fazën përgatitore dhe përmban 2 komponente kryesore:

- Rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së NQ Termokos;
- Modernizimin e nënstacioneve ekzistuese dhe ndërtimin e nënstacioneve të reja, si dhe ndërtimin e rezervuarëve për deponim të ngrohjes.

Ky projekt, që është fazën fillestare përgatitore, parashihet të jetë në vlerë përafërsisht 14 mil €, mjete që janë zotuar si donacion nga Gjermania, Luksemburgu, Suedia, fonde që do të ndahen dhe menaxhohen përmes KfW, si dhe një shumë e vogël nga Komuna e Prishtinës.

Në dhjetor 2019 është përzgjedhur kompania për implemëntimin e projektit: “Matja e ngrohjes qendrore”. Konkretisht në kuadër të Programit ‘Spektri i Energjisë së Besueshme’ të MCC - SHBA

(“Millenium Challenge Corporation”) është përfshirë komponenta e instalimit të matësve të energjisë termike për konsumatorët e NQ Termokos, me synim që të kalohet në faturimin e bazuar në matjen e konsumit, me ç’rast arrihet shfrytëzimi efikas i energjisë termike. Ky projekt në vlerë të parapare prej 10.9 mil \$, si donacion nga MCC – SHBA, përmban:

- Instalimin e matësve individual të energjisë termike respektivisht alokatorëve të nxehtësisë;
- Instalimin e valvulave termostatike dhe pompave qarkulluese;
- Zhvillimin e softverit për faturim dhe lexim të konsumit të energjisë termike;
- Asistencë në përmirësimin e shërbimeve të faturimit bazuar në konsumin e matur.

Realizimi i këtij projekti, që pritet të filloj në 2020, do të mundësoj matjen e konsumit dhe implementimin e faturimit bazuar në matjen e regjistruar të konsumit, me çka do të arrihet kursimi i energjisë termike që do të liroj kapacitetet për zgjerim të bazës së konsumatorëve respektivisht do mundësoj kyçjen në sistemin e ngrohjes të një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve që aktualisht shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje të hapësirave.

Lidhur me projektet zhvillimore duhet theksuar se në seancën e dt. 10 korrik 2019, Bordi i ZRRE-së ka miratuar Planin Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar të NQ Termokos. Plani Zhvillimor paraqet masat efikase që do të merren për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe për të siguruar furnizim sa më të mirë me energji termike (ngrohje qendrore), duke përfshirë planifikimet për projektet rehabilituese dhe të zgjerimit të infrastrukturës së sistemit të ngrohjes qendrore në komunën e Prishtinës, gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme.

## 7.2.2 Zhvillimet në NQ Gjakova – Projekti i ndërrimit të lëndës djegëse dhe kogjenerimi

Sa i përket NQ Gjakovës, fillimisht duhet theksuar se, përkundër vështirësive financiare për sigurimin e sasive të mjaftueshme të lëndës djegëse – mazutit, falë subvencioneve nga buxheti i Kosovës, NQ Gjakova ka arritur që me 25 nëntor 2018 të startoj me prodhimin dhe furnizimin e konsumatorëve me energji termike.

Lidhur me projektin për Ngrohtoren e re me biomasë të NQ Gjakovës, vlen të përmendet se gjatë vitit 2019 kanë përfunduar procedurat e tenderimit për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore dhe instaluese si dhe është hartuar hartimi i projektit detal të ngrohtores së re. Ndërsa dhjetor të vitit 2019 ka filluar realizimi i Projektit për ndërtimin e ngrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit me lëndën djegëse biomasë. Ky projekt në vlerë prej rreth 13.5 milion €, përkrahet financiarisht nga Komisioni Evropian - Zyra në Kosovë përmes fondeve të IPA-2015. Të dhënat kryesore:

- 2 njësi për prodhim vetëm të energjisë termike (ngrohjes) me kapacitet  $2 \times 5.5 \text{ MW}_{\text{TH}}$ ;
- 1 njësi e kogjenerimit (bashkëprodhimit) të energjisë elektrike dhe termike me kapacitet termik:  $4 \text{ MW}_{\text{TH}}$ ; dhe Kapacitet elektrik:  $1.2 \text{ MW}_{\text{EL}}$
- Total kapaciteti termik:  $15 \text{ MW}_{\text{TH}}$  dhe Kapaciteti elektrik  $1.2 \text{ MW}_{\text{EL}}$

Projekti, ndër tjera, përfshin edhe instalimet e pajisjeve përkatëse të ngrohtores së re dhe kyçjen në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike respektivisht të energjisë elektrike.

Ky projekt do të mundësoj një qëndrueshmëri operationale dhe financiare të NQ Gjakovës, ku konkretisht ndikimi kryesor paraqet zëvendësimi i lëndës djegëse – mazutit (që për shkak të kostos



së lartë në masë të madhe është subvencionuar nga Buxheti i Kosovës) me biomasë. Përveç furnizimit cilësor të konsumatorëve me ngrohje qendrore, ky projekt po ashtu ndikon pozitivisht në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe në mbrojtjen e ambientit.

Me dt. 27 nëntor 2019 Bordi i ZRRE ka lëshuar Autorizimin final për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë, që përmban edhe përfshirjen në skemën mbështetëse (tarifën nxitëse) të kapacitetit gjenerues të energjisë elektrike prej 1.2 MW<sub>EL</sub> si pjesë e njësisë së kogjenerimit.

### 7.3 Përformanca e ndërmarrjeve të energjisë termike

Në sezonin 2018/2019 NQ Termokos ka vijuar me trendin pozitiv të prodhimit dhe furnizimit të qëndrueshëm me energji termike, duke ofruar furnizim të pandërprerë 24 h, që kryesisht është rrjedhojë e prodhimit të mjaftueshëm nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, por edhe realizimit të projekteve rehabilituese të rrjetit dhe nënstacioneve termike.

Sa i përket NQ Gjakovës duhet përmendur se, falë Subvencioneve nga Qeveria e Kosovës ka arritur që në sezonin 2018/2019 të startoj prodhimin dhe furnizimin me energji termike. Megjithatë, për shkak të kufizimeve financiare, NQ Gjakova, ka qenë e detyruar të shkurtoj sezonin e ngrohjes në rreth 3.5 muaj (gjysma e dytë e nëntorit 2018 – shkurt 2019). Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka ofruar furnizim me orar të reduktuar ditore si dhe ka reduktuar dukshëm sipërfaqen ngrohëse gjegjësisht numrin e konsumatorëve që u ka ofruar furnizim, duke u përqendruar në konsumatorët pagues më të rregullt si dhe në pjesët e rrjetit ku ka më pak humbje të energjisë termike.

#### 7.3.1 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet në NQ Termokos

##### - Prodhimi i energjisë termike

NQ Termokos e ka bazuar prodhimin e energjisë termike nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B; në fakt në sezonin 2018/2019 i tërë prodhimi i energjisë termike ka qenë nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, ashtu që nuk ka qenë e nevojshme aktivizimi i kaldajave me mazut në Ngruhtoren e Termokosit.

Sasia e energjisë termike e ekstraktuar nga kogjenerimi në sezonin 2018/2019 ka qenë **235,079 MWh<sub>TH</sub>**, që është për 11,341 MWh<sub>TH</sub> ose 5.07% më e madhe se sasia e energjisë termike në sezonin e kaluar (223,738 MWh<sub>TH</sub>). Ndërsa sasia e pranuar energjisë termike në stacionin e shkëmbimit të nxehtësisë në NQ Termokos ka qenë **229,661 MWh<sub>TH</sub>**, që gjithashtu paraqet një rritje prej 9,907 MWh<sub>TH</sub> ose 4.41% në krahasim me sezonin e kaluar (219,954 MWh<sub>TH</sub>).

Të dhënat e përmbledhura të prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi, janë paraqitur në tabelën vijuese:



*Tab. 7.2 Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi*

Energjia Termike nga Kogjenerimi – NQ Termokos, Sezoni 2018/2019			
Muaji	Njësia	En.term. e ekstraktuar (matur në TC Kosova B)/Prodhimi Bruto	En.term. e pranuar (matur në NQ Termokos)/Prodhimi neto
Tetor 2018	MWh <sub>TH</sub>	13,703	13,589
Nëntor 2018	MWh <sub>TH</sub>	29,583	28,988
Dhjetor 2018	MWh <sub>TH</sub>	44,912	43,698
Janar 2019	MWh <sub>TH</sub>	48,391	47,647
Shkurt 2019	MWh <sub>TH</sub>	40,778	39,899
Mars 2019	MWh <sub>TH</sub>	36,744	35,289
Prill 2019	MWh <sub>TH</sub>	20,968	20,551
<b>Gjithsej</b>	<b>MWh<sub>TH</sub></b>	<b>235,079</b>	<b>229,661</b>

#### - Furnizimi me energji termike

Gjithashtu në sezonin 2018/2019 NQ Termokos ka vazhduar me furnizim të mjaftueshëm sasiore dhe kualitativ të energjisë termike, që kryesisht është rrjedhojë e përmirësimit në vazhdimësi të prodhimit të energjisë termike, si dhe mirëmbajtjes, riparimeve dhe rehabilitimit të rrjetit.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike (ngrohje qendrore), në këtë sezonë vlerësohet të jetë **209,533 MWh<sub>TH</sub>**, që paraqet rritje prej **9,671 MWh<sub>TH</sub>** ose 4.84 % në krahasim me sezonin paraprak 2017/2018 (**199,862 MWh<sub>TH</sub>**). Ky furnizim i realizuar është mjaft i kënaqshëm dhe ka përmbushur planifikimet dhe objektivat për një furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor

#### - Humbjet në sistem

Sistemi i energjisë termike i NQ Termokos ka specifikat e veta sa i përket humbjeve në sistem, për shkak të integritetit të energjisë termike nga kogjenerimi. Pra, humbjet në rrjet përfshijnë dy komponentë: humbjet në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos dhe humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes.

Humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej 10.5 km, janë përcaktuar nga matjet që janë kryer në stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B dhe në stacionin e pranimit të energjisë termike në NQ Termokos. Nga matjet që janë kryer në periudhën tetor 2018 – prill 2019 rezulton se humbjet sasiore në këtë periudhë janë **5,418 MWh<sub>TH</sub>** gjegjësisht **2.3%**. Në tabelën vijuese janë dhënë detaje për humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike.

*Tab. 7.3 Energjia termike dhe humbjet e në rrjetin e transmetimit TC Kosova B – NQ Termokos– sezoni 2018/2019*

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Total
Energjia termike e ekstraktuar - matur në TC Kosova B [MWh]	13,703	29,583	44,912	48,391	40,778	36,744	20,968	235,079
Energjia termike e pranuar - matur në NQ Termokos [MWh]	13,589	28,988	43,698	47,647	39,899	35,289	20,551	229,661
Humbjet në sasi të energjisë [MWh]	114	595	1,214	744	879	1,455	417	5,418
Humbjet në [%]	0.83%	2.01%	2.70%	1.28%	1.46%	1.30%	1.30%	2.30%

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes së energjisë termike normalisht përcaktohen nga matjet e energjisë termike në hyrje të rrjetit të shpërndarjes dhe nga furnizimi i energjisë termike në nënstationet e konsumatorëve. Mirëpo, në mungesë të matjes së tërësishme të furnizimit të energjisë termike (në nënstatione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës ( $W/m^2$ ) dhe orë e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik ( $kWh/m^2$ ). Vlera e përlllogaritur e konsumit është **209,533 MWh<sub>TH</sub>**. Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (**228,841 MWh<sub>TH</sub>**) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2018/2019 janë **19,308 MWh<sub>TH</sub>**, që në përqindje paraqet **8.44%**; Ky nivel i humbjeve prej 8.4% paraqet një zvogëlim prej 0.4% krahasuar me sezonin e kaluar (8.8%).

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e tërësishme në rrjet – rrjetin e transportimit të energjisë termike dhe në rrjetin e shpërndarjes:

*Tab. 7.4 Performanca energjetike e NQ Termokos – sezoni 2018/2019*

NQ Termokos - Sezoni i Ngruhjes 2018/2019		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Prodhipi bruto në stabilimentet e ngrohtores	[MWh <sub>th</sub> ]	0
Prodhipi bruto në stabilimentet e kogjenerimit	[MWh <sub>th</sub> ]	235,079
Humbja sasiore në rrjetin e transportit (TC Kosova B - NQ Termokos)	[MWh <sub>th</sub> ]	5,418
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	2.30
Konsumi vetanak	[MWh <sub>th</sub> ]	820
Prodhipi neto i energjise termike	[MWh <sub>th</sub> ]	228,841
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh <sub>th</sub> ]	19,308
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	8.44
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh <sub>th</sub> ]	209,533

### 7.3.2 Prodhipi, furnizimi dhe humbjet në NQ Gjakova

#### - Prodhipi i energjisë termike

NQ Gjakova, prodhimin e energjisë termike e ka bazuar në kaldajat me lëndën djegëse mazut. Siç u theksua më lartë, në sezonin 2018/2019 prodhipi i energjisë termike ka qenë mjaft i reduktuar – prodhipi bruto ka qenë **9,112 MWh<sub>TH</sub>** ndërsa prodhipi neto i energjisë termike **8,637 MWh<sub>TH</sub>**. Për

këtë prodhim të energjisë termike në këtë sezon janë shpenzuar **1,152 ton** të lëndës djegëse - mazut. Duhet të theksohet se, sipas të dhënave të raportuara nga ndërmarrja, është shënuar një efikasitet termik i ulët i ngrohtores rreth 70%.

#### - Furnizimi me energji termike

NQ Gjakova gjatë sezonit 2018/2019 ka ofruar një furnizim të reduktuar, si pasojë e përgjysmimit të sezonit të ngrohjes dhe zvogëlimit të sipërfaqes ngrohëse. Furnizimi i konsumatorëve me energji termike në këtë sezon ka qenë **6,909 MWh<sub>th</sub>**, sasi kjo që as për së afërmi nuk e plotëson e kërkesën për ngrohje të gjithë konsumatorëve të kyçur në sistemin e NQ Gjakovës.

#### - Humbjet në sistem

Sa i përket humbjeve në prodhimin e energjisë termike, fillimisht duhet theksuar se, për arsye se disa matje mungojnë gjegjësisht konsiderohen si jo shumë të besueshme për shkak të vjetërsisë së pajisjeve, përcaktimi i humbjeve përfshin edhe disa parametra të paravlerësuar si p.sh efikasiteti i kaldajave dhe vlera e konsumit vetanak. Efikasiteti i kaldajave për prodhimin e energjisë termike është vlerësuar mjaft i ulët rreth 70%, që shkakton një humbje të konsiderueshme gjatë procesit të transformimit të energjisë së lëndës djegëse në energji termike, e cila vlerësohet të jetë 3,905 MWh<sub>th</sub>.

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes llogariten si diferenca në mes të sasisë së energjisë termike të futur në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimit/konsumit. Në mungesë të matjes së sasisë së furnizuar të energjisë termike (në nënstacione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafrime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës (W/m<sup>2</sup>) dhe orë e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik (kWh/m<sup>2</sup>). Vlera e përllogaritur e konsumit është **6,909 MWh<sub>th</sub>**. Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (**8,637 MWh<sub>th</sub>**) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2018/2019 janë **1,728 MWh<sub>th</sub>**, që në përqindje janë rreth 20%.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e në rrjetin e shpërndarjes.

Tab. 7.5 Performanca energjetike e NQ Gjakova – sezoni 2018/2019

NQ Gjakova - Sezoni i Ngrohjes 2018-2019		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Sasia e lëndës djegëse -mazutit	[ton]	1,152
Vlera kalorifike	[MWh <sub>th</sub> /ton]	11.3
Energjia e futur nga lënda djegëse -mazuti	[MWh <sub>th</sub> ]	13,017
Efikasiteti i kaldajave	[%]	70.00
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh <sub>th</sub> ]	9,112
Konsumi vetanak	[MWh <sub>th</sub> ]	475
Prodhimi neto i en.termike / Energjia e futur në rrjetin e shpërndarjes	[MWh <sub>th</sub> ]	8,637
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh <sub>th</sub> ]	1,728
Humbjet në përqindje	%	20.01
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh <sub>th</sub> ]	6,909

## 7.4 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet e gjithëmbarshme të energjisë termike

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e prodhimit, furnizimit dhe humbjeve në sistem të përmbledhura për tërë sektorin e energjisë termike.

Tab. 7.6 Performanca energjetike e sektorit të energjisë termike – sezoni 2018/2019

Sektori i Energjisë Termike - Sezoni 2018/2019				
Përshkrimi	Njësia	NQ Termokos	NQ Gjakova	Gjithsej
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh <sub>th</sub> ]	235,079	9,112	244,191
Humbjet sasiore në rrjetin e transportit	[MWh <sub>th</sub> ]	5,418	0	5,418
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	2.30	0.00	2.30
Konsumi vetanak	[MWh <sub>th</sub> ]	820	475	1,295
Prodhimi neto i energjise termike	[MWh <sub>th</sub> ]	228,841	8,637	237,478
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh <sub>th</sub> ]	19,308	1,728	21,036
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	8.44	20.01	8.86
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh <sub>th</sub> ]	209,533	6,909	216,442

## 7.5 Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes

### 7.5.1 Faturimi dhe arkëtimi

Në lidhje me faturimin fillimisht duhet përmendur se edhe në sezonin 2018/2019, faturimi i konsumatorëve të energjisë termike kryesisht ka qenë i bazuar në sipërfaqen e ngrohjes (për metër katror), ndërsa një numër më i vogël i konsumatorëve janë faturuar bazuar në konsumin e matur. Konkretisht në NQ Termokos numri i konsumatorëve të faturuar me matje ka arritur në 105 konsumatorë, kryesisht komercial e institucional; përderisa NQ Gjakova në mungesë të njehsorëve funksional pothuajse tërësisht faturon sipas sipërfaqes ngrohëse.

NQ Termokos në sezonin 2018/2019 ka shënuar një rritje të faturimit në krahasim me sezonin e kaluar 2017/2018, që është kryesisht rrjedhojë përmirësimit të vazhdueshëm të furnizimit. Faktikisht faturimi në sezonin 2018/2019 ka qenë **6,288,796 €**, që paraqet një rritje prej 247,136 € ose 4% në krahasim me sezonin 2017/2018 (6,041,660 €). Megjithatë edhe në këtë sezon nuk është arritur niveli i planifikuar i faturimit kryesisht për shkak të: i) zbritjeve në faturim për shkak të ditëve pa ngrohje dhe për shkak të kualitetit të dobët të furnizimit (në disa lagje të Prishtinës); dhe ii) zbritjet në sipërfaqen ngrohëse pas verifikimit në terren.

Nga faturimi total i realizuar në sezonin 2018/2019 prej **6,288,796 €**, faturimi me matje ka qenë **2,457,164€** ndërsa dhe pa matje **3,831,632€**; raporti i faturimit me matje dhe pa matje si dhe vlerat respektive janë paraqitur në diagramin më poshtë.




Fig. 7.2 Pjesëmarrja e vlerave të faturimit me matje dhe pa matje në faturimin total

Si rrjedhojë e faturimit të shtuar por edhe përmirësimit në arkëtim, shuma monetare e arkëtuar ka pësuar një rritje në krahasim me sezonin e kaluar – në sezonin 2018/2019 shuma e arkëtuar ka qenë **4,456,254 €** ndërsa shuma e arkëtuar në sezonin 2017/2018 ka qenë 3,812,371 €, që paraqet një rritje prej 643,833 € ose 16.9%. Po ashtu nëse i referohemi përqindjes së arkëtimit, në këtë sezon vërehet një rritje e përqindjes së arkëtimit në krahasim me sezonin e kaluar – në sezonin 2018/19 përqindja e arkëtimit ishte 70.86% ndërsa në sezonin 2017/18 përqindja e arkëtimit ka qenë 63.59%, që paraqet rritje prej 7.27%.

Siç u theksua më lartë, NQ Gjakova gjatë sezonit 2018/2019 ka ofruar një furnizim të reduktuar, si pasojë e përgjysmimit të sezonit të ngrohjes dhe zvogëlimit të sipërfaqes ngrohëse. Rrjedhimisht faturimi në këtë sezon ka qenë mjaft i vogël – **312,323 €**, ndërsa arkëtimi si shumë monetare ka arritur vlerën prej **250,301€**, që paraqet një shkallë të arkëtimit prej 80.14%.

Detajet në lidhje me faturimin dhe arkëtimin janë treguar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tab. 7.7 Faturimi dhe arkëtimi– sezoni 2018/2019

Sezoni i ngrohjes 2018/2019	Sipërfaqja ngrohëse [m <sup>2</sup> ]	Pjesëmarrja në përqindje	Faturimi [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
<b>NQ "Termokos" Prishtina</b>					
Amvisëri	738,413	57.05%	2,979,629	2,266,135	76.05%
Komercial e Institucional	555,835	42.95%	3,309,167	2,190,119	66.18%
Gjithsej	1,294,248	100.00%	6,288,796	4,456,254	70.86%
<b>NQ "Gjakova" Gjakovë</b>					
Amvisëri	34,559	45.34%	114,390	97,314	85.07%
Komercial e Institucional	41,670	54.66%	197,933	152,987	77.29%
Gjithsej	76,229	100.00%	312,323	250,301	80.14%




Fig. 7.3 Faturimi dhe arkëtimi NQ Termokos dhe NQ Gjakova – sezoni 2018/2019

### 7.5.2 Sipërfaqja për ngrohje

Në sezonën 2018/2019 NQ Termokos ka pasur sipërfaqen e përgjithshme ngrohëse të konsumatorëve prej **1,294,248 m<sup>2</sup>**, që paraqet një rritje prej 23,468 m<sup>2</sup> ose 1.85% në krahasim me sipërfaqen ngrohëse në sezonin 2017/2018 (**1,270,780 m<sup>2</sup>**).

Ndërsa NQ Gjakova, për arsyet e përmendura më lartë, në sezonin 2018/2019 dukshëm ka zvogëluar sipërfaqen ngrohëse në vetëm **76,229 m<sup>2</sup>**.

Në grafikët e mëposhtëm paraqiten sipërfaqet ngrohëse të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, të ndara sipas grupeve të konsumatorëve.




Fig. 7.4 Sipërfaqja ngrohëse sipas grupeve të konsumatorëve në sezonin 2018/2019

## 8 SEKTORI I GAZIT NATYROR

### 8.1 Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë

Me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të sektorit të gazit natyror dhe njëkohësisht përmbushjes së obligimeve që Kosova i ka ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Parlamenti i Kosovës në qershor 2016, në kuadër të pakos së ligjeve të energjisë, ka miratuar Ligjin për Gazin Natyror, Nr.05/L-082.

Me këtë ligj është bërë transpozimi i pakos së tretë të legjislacionit Evropian relevant për gazin natyror, kryesisht:

- Direktiva Nr. 2009/73/EC për Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Gazit Natyror; dhe
- Rregullorja Nr. 715/2009/EC për Kushtet e Qasjes në Rrjetet e Transmisionit të Gazit Natyror.

Ligji për gazin natyror shtron bazat për kornizën ligjore dhe rregullative për transmisionin, shpërndarjen, deponimin dhe furnizimin me gaz natyror dhe për operimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes së gazit. Rrjedhimisht me këtë ligj përcaktohet organizmi dhe funksionimi i sektorit të gazit natyror dhe qasja në rrjetet dhe tregun e gazit.

Strategjia e energjisë e Kosovës 2017-2026 në Objektivin '4' ka përfshirë zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes (kyçjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, sidomos me projektin e gazsjellësit TAP ("Trans-Adriatik-Pipeline" – Gazsjellësi Përtej Adriatikut) dhe me Unazën e Gazit të Komunitetit të Energjisë. Lidhur me këtë duhet theksuar se projekti i gazifikimit respektivisht zhvillimit të infrastrukturës së gazit është renditur në listën e projekteve prioritare infrastrukturore - fusha e energjisë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar për Investime dhe nga Qeveria e Kosovës.

Vlerësohet se projekti i gazsjellësit TAP do ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Komunitetin e Energjisë respektivisht në rajonin e Evropës Juglindore, duke ofruar mundësi për lidhjen e projekteve të planifikuara rajonale si gazsjellësi Jon-Adriatik (IAP) dhe ALKOGAP, dy këto projekte që e plotësojnë të ashtuquajturën 'Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë'.

TAP aktualisht është në fazën përfundimtare të ndërtimit dhe planifikohet që në vitin 2020 të filloj operimi i plotë i gazsjellësit TAP dhe rrjedhat e para të gazit përmes këtij gazsjellësi. Kapaciteti fillestarë i TAP planifikohet të jetë 10 miliardë metër kub (bcm) për vit, me mundësi shtimi gjer në 20 bcm për vit. TAP do lejoj kyçjet interkonektive (intekonekcionet) përgjatë gazsjellësit për të furnizuar me gaz projektet tjera rajonale. Pra me marrëveshjet shtetërore me shtetet "nikoqire" (Greqia, Shqipëria dhe Italia) janë para-përcaktuar vendet e kyçjes dhe sasisë respektivisht kapacitetet e gazit.

Në këtë kontekst të zhvillimeve rajonale në sektorin e gazit, Kosova ka ndërmarrë një numër aktivitetesh të ndërlidhura me projektet aktuale të gazsjellësve rajonal.

Përveç projektit të Gazsjellësit Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP), për të cilin në vitin 2018 është përgatitur Studimi i para-fizibilitetit për projektin ALKOGAP, gjatë vitit 2019 janë ndërmarrë iniciativa tjera për projektet tjera me karakter vendor ose rajonal.



### 8.1.1 Master-plani për zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Kosovë

Bazuar në rekomandimet e dala nga Studimi i para-fizibilitetit për projektin ALKOGAP, në fillim të vitit 2019 Kosova ka aplikuar në platformën WBIF ('Western Balkans Investment Framework' – Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor) për asistencë teknike për hartimin e Master-planit të gazit. Në mbledhje e qershorit 2019 të Komitetit Drejtues të WBIF është miratuar projekt-propozimi për Master plan e gazit në Kosovë dhe është vendosur që të përkrahët financiarisht hartimi i këtij master plani, ku Institucion udhëheqës financiar është Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD-BERZH); planifikohet që në 2020 të fillohet me hartimin e Master-planit.

### 8.1.2 Interkonekcioni i gazit Maqedoni e Veriut – Kosovë

Në shkurt 2019 Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë së Maqedonisë së Veriut kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit, në funksion të bashkëpunimit për të intensifikuar marrëdhëniet dypalëshe në sektorin e energjisë; ndër tjera në këtë memorandum janë përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim në sektorin e energjisë elektrike, gazit natyror, burimeve të ripërtërishme të energjisë, dhe efijencës së energjisë, si dhe në përgatitjen në të ardhmen të projekteve të përbashkëta, të rëndësishme infrastrukturore në energji elektrike dhe gaz natyror. Në vijim të këtij bashkëpunimi, Kosova dhe Maqedonia e veriut bashkërisht kanë paraqitur projekt-propozimin / aplikacionin për linjën interkonektive të gazit mes dy vendeve në platformën WBIF. Komitetit Drejtues i WBIF në mbledhjen e qershorit 2019 ka aprovuar përkrahjen financiare për asistencë teknike në hartimin e Studimit të fizibilitetit dhe Vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social për këtë projekt; Institucion udhëheqës financiar është Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD-BERZH)

Progresi në zhvillimin dhe implementimin e këtyre projekteve të lartë përmendura konsiderohet me rëndësi dhe një parakusht i domosdoshëm për krijimin dhe zhvillimin e tregjeve të gazit natyror në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të veriut. Në vijim janë paraqitur skicat e këtyre projekteve:






Fig. 8.1 Projektet e Infrastrukturës rajonale të gazit dhe opcionet për kyçjen e Kosovës (përshirë ALKOGAP dhe interkoneksionin e gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë)



Fig. 8.2 Projekti i linjës interkoneksionit të gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë

Gjatë pjesës së parë të vitit 2019 ZRRE ka vazhduar të marrë pjesë në projektin regional “Southeast Europe Natural Gas Transmission and Distribution Grid Codes Project”- Projekti i Evropës juglindore për kodet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit”. Ky projekt implementohet nga NARUC, SHBA - Agjencioni Kombëtar i Komisioneve Rregullative të Shërbimeve Publike (“National Agency of Regulatory Utilities Commissions”) me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Në kuadër të implementimit të projektit me asistencën e konsulentëve të NARUC- është përgatitur Modeli i ‘kosto – benefit’ analizës për vlerësimin e projekteve të infrastrukturës së gazit.

ZRRE, edhe këtë vit ka vazhduar pjesëmarrjen e rregullt në punën e Grupit punues të gazit të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB) dhe Forumin e gazit, si dhe në eventet tjera të karakterit regional të organizuar në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

**Adresa e Rregullatorit**

**Zyra e Rregullatorit për Energji**

Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12

Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 247 615

Fax: +383 (0) 38 247 620

Email: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org)

Web: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:**

Tel: +383 (0) 38 247 615 lok. 101

**Sekretaria:**

Tel: + 383 (0) 38 247 615 lok. 104

**Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:**

Tel. + 383 (0) 38 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: [ankesa.dmk@ero-ks.org](mailto:ankesa.dmk@ero-ks.org)